

> 2020

RAPORT

për gjendjen në
financimin
kapital të
sigurimit
pensional



MAPAS

Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

Shkup, Qershor 2021



MAPAS

Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional



Shkurtesa	4
Fjala hyrëse	5
Data të rëndësishme në vitin 2020	7
MAPAS, misioni dhe vizioni	8
1. Një vështrim i shkurtër i situatave në Botë dhe trendeve në sferën e pensioneve, me theks në financimit kapital të sigurimit pensional	9
2. Struktura e financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut	16
2.1. Përshkrimi i sistemit pensional	17
2.2. Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin e pensioneve	18
2.3. Infrastruktura institucionale e financimit kapital të sigurimit pensional	19
3. Ndryshime dhe plotësime në ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë sfincimit kapital të sigurimit pensional	23
4. Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale	26
4.1. Të ardhura dhe shpenzime të shoqërive pensionale për vitin 2020	27
4.2. Rezultati financiar i shoqërive pensionale	30
4.3. Kapitali, kapitali themeltar dhe mjetet individuale të shoqërive pensionale	31
4.4. Indikatorët	32
5. Informacione për fondet pensionale të detyruara	34
5.1. Anëtarësia në fondet pensionale të detyruara	35
5.2. Të dhënat për anëtarësia në fondet e pensionit të detyruara	36
5.3. Kalimi i një anëtar nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër	41
5.4. Kontribute në fondet pensionale të detyrueshme	42
5.4.1. Kompensim për transferimin jo në kohë të kontributeve	44
5.4.2. Mjete të kthyer në Fondin PIOSM	45
5.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale të detyrueshme	46
5.6. Mjetet -neto, njësiti kontabël dhe norma e kontributit të fondeve pensionale të detyrueshme	53
5.7. Kompensime të fondeve pensionale të detyrueshme	63
5.8. Pagesa e pensioneve nga financimi kapital i sigurimit pensional të detyrueshëm	65
6. Informacione për fondet pensionale vullnetare	68
6.1. Qëllimi i financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar	69
6.2. Anëtarësia në fondet pensionale vullnetare	70
6.3. Kalim i anëtarit nga një llogari në një tjetër në të njëjtin ose në fond pensional vullnetar tjetër	73
6.4. Kontributet në fondet pensionale vullnetare	74
6.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale vullnetare	75
6.6. Mjetet-neto, njësia e kontabilitetit dhe norma e kontributit të fondeve pensionale vullnetare	81
6.7. Kompensime tek fondet pensionale vullnetare	88
6.8. Pagesa e kompensimeve pensionale të financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar	90
7. Efektet e krizës globale e shkaktuar nga pandemia e virusit Korona mbi sigurimin pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut	92
8. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale	98

SHKURTESA

BPV - Prodhimi i Brendshëm Bruto

Shtylla e dytë - Financimi kapital i sigurimi të detyrueshëm pensional

FPV - fondet e pensionit vullnetar

ESHS - Enti Shtetëror i Statistikave

BE - Bashkimi European

FPD - fondet pensionale të detyrueshme

ONMP - Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të pensioneve (International Organisation of Pension Supervisors)

KB Prvo - KB Shoqëria e parë për menaxhimin e fondeve të pensionit të detyrueshëm dhe vullnetar AD Shkup

KBPd - KB Fondi i parë i hapur vullnetar pensional - Shkup

KBpz - KB Fondi i parë i hapur pensional i detyrueshëm - Shkup

MAPAS - Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

BPRMV - Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

OECD - Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (Organisation for Economic Co-operation and Development)

Shtylla e parë - Sigurim i detyrueshëm pensional dhe invalidor i bazuar në solidaritetin e gjeneratave

SAVA - Shoqëria për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava Shoqëria për pensione a.d. Shkup

SAVAd - Fondi i hapur vullnetar pensional Sava pension plus

SAVAz - Fondi i hapur i detyrueshëm pensional Sava fondi pensional

Shtylla e tretë - Financimi kapital i sigurimi pensional vullnetar

TRIGLAV - Shoqëria për administrim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHOQERIA PENSIONALE TRIGLAV AD Shkup

TRIGLAVz - Triglav Fondi i hapur i detyrueshëm pensional– Shkup

DAP - Drejtoria e te Ardhurave Publike

Fondi PIOsm - Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut

PËRSHËNDETJE HYRËSE



Të nderuar,

Raporti për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital në vitin 2020 të Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional – MAPAS përmban përshkrim të karakteristikave të financimit kapital të sigurimit pensional, të dhënave të financimit kapital të sigurimit pensional, vlerësim të kryerjes të rregullave në fushën e financimit kapital të sigurimit pensional dhe të dhënave të tjera të rëndësishme për këtë sigurim për vitin 2020. Raporti është vërtetim se edhe në kushte të pandemisë dhe të virusit Korona dominonte në funksionimin e përditshëm në vitin 2020 dhe në gjysmën e parë të vitit 2021 akoma gjeneron një mjedis të pasigurt MAPAS siguron një funksionim, zhvillim dhe përparim të vazhdueshëm të shtyllës së dytë dhe të tretë, transparencë dhe supervizion

efikas të segmentit të dytë për nga madhësia në sektorin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Investimi i papritshëm në situatën globale epidemilogjike e shaktuar nga përhapja e virusit Korona e shoqëruar me vendosjen e masave për ruajtjen e shëndetit publik siç është kufizimi i pjesshëm ose i plotë të lëvizjeve shkaktoi efekte të mëdha ekonomike. Kriza ekonomike dhe shëndetsore globale kishte shfaqur ndikim në tregjet financiare të huaja dhe të vendit dhe fondet pensionale maqedonase nuk ngelën immune të zhvillimeve aktuale globale.

Kriza në mënyrë afakshkurtër ndryshoi trendet e lëvizjes pozitive të parametrave për sigurim pensional me financim kapital të detyrueshëm dhe vullnetar, kështu që shënohen zhvendosje negative në fund të tremujorit të parë të vitit 2020, por fondet pensionale për një kohë relativisht të shkurtër e kthyen dhe e tejkaluan vlerën e zvogëluar të mjeteve.

Në krahasim me vitin e kaluar mjetet totale të fondeve pensionale të detyruara dhe vullnetare u rritën për 15% dhe aritën masën 87,3 miliardë denarë ose mjetet totale të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare aritën në masën 2,3 miliardë denarë. Me këtë mjetet totale të fondeve pensionale në shtyllën e dytë dhe të tretë aritën afërsisht 13,5% të prodhimit të vendit bruto për vitin 2020. Në vitin 2019 u rrit edhe përfshirja e popullsisë në shtyllën e dytë ose 93% nga numri total i sigurveve në fondin e PIOSM ose 56% të popullsisë totale aktive janë anëtarë të shtyllës së dytë. Edhe pse u shënua rritje prapë përfshirja e popullsisë në shtyllën e tretë akoma është modeste ose vetëm rreth 2,7% të popullsisë totale aktive në RMV –riut janë anëtarë me llogari vullnetare individuale dhe janë pjesëmarës në skemën pensionale me llogari profesionale në fondin pensional vullnetar.

Struktura e portofolit investues të fondeve pensionale të detyrueshme nuk ndryshon shumë në krahasim me vitin e kaluar. Respektimi në punë të fondit pensional të detyrueshëm TRIGLAVZ nuk ndikonte në strukturën totale të investimeve në fondet pensionale të detyrueshme persa i përket faktit se në vitet e para të punës fondi i ri akoma disponon me mjete që janë me vëllim të vogël në krahasim me mjetet totale të fondit pensional të detyrueshëm. Portofoli investues në vitin 2020 përbëhet nga investimet e vendit të cilat përfshijnë letra me vlerë shtetërore (60%), depozita (10%), aksione (3%), pjesëmarje në fondet investuese (0,02%) dhe obligacione korporative (0,03%), si dhe investime jashtë

vendit të cilët përfshijnë pjesëmarje të fondeve investuese (23%) dhe aksione (5%). Në nivel të sigurimit pensional të detyrueshëm me financim kapital në periudhën shtatëvjeçare 2014–2020 ishte realizuar një shumë mesatare e ndjekur në nivel vjetor me 5,55% në shumë nominale ose 4,85% në shumën reale e përlogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit për fondet pensionale të detyrueshme. Struktura e portofolit investues të fondeve pensionale vullnetare gjithashtu nuk ndryshon shumë në krahasim me vitin e kaluar dhe përbëhet nga investimet e vendit të cilët përfshijnë letra me vlerë shtetërore (44%), depozita (14%), aksione (8%), obligacione korporative (2%) dhe një pjesë të vogël në pjesëmarje në fondet investuese (0,01%), si dhe investime jashtë shtetit të cilët përfshijnë pjesëmarje në fondet investuese (22%) dhe aksione (6%). Në nivel të financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar në periudhën shtatëvjeçare 2014–2020 ishte realizuar një kontribut mesatar në nivel vjetor prej 5,56% në shumë nominale ose 4,86% në shumë reale i përlogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit në fondet pensionale vullnetare.

Edhe pse në kushte të vështira në vitin 2020 punohej për përmirësimin dhe precizimin ose thjeshtëzimin e procedurave të caktuara në kuadrin e funksionimit të sigurimit pensional me financim kapital dhe në atë drejtim ishin bërë ndryshime në aktet dhe udhëzimet nënligjore.

Kursimi për pension është afatgjatë ndërsa sfidat që sjell financimi kapital i sigurimi pensional janë të pashmangshme. Gjendjet në fushën e pensionit duhet të ndiqen vashdimisht dhe në kontinuitet dhe me atë të meren masat e duhura me qëllim forcimin e kursimeve individuale nëpërmjet nxitjes të konkurrencës, promovimit të drejtimit fleksibël dhe efikas me portofolet dhe zgjerimin e mbulimit në drejtim të mbrojtjes të interesave të anëtarëve dhe realizimin e pensionit të sigurt gjatë pleqërisë.

Ju sigurojmë se si trup regullator dhe mbikëqyrës në punën e përditshme udhëhiqemi nga misioni tonë ashtu si dhe në vitet e kaluara do të investojmë resurset tona në drejtim të përmirësimit dhe shtimit të financimit kapital të sigurimit pensional.

Besojmë se ky raport me të dhëna dhe informacione të detajuara për shtyllën e dytë dhe të tretë do të jetë me leverdi për të gjitha palët e interesuara.

**Kryetari i Këshillit të Ekspertëve,
Maksud Ali**

DATA TË RËNDËSISHME NË VITIN 2020.

01.01.2020 r.

U zvogëlua kompensimi maksimal i lejuar nga kontributet që mund ta arkëtojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e dytë (nga 2,25% në 2,00% kompensim nga kontributet)

31.12.2020 r.

U mbushën pesëmbëdhjetë vjet punë të sigurimit pensional të detyrueshëm me financim kapital

MAPAS, misioni dhe vizioni

Agjensioni i mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional-MAPAS është institucion rregullator dhe mbikëqyrës, i themeluar me qëllim që të kujdeset për interesat e anëtarëve dhe anëtarëve në pension të fondeve pensionale dhe të nxisë zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional. I themeluar në korrik të vitit 2002, ai ka cilësinë e subjektit juridik me autorizime publike, të parapara me Ligjin për financimin kapital të sigurimit pensional të detyruar dhe me Statutin. Për punën e tij përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

MAPAS është përgjegjës për lëshimin, tërheqjen dhe marrjen e lejeve për themelimin e shoqërive pensionale, lejeve për ushtrimin e aktivitetit – menaxhimin e fondeve pensionale dhe lëshimin, tërheqjen dhe anulimin e lejeve për menaxhimin me fondet pensionale të detyruara dhe vullnetare. Agjensioni bën edhe mbikëqyrjen e punës së shoqërive pensionale, të fondeve pensionale të detyruara dhe vullnetare, si dhe të rojtareve të pasurisë dhe të menaxherëve të huaj të mjeteve. MAPAS, po ashtu promovon, organizon dhe nxit zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional në RMV, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe e zhvillon ndërgjegjësimin e opinionit për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe të fondeve pensionale të detyruara dhe vullnetare, për përfitimet nga anëtarësimi në fondin pensional të detyruar dhe/ose vullnetar, duke përfshirë qëllimet, përfitimet dhe parimet nga pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve pensionale të detyruara dhe vullnetare dhe për çështje të tjera në lidhje me financimin kapital të sigurimit pensional. MAPAS miraton akte konform ligjeve në sferën e financimit kapital të sigurimit pensional dhe përgatit udhëzime profesionale, doracakë e të tjera, në lidhje me financimin kapital të sigurimit pensional dhe inicion miratimit të normave dhe akteve të tjera në lidhje me shoqëritë pensionale dhe me fondet pensionale, me të cilat menaxhojnë ata. Po ashtu, MAPAS bashkëpunon me institucione relevante të RMV dhe të huaja me qëllim që të sigurojë një kontroll efikas të financimit kapital të sigurimit pensional në RMV.

Me Agjencinë e mbikëqyrjes së financimit kapital të sigurimit pensional menaxhon Këshilli i Ekspertëve, i përbërë nga Kryetari i Këshillit dhe katër anëtarë, si më poshtë vijon:

Maksud Ali – Kryetar,

Mentor Jakupi – anëtar profesionalisht i angazhuar,

Darko Sazdov – anëtar profesionalisht i angazhuar,

Borçe Bozhinovski – anëtar i jashtëm,

Marina Makenaxhieva – anëtar i jashtëm.

MISIONI YNË është që të mbrojmë interesat e anëtarëve dhe anëtarëve në pension të fondeve pensionale dhe të nxisë zhvillimin e financimit kapital të sigurimit pensional, për ditë më të sigurt pensionale.

VIZIONI YNË është që të identifikohemi si një institucion i pavarur, profesional dhe transparent, që mbron dhe zhvillon sistemin pensional në RMV.

1 ● Përmbledhje e shkurtër e kushteve dhe trendeve botërore në fushën e pensioneve me theks financimit kapital të sigurimit pensional

1. Përmbledhje e shkurtër e kushteve dhe trendeve botërore në fushën e pensioneve me theks financimit kapital të sigurimit pensional¹

Sistemet e pensioneve në botë karakterizohen nga struktura të ndryshme si rezultat i kushteve të ndryshme socio-ekonomike dhe demografike në vendet, ndikimi i kulturës së njerëzve dhe shprehjet e tyre dhe perceptimet e kursimeve për pension. Në dekadat e fundit, rreziqet e një plakje të popullsisë dhe ndryshimi i natyrës së tregut të punës kanë nxitur një gamë të gjerë të reformave të sistemit të pensioneve me qëllim për t'i zbutur ato, por me të njëjtin qëllim përfundimtar - sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm pensioni dhe të ardhura adekuate për të siguruarit pas pensionit të tyre.

Shuma e aseteve të pensioneve në sistemet e pensioneve në gjerë në botë në vitin 2019 ndoqi një trend të rëndësishëm në rritje. Pas rënies së vërejtur të pensioneve në disa vende në 2018, mjetet pensionale në 2019 u rritën në të gjitha vendet e hulumtuara. Shuma totale e mjeteve pensionale në 2019 është pothuajse dy herë më e lartë se shuma e mjeteve pensionale në fund të vitit 2009 (menjëherë pas krizës financiare globale në 2008) kur ato arritën në 27 bilion USD. Në vitin 2019 (para pandemisë me korona virusin), mjetet pensionale në nivel botëror arritën shumën më të madhe dhe tejkaluan 50 bilion USD. (49.2 bilion USD në vendet e OECD dhe 1.7 bilion USD në vendet e zgjedhura të cilët nuk janë anëtare të OECD-së.) Nxitësit kryesorë të sistemeve të pensioneve në nivel botëror, dhe më tej janë fondet e pensionale (asete në shumën prej 32 bilion në 2019). Gjithashtu, disa vende përdorin forma të tjera të kursimeve për pension siç janë marrëveshjet e sigurimeve pensionale me kompanitë e sigurimeve (për shembull Danimarka, Franca) ose produktet e siguruara dhe të administruara nga bankat dhe kompanitë e investimeve (angl: individual retirement accounts, në SHBA).

Madhësia e vlerës të mjeteve të sistemeve private të pensioneve në të gjitha vendet është e ndryshme, e cila ndoshta për shkak të fillimeve të ndryshme të krijimit të sistemeve, nëse kyçja në planin e pensioneve është e detyrueshëm apo vullnetar dhe natyrisht, rezultatet e investimeve. Në terma absolutë, në shtatë vende- anëtare të OECD (Kanada, SHBA, Holanda, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar, Australia dhe Japonia), mjetet pensionale tejkaluan nën një bilion USD. Nga ana tjetër, mjetet e sistemeve private të pensioneve në 70 (nga 90 vendet të cilët janë hulumtuar) vendet përfaqësojnë më pak se 0.2 bilion USD. Madhësia e vlerës e aseteve në sistemet private të pensioneve në të gjitha vendet është e ndryshme dhe në terma relativë. Tetë nga 37 vendet anëtare të OECD në fund të vitit 2019 kishin asete mbi 100% të ekonomisë së tyre. Në vendet e vogla si Islanda, asetet e akumuluar janë të vogla krahasuar me sistemet e tjera të pensioneve, por të larta në raport me ekonominë e tyre (178% të BPV-së). Nga ana tjetër, shuma e pensioneve është më pak se 20% e BPV-së në 54 nga 90 vendet e hulumtuara, përfshirë disa vende me rritje të shpejtë (p.sh. Kina, India).

Krahasimi i madhësisë së vlerës së mjeteve të mjeteve pensionale private në lidhje me madhësisë së ekonomisë, shprehur përmes produktit të brendshëm bruto, po jep një pamje më të mirë mbi rëndësinë relative të segmentit të pensioneve private në vend. Shuma e mjeteve pensionale në vendet e OECD në lidhje me BPV-në totale të vendeve anëtare të OECD u rrit nga 60% në 2009 në 92% në 2019. Si në vitin 2009, në 2019 kryeson Danimarka me 220% të BPV-së, e ndjekur nga Holanda (194%) dhe Islanda (178%). Në disa vende të cilat nuk janë anëtare të OECD, mjetet pensionale pothuajse arritën nivelin e BPV-së (88%

¹Burime të përdorura: Raporte nga OECD, Banka Botërore, FIAP dhe IOPS, dhe analiza dhe vazhime vetanake.

në Lihtenshtajn dhe 95% në Afrikën e Jugut). Nga ana tjetër, përkundër një rritje e vërejtur, mjetet pensionale në disa vende (Shqipëri, Greqi dhe Serbi) akoma dhe në fund të vitit 2019 janë më pakë se 1% nga BPV.

Edhe një tregues tjetër për rëndësinë të kapitalit të financuar dhe pensionet private në një vend është shkalla e mbulimit. Shkalla e mbulimit është një faktor që ndikon shumë në totalin, Shkalla e mbulimit mund të matet përmes numri i anëtarëve aktivë të planeve të pensione (personat që kanë fonde në planet e pensione dhe akoma nuk kanë ndalë në pension) në raport popullsisë në moshë pune. (personat në moshën 15 deri 64 vjeç). Anëtarësimi në një plan pensioni mund të jetë i detyrueshëm, vullnetar ose i inkurajuar përmes përfshirjes automatike. Të dhënat e disponueshme tregojnë se në vitin 2019 në 17 nga 32 vendet e hulumtuar në planet e pensione të detyrueshme janë mbuluar më shumë se 70% e popullsisë në moshë pune. Normat më të larta të mbulimit shënojnë Finlanda (93% e popullsisë në moshë pune) dhe Estonia (88%). Në Amerikën Latine, Kili shënon shkallën më të lartë të mbulimit prej 88% të popullsisë në moshë pune, gjë që nuk është rast në vendet e tjera. Norma të larta të punës informale në Kolumbi, Meksikë dhe Peru i shpjegojnë nivelet relativisht të ulëta të mbulimit në planet e pensione të detyrueshme (51% në Kolumbi, 34% në Peru). Për më tepër në disa prej këtyre vendeve, mbajtësit e policave kanë të drejtë të zgjedhin midis një sistemi pensioni të solidaritetit të gjeneratave dhe një sistemi kapital privat të pensione të financuar plotësisht (Kolumbi, Peru). Pjesëmarrja në planet e pensionit vullnetar ndryshon shumë midis vendeve. Më shumë se gjysma e të punësuarve në Gjermani dhe Islandë dhe më shumë se gjysma e popullsisë në moshë pune në Belgjikë, Republikën Çeke, Japoni dhe Poloni ishte përfshirë në planet e pensionit vullnetar. Në disa vende, pjesëmarrja në planet e pensione vullnetare ishte relativisht e ulët, sidomos në Shqipëri, Bullgari dhe Kazakistan. Sidoqoftë, në Bullgari dhe Kazakistan, shumë persona të siguar janë tashmë anëtarë të planeve të pensione të detyrueshme, përkatësisht 85% dhe 78% të popullsisë që punon. Mbulimi i ulët në Shqipëri mund të jetë rezultat i ndërgjegjësimit të pamjaftueshëm të popullsisë për plane të tilla pensionale.


Rritja e madhe e mjeteve pensionale në 2019 është pjesërisht për shkak të rezultateve të investimeve të planeve të pensione të financuara plotësisht dhe private në 2019. Kthimi real i investimeve kontribuues të mjeteve pensionale (neto nga shpenzimet e menaxhimit) në vitin 2019, në vendet e OECD-së mesatarisht ishte 8.0% dhe 4.4% në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së. Kontributi (për sa i përket mjeteve pensionale) kontributi neto i investimeve reale vërejtë dhe vlera më të larta, 9.7% në vendet e OECD dhe 6% në vendet të vendeve që nuk janë anëtare të OECD-së, duke pasqyruar atë që disa nga tregjet më të mëdha të pensione kanë realizuar fitime më të mëdha. Mjetet pensionale regjistruan fitime investimesh pothuajse në të gjitha vendet e hulumtuara (ffitimet më të mëdha janë vërejtur në Irlandë (18.5%) dhe Hollandë (13.7%)). Kontributi real i investimeve në mjetet pensionale në pesëmbëdhjetë vende të tjera, përfshirë Belgjikën, Kosta Rikën, Zvicrën, SHBA-në dhe Maqedoninë e Veriut regjistruan një vlerë prej më shumë se 10%.

Pensionet në përgjithësi regjistruan fitime nga rritja e tregjeve të kapitalit në 2019, rezultatet kryesore negative në tremujorin e fundit të 2018. Lehtësimi i tensioneve tregtare midis SHBA-në dhe Kinës, si dhe mundësia e një marrëveshje për Brexit, kanë kontribuar në rritjen e çmimeve të letrave me vlerë. Indekset kryesore të aksioneve ka regjistruar rritje në 2019 krahasuar me 2018 (p.sh. 25% - FTSE 250, 26.5% - DAX dhe 28.9% - S&P500) Grafiku 1.1² janë shfaqur kontributet reale të investimeve të mjeteve pensionale, neto nga shpenzimet për menaxhim për vitin 2019, në vendet e zgjedhura të OECD dhe vendet që nuk janë anëtare të OECD-së.


²Burimi: OECD, Tregu i pensionit në fokus, 2020.

Grafiku 1.1 Kontributi i investimit real në mjetet pensionale, neto nga shpenzimet e menaxhimit, për vitin 2019, në përqindje

A. Vendet e zgjedhura - anëtare të OECD



B. Vendet e zgjedhura që nuk janë anëtare të OECD



Kontributet për një periudhë më të gjatë janë tregues më relevant nga kontributet afatshkurte duke pasur parasysh natyrën e saj afatgjatë të planeve të pensione. Kontributet mesatare vjetore nominale në 5, 10 dhe 15 vitet e fundit ishin pozitive në të gjitha vendet e hulumtuara, ndërsa kontributet mesatare nominale vjetore për të njëjtën periudhë të rregulluar për inflacionin janë pozitive në pothuajse të gjitha vendet. Përkundër rezultateve relativisht të ulëta dhe kryesisht negative të investimeve në 2018, planet e pensione kanë arritur kontribute pozitive vjetore reale të investimeve në pesë vitet e fundit në 50 nga 53 vendet e hulumtuara.

Rezultatet nga investimet të fondeve të pensionit, në masë të madhe, varen nga alokimi i fondeve. Në shumicën e vendeve të hulumtuara, në vitin 2019, mjetet pensionale janë investuar në bono dhe në aksione, dhe në më shumë se gjysmën nga investimet në 34 nga 37 vendet e OECD dhe në 39 nga 47 vende të hulumtuara të cilët nuk janë anëtarë të OECD-së. Prandaj, zhvillimi i tregjeve të bonove dhe aksioneve ka rol të rëndësishëm në performancën financiare të planeve të pensione. Pjesa më e lartë e obligacioneve dhe aksioneve në portofolin total të fondeve të pensione kishte Kili (99%), Republika Dominikane (97.3%), Meksika (96.6%), Estonia (96.4%), Nigeria (96.4%), Rumania (96.3%), Maldive (96.2%) dhe Kroacia (95.7%). Pjesëmarrja në përqindje e aksioneve dhe obligacioneve ndryshon në vendet në 2018. Megjithatë, në përgjithësi ka një prirje më të madhe për obligacioneve, megjithatë, në 8 vende të OECD dhe 11 vende të cilat nuk janë anëtarë të OECD-së, pjesëmarrja në përqindje e aksioneve ishte më e lartë se tek obligacionet. Obligacionet shtetërore në kundërshtim të obligacioneve korporatave, zënë pjesën më të madhe të investimeve të obligacioneve direkte në një numër të madh vendesh. Për shembull, obligacionet shtetërore ishin 100% të investimeve të obligacioneve direkte në Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut, 96.5% në Maldive, 96% në Gana dhe Serbi, 88.2% në Çeki dhe 87.1% në Izrael, por vetëm 21, 4% në Norvegji dhe 12.2% në Zelandën e Re. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e pensione në disa nga vende të hulumtuara janë në kesh dhe depozita (22.9% nga fondet e pensionit në Çeki). Në shumicën e vendeve të hulumtuara, investimet në hua, pasuri të paluajtshme, fonde private të kapitalit dhe investime të tjera alternative zënë një pjesë relativisht të vogël nga investimet e mjeteve pensionale. Një pjesë e konsiderueshme e investimeve në pasuri të paluajtshme (direkte ose indirekte) vërehet, për shembull, në Kanada (më shumë se 12% nga mjetet totale) dhe Zvicër

(20%). Rregullorja për investimeve mund të parashikojë gjithashtu kufizime në investimet të instrumenteve jo-tradicionale. Shumica e vendeve kufizojnë ose ndalojnë plotësisht investimet në pasuri të paluajtshme (të paktën investime direkte), fonde private dhe/ose hua. Disa vende kanë zvogëluar kufizimet e investimeve në vitet e fundit dhe kanë inkurajuar investimet në infrastrukturë dhe projekte afatgjata (si për shembull në Kroacia dhe Rumani). Në Kroaci, me ndryshimet të Ligjit nga viti 2014 ishin zgjeruar mundësitë e investimeve për fondet e pensionit të detyrueshëm, për investime direkte në projekte infrastrukturë dhe në fondet alternative të investimeve. Në Rumani, me ndryshimet e rregullores nga viti 2019, u bë e mundur investimi i aseteve të fondeve pensionale në projekte infrastrukturë (deri në 15% nga mjetet pensionale).

Një nga temat kryesore që ishin të diskutuara në vitin 2020, në vazhdim diskutimet për dixhitalizimin dhe zhvillimin e teknologjisë në sektorin e pensioneve, ishte qasja mbikëqyrëse për forcimin e rezistencës kibernetike në sektorin e pensioneve private. Mbikëqyrësit diskutuan masat mbikëqyrëse dhe qasjet në fushën e sigurisë kibernetike, në mënyrë që të përmbledhin përvojën e deritanishme, në drejtim këshillimi i institucioneve financiare, duke përfshirë shoqëritë pensionale dhe drejtuesit e fondeve pensionale, për t'i mundësuar atyre që të zbusin dhe t'i përgjigjen në mënyrë efektive rreziqeve kibernetike. Në vitet e fundit, institucionet financiare, përfshirë fondet private të pensioneve dhe shoqëritë gjithnjë e më shumë u mbështetën në teknologjitë inovative për të zhvilluar zgjidhje të reja IT, gjë që rriti fushën e dobësive dhe mundësive për sulme kibernetike. Në vitin 2020, nevoja për zgjidhjet dixhitale që do të mundësojnë shërbimet online dhe shkëmbime informacionesh, si dhe puna në distancë përmes kanaleve dixhitale është rritur me kufizimet e lëvizjes të vendosura nga shtetet si përgjigje të përhapjes së virusit Corona. Këto kushte kanë rritur shqetësimet e sigurisë, përfshirë kapaciteteve e rrjeteve virtuale për të mbështetur funksionimin në distancë dhe sigurinë e informacionit në qasjen nga shtëpia. Kështu institucionet financiare u bënë mjaft të ekspozuara ndaj kërcënimeve dhe sulmeve kibernetike. Shoqëritë pensionale dhe fondet e pensioneve mbajnë sasi të mëdha të të dhënave personale dhe mjeteve të mbajtësve të policave të sigurimit, gjë që i bën ata një objektiv tërheqës të sulmeve kibernetike, megjithëse në një masë më të vogël krahasuar me bankat dhe institucionet e tjera të shërbimit të pagesave. Siguruesit mund të pësojnë dëme në lidhje me keqpërdorimin e të dhënave personale dhe humbjen të mjeteve financiare. Shoqëritë pensionale mund të përballen me sfida operacionale si prishjen e proceseve të shërbimit dhe ndërprerja e aktivitetit të biznesit, humbja e të dhënave të anëtarëve, mospërmblidhja e qëllimeve financiare si dhe mosrespektimi i detyrës fiduciare. Prandaj, siguria kibernetike është me interes të madh publik dhe kërkon vëmendje të veçantë dhe të shtuar nga mbikëqyrësit në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në vitin 2020 vazhduan diskutimet projektimet pensionale. Projektionet e pensioneve mund të jenë një mjet i fuqishëm për menaxhimin e pritjeve të anëtarëve të fondeve pensionale dhe mund të ndikojnë në vendimet dhe zgjedhjet që duhet t'i bëjnë anëtarët. Të njëjtët mund t'i edukojnë anëtarët për vlerën e vërtetë të një pensioni të ardhshëm dhe t'i ofrojnë këshilla për marrjen e vendimeve për pension. Por, mbikëqyrësit e pensioneve përballen me sfida të mëdha në drejtim të sigurimit të projeksioneve të cilësisë (të dhëna të përshtatshme, metodologji, supozime), gjetja e metodave të përshtatshme për prezantimin e rezultateve, standardizimin si dhe sigurimin e pajtueshmërisë me rregullores. Pyetjet kryesore të mbikëqyrësve janë kryesisht të natyrës teknike dhe kanë të bëjnë me zhvillimin e një metodologjie të përshtatshme për vlerësime afatgjata, supozime demografike (siç është jetëgjatësia) dhe supozimet makroekonomike (siç janë kontributet e mjeteve dhe normat e interesit për anuitet). Me rëndësi të madhe është edhe sfida për mënyrën të komunikimit efektiv të rezultateve të projekteve me anëtarët e fondeve pensionale, dhe sidomos prezantimi i pasigurisë të rezultateve të projektuara. Në këtë drejtim, IOPS është në proces të zhvillimit të praktikave të mira të lidhur me parashikimet e pensioneve nga sistemet e pensioneve të financuara plotësisht në mënyrë që të nxjerrë në pah dhe të ofrojë sugjerime për sfidat më të rëndësishme në lidhje me projektimet e pensioneve nga aspekti të mbikëqyrësve pensionale.

Vend thelbësor në diskutimet në vitin 2020 kishin zhvillimet në zonën e pensioneve të shkaktuara nga pandemia me Korona virusit. Pandemia ndërpreu aktivitetet e biznesit në të gjithë sektorët, përfshirë sektorin e pensioneve. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në të gjithë botën ka shkaktuar zhvillime të pafavorshme në tregjet financiare dhe të punës, të cilat nga ana tjetër kanë pasur një ndikim të madh të pashmangshëm në sistemet që sigurojnë të ardhura pas pensionimit. Ndikimi u reflektua mbi kursimet e pensioneve, shoqëritë pensionale dhe fondet, rregullatorët dhe mbikëqyrësit. Këto ndikime mund të çojnë në të ardhura më të ulta për pensionin dhe keqfunksionime të konsiderueshme në treg. Ndikimet kryesore që janë identifikuar janë si më poshtë:

- Ulje në vlerën e kursimeve të pensioneve për shkak të rënies në tregjet financiare
- Rritja e detyrimeve për shkak të rënies së normave të interesit në planet e pensioneve me pensione të përcaktuara dhe pensione anuitete
- Është zvogëluar aftësia për të kontribuar në fondet e pensionale nga ana e mbajtësit e policave, për shkak të përfitimeve të ulura të pagave ose humbjeve të vendeve të punës, si dhe nga punëtorët të cilat janë të prekur nga kriza financiare
- Ndërprerjet operacionale si rezultat i funksionimit në distancë
- Sulme kibernetike, abuzime dhe mashtrime kundër siguruesve, rregullatorëve, mbikëqyrësve dhe shoqëritë pensionale dhe fondeve
- Ulja e kursimeve dhe norma komplikuese të interesit të fituar për shkak të masave që synojnë përfitime afatshkurtra që mund të kenë një ndikim serioz negativ në planin afatgjatë, veçanërisht në përshtatshmërinë e të ardhurave nga pensioni (p.sh. ndërprerjet e kontributit, duke mundësuar hyrjen e hershme të kursimet e pensioneve)

Vendet miratuan politika dhe masa të ndryshme me qëllim për t'i ndaluar sfidat që i soli pandemia, dhe kanë të bëjnë edhe me kursimet e pensioneve. Këto politika referoheshin tek pjesëmarrësve të ndryshëm në sistemin e pensioneve, dmth anëtarëve të fondeve të pensioneve, punëdhënësit e tyre, pensionistët dhe shoqëritë pensionale dhe fondet. Janë identifikuar pesë grupe kryesore të masave. Katër grupet e para referoheshin për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të penisit privat dhe mbrojtjen e të ardhurave të pensionit në të ardhmen dhe mjaftueshmërinë e tyre, si më poshtë: subvencionimi i kontributeve dhe fondeve, kufizimi i materializimit të humbjeve afatshkurtra të investimeve, duke siguruar aftësinë paguese të planeve me garanci dhe të shoqëritë pensionale, mbrojtja e shoqërive pensionale dhe fondeve dhe anëtarëve nga rreziqet kibernetike. Grupi i fundit i masave përqendrohet në sigurimin e lehtësimeve afatshkurtra për siguruesit dhe punëdhënësit e tyre, në mënyrë që të mbrojë mirëqenien afatshkurtër në këmbim të një kostoje potenciale të të ardhurave të pensionit në të ardhmen.

Mbikëqyrësit e pensioneve kanë marrë një numër masash për të mbrojtur interesat e anëtarëve dhe konsumatorëve të pensioneve në mënyrë që të ruajnë funksionimin dhe vazhdimësinë e biznesit të skemave dhe fondeve të pensioneve dhe për të siguruar forcën financiare të planeve private të pensioneve në rrethanat aktuale. Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensionit ka mbështetur qasjet fleksibile, pragmatike, proporcionale dhe mbikëqyrëse bazuar në vlerësimin e rreziqut të marrë nga anëtarët e saj, por gjithashtu paralajmëroi për disa veprime që mund të çojnë në një përkeqësim të ndjeshëm të përfitimeve të pensioneve për përdoruesit. IOPS mbështeti nevojën për komunikim të hershëm dhe të qartë, si dhe udhëzime dhe këshilla për t'u ofruar mbikëqyrësve dhe subjekteve nën mbikëqyrje me palët e interesuara përkatëse. IOPS e konfirmoi rëndësinë, në rrethana të tilla specifike, të lehtësimit të disa kufizimeve rregullatore dhe sigurimin e lehtësimit të përkohshëm nga disa kërkesa për punëdhënësit ose menaxherët e mjeteve për t'i mundësuar atyre që të vazhdojnë aktivitetet e tyre në një mënyrë të qëndrueshme. Gjithashtu, IOPS njohu nevojën, në raste të caktuara të jashtëzakonshme, për masat që lehtësojnë kërkesat për qasje të përkohshme në llogaritë e kursimeve të pensionit për t'i zgjidhur vështirësitë të caktuara financiare. Në raste të tilla, IOPS theksoi gjithashtu nevojën për të marrë parasysh interesin afatgjatë të anëtarëve dhe paralajmëroi për veprime të caktuara që mund të çojnë në një përkeqësim të ndjeshëm të përfitimeve të pensioneve të përfituesve. Në këtë kuptim, qasja e hershme në kursimet e pensioneve duhet të jetë e kufizuar, e përkohshme dhe proporcionale me nevojat reale të përfituesit, veçanërisht për grupet më të rrezikuara, dhe të lejojë tërheqjen e fondeve në një mënyrë kuptimplote.

IOPS theksoi më tej rëndësinë e:

- kërkesat për subjektet e mbikëqyrura të ballafaqohen me rreziqet që vijnë nga kriza me virusit Korona, përfshirë implementimin të planeve të duhura për gjendje të paparashikuara dhe masa për zbutjen humbjeve sa është e mundur që të minimizohet ndikimi tek anëtarët;
- Sigurimi i mbikëqyrjes së fortë të fondeve pensionale dhe monitorimi i vazhdueshëm i kujdesshëm i aktiviteteve të ndërmarra nga subjektet nën mbikëqyrje;
- rishikimi i politikave anticiklike në mënyrë që të kontribuojë sa më shumë në stabilizimin dhe rimëkëmbjen e ekonomive;
- koordinimi i politikave të komponentit të pensionit privat dhe publik; dhe
- Vendosja e mekanizmave të duhur nga mbikëqyrësit dhe subjektet nën mbikëqyrje për mbrojtjen operacionale në lidhje me virusin Corona, përfshirë ndërmarrjen e veprimeve të duhura për të mbrojtur palët e prekur nga abuzimi i përdoruesve të shërbimeve financiare dhe forcimin e edukimit financiar midis përdoruesve.

Të dhënat paraprake nga OECD për vitin 2020 tregojnë se aktivet e fondit të pensionit në vitin 2020 u rritën pothuajse në të gjitha vendet e hulumtuara pavarësisht tronditjes së shkaktuar nga pandemia me virusit Corona dhe rënia e mjeteve në fund të Marsit 2020. Asetet e fondeve të

pensioneve në fund të vitit 2020 arritën 35 bilion USD, që tejkaluan shumat e aseteve të fondeve të pensioneve në fund të vitit 2019. Asetet e fondeve të pensioneve në vendet anëtare të OECD, në vitin 2020 krahasuar me 2019, u rritën me 9% në vendet anëtare të OECD dhe arritën shumën prej 34.2 bilion USD. Asetet e fondit pensional në vendet që nuk janë anëtare të OECD-së (31 vende të hulumtuara) arritën 0.8 bilion USD në 2020, domethënë, u rritën me pak më shumë se 1% krahasuar me fundin e vitit 2019.

Rritja e aseteve të fondeve të pensioneve në vitin 2020 ishte mbështetur nga fitimet e kapitalit në tregjet financiare dhe masat qeveritare që e ndihmuan pjesëmarrjen e vazhdueshme të anëtarëve në fondet e tyre të pensionit. Një rritje e madhe e aktiveve të fondit të pensioneve u vërejt në Gjeorgji (më shumë se 100%), ku pjesëmarrja në shtyllën e dytë të pensionit u bë e detyrueshme nga 1 janari 2019. Vetëm pesë nga 68 vendet regjistruan ulje të mjeteve në fondet pensionale (Australia, Polonia, Kili, Xhamajka dhe Peru). Në uljen e aseteve në fondet pensionale Australi, Xhamajkë dhe Poloni ndikim kanë humbjet e investimeve, ndërsa fondet e pensioneve në Kili dhe Peru panë rënie për shkak të rrjedhjeve të konsiderueshme të fondeve për anëtarët që shfrytëzuan mundësinë e përsëritur për të tërhequr një pjesë të llogarive të tyre të kursimeve pensionale, e cila ishte një masë e shkaktuar nga pandemia e virusit Korona.

Sidoqoftë, pasiguria mbetet, duke pasur parasysh shfaqjen e varianteve të reja të virusit në pjesë të ndryshme të botës dhe duke pasur parasysh nevojën për të rritje e numrin e popullsisë të imunizuar. Virusi Korona dhe masat e duhura të politikave ende mund të ndikojnë në tregjet financiare dhe të shkaktojë korrigjime potenciale të çmimeve në të ardhmen.

Në përgjithësi, ekspertët besojnë se pandemia ishte një provë në kohë reale e stabilitetit të menaxhimit të fondeve pensionale, efektivitetit të kontrolleve të brendshme dhe strategjive të menaxhimit të krizave dhe komunikimit të shoqëritë pensionale dhe fondeve me anëtarët dhe përdoruesit e tyre. Në përgjithësi, masat politike të shkaktuara nga pandemia, së bashku me masat ekonomike, nuk lejuan ndonjë ndërprerje të madhe operationale në fondet e pensionit. Në mënyrë të ngjashme, mund të thuhet se u testuan mbikëqyrësit e pensioneve, të cilët gjithashtu përgjithësisht iu përgjigjën rrethanave të reja dhe përshtatën strategjitë e mbikëqyrjes në përputhje me rrethanat. Sepse sistemet e pensioneve luajnë një rol të rëndësishëm në tregjet financiare, rregullimi dhe mbikëqyrja efektive bëhen edhe më të rëndësishme. Pritet, rregullatorët e pensioneve pritët që të rrisin fokusin në sigurimin e menaxhimit të përforcuar dhe menaxhimi i përforcuar me rreziqe dhe të ndryshojë qasjen e mbikëqyrjes në mbikëqyrjen e bazuar në rreziqe. Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm, veçanërisht në kushte pasigurie ekonomike, është besimi i anëtarëve në sistemin e pensioneve, i cili lidhet drejtpërdrejt me arsimimin e anëtarëve dhe sigurimin e informacione të qarta nga shoqëritë pensionale.

OECD theksoi disa rekomandime të vlefshme të politikave të cilat e adresojnë ndikimin e pandemisë në kursimet e pensioneve. Rekomandohet tek politikëbërësve për të siguruar anëtarësimin dhe kontributin e vazhdueshëm në fondet pensionale përmes së cilës do të sigurohet fleksibilitet për sponsorët në planet e pensioneve me pensione të definuara për të shmangen kërkesat për pagimin e kontributeve shtesë në rrethana jashtëzakonisht të vështira. Gjithashtu, një rekomandim i rëndësishëm është sigurimi i mbikëqyrjes proporcionale, fleksibile të bazuar në rrezik me një komunikim adekuat. Fleksibiliteti i vendosur nga pandemia pritët të hiqet kur rrethanat të përmirësohen.

2. Struktura e Financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

2.1. Përshkrimi i sistemit pensional

2.2. Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin pensional

2.3. Institucionet në financimin kapital të sigurimit pensional

2. Struktura e Financimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

2.1. Përshkrimi i sistemit pensional

Sistemi pensional maqedonas është pjesë e sigurimit social në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMS) dhe e ka strukturën e mëposhtme:

- Sigurim nbi bazë të solidaritetit të gjeneratave (e ashtuquajtur shtylla e parë),
- Financimi kapital i sigurimi pensional të detyrueshëm (a.q shtylla e dytë),
- Financimi kapital i sigurimit pensional vullnetar (a,q shtylla e tretë).

Kjo strukturë është rezultat e reformave rrënjësore të sistemit pensional e cila ishte përgatitur shumë vjet, ndërsa korniza ligjore e saj është u vu në funksion në vitin 2000. Ekzistojnë katër ligje dhe një numër i madh aktesh nënligjore që e rregullojnë sistemin pensional në RMV. Ato janë: Ligji për sigurim pensional dhe invaliditeti. Ligji për sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital. Ligji për sigurim pensional vullnetar me financim kapital. Ligji për pagesa të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga financimi kapital i sigurimit pensional dhe një numër i madh aktesh nënligjore të cilët e përpunojnë fushën përkatëse.

Sistemi pensional në RMV ka histori të një ekzistencë shumëvjeçare, përfshirje të madhe të fuqisë punëtore dhe sigurimin e pensioneve për personat e siguruar. Por ndryshimet social-ekonomike në RMV në fillimin e viteve 90 kanë pasur ndikim mbi sistemin pensional i cili u përball me vështirësi financiare gjatë punës së vetë. Ato ishin shkaktuar nga lëvizjet e disfavorshme në ekonomi të cilët ndikuan në uljen e numrin aktiv të siguruarve dhe në anketimet më të vogla të kontributeve nga njëra anë dhe në rritjen e numrit të pensionistëve nga ana tjetër. Shpenzimet për pensione shënuan rritje të vazhdueshme.

Faktor tjetër që kanë ndikim të fuqishëm mbi sistemin pensional është faktori demografik. Pra plakja e popullsisë që është në trend botëror domethënë njerëzit jetojnë më gjatë për shkak të kushteve më të mira të jetesës dhe kushteve më të mira shëndetësore por në të njëjtën kohë zvogëlohet numri i lindjeve të reja d.m.th të personave të rinj. Si rezultat të këtij faktori pjesëmarrja e personave të moshuar në popullsi totale është përherë dhe më i madh.

Lëvizjet demografike të këtyra në sistemin pensional shkaktuan daljen në pah të një numri të madh pensionerësh dhe shfrytëzimin për një kohë të gjatë të pensionit, dhe uljen e numrit të të siguruarve. Për sistemin me financim të vazhdueshëm shumë i rëndësishëm është raporti midis të siguruarve dhe pensionistëve pasi me kontributet e të siguruarve aktual paguhen pensionet për pensionistët aktualë. Projektione aktuariale, të përgatitura gjatë përgatitjes së reformave të sistemit pensional treguan se mund të pritët që këta faktorë do të kenë ndikim negativ mbi aftësinë paguese të Fondit të PIOSM, për një afat të gjatë, ose, pa reforma sistemi mund të funksiononte me një deficit të theksuar që shpejt dhe dukshëm do të rritej.

Me qëllim që ti dilet përpara këtyre situatave të pritshme ishte zbatuar një reformë rrënjësore të sigurimit pensional dhe invalidor në shtetin tonë me të cilën u fut sistemi pensional treshtyllash me mënyrë të kombinuar të financimit të pensioneve të ardhshme dhe me diversifikimin të rrezeve demografike dhe ekonomitë me qëllim që të sigurohet pension i sigurt për gjeneratat e pensionistëve të tanishëm dhe të ardhshëm dhe stabilitet financiar afatgjatë të sistemit pensional.

Shtylla e parë financohet nga baza aktuale (PAYG), që do të thotë se me kontributet e të siguruarve aktual paguhen pensionet e pensionistëve të tanishëm. Kjo shtyllë funksionon mbi principin e të ashtuquajtur pensionet të definuara ose nëpërmjet tij sigurohen pensionet sipas formulës të përcaktuar më parë për llogaritje të pensionit. Nga shtylla e parë paguhen një pjesë të pensioneve të pleqërisë, pensionit familjar si dhe shuma më e vogël e pensionit.

Shtylla e dytë dhe e tretë përfaqësojnë financimin kaptina të sigurit pensional në të cilën kryhet kapitalizimi i kontributeve të paguara në emrin dhe për llogari të anëtarit. Këto dy shtylla funksionojnë mbi principin e të ashtuquajtur kontribute të definuara, ose tek ato, niveli i kontributit që paguhet është përcaktuar që më përpara, ndërsa pensioni përcaktohet më pas në varësi të shumës së akumuluar. Nga shtylla e dytë paguhet një pjesë e pensioneve të pleqërisë. Nga shtylla e tretë sigurohet kompensim financiar për kohën e pleqërisë, invaliditet dhe në rast vdekje të siguruarit.

Me vendosjen e sistemit pensional shumëshyllësh si sistem i kombinuar nga financimi kapital i sigurimit pensional, publik, aktual i financuar dhe privat në RMV pritet që të sigurohet një stabilitet afatgjatë të sistemit dhe siguri në realizimin e të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor, nëpërmjet realizimit të fitimeve afatgjate për personat invalidë të cilat marrin pjesë në sistemin pensional, për vet sistemin pensional, si dhe efekte shtesë mbi ekonominë pra nga aspekti i personave invalidë sigurohet një siguri më e madhe në realizimin e pensionit i cili do financohet nga disa burime, kështu që bëhet ndarja e rreziqeve. Në të njëjtën kohë me reformat u arit transparencë dhe informim më të madhe të anëtarëve të fondeve pensionale. Reforma duhet të udhëheqë drejt vendosjes të një sistemi pensional solvent si dhe rritjen e kursimeve dhe nxitjen e investimit të popullsisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike.

2.2. Roli i financimit kapital të sigurimit pensional në sistemin pensional

Financimi kapital i sigurimit pensional në mënyrë radikale dallohet nga financimi kapital i sigurimit pensional aktual dhe nga pikëpamja e trajtimit dhe evidentimit të kontributeve të paguara dhe nga pikëpamja e përcaktimit dhe pagesës së pensioneve. Në këtë sigurim çdo anëtar ka llogari individuale në të cilën evidentohen mjetet e tyre dhe sigurohet një lidhje e ngushtë midis vëllimit të kontributeve të paguara dhe pensioneve të ardhshme që do ti realizoj çdo anëtar. Kjo lloj mënyre e sigurimit është bazuar në principin e akumulimit të mjeteve nga kontributet e llogarive individuale të cilat më tej investohen dhe kontributi i realizuar nga investimet, i zvogëluar për shpenzimet e punës së sistemit, në tërësi i shtohet mjeteve të akumuluar dhe llogarive individuale. Pensioni i ardhshëm varet nga mjetet e akumuluar të llogarisë individuale dhe nga jetëzgatja e pritur gjatë daljes në pension, ose periudhe e pritshme e shfrytëzimit të pensionit. E rëndësishme është të theksohet se ky kursim pensional është kursim afatgjatë dhe realizohet gradualisht por rritja e kontinuar e kursimeve janë të vogla por në të ardhmen kur i siguruari do ta arrij moshën e pensionit kursimet bëhetdukshëm më të mëdha.

Karakteristikë për këtë sigurim është se mjetet në të janë menaxhuar privatisht dhe në mënyrë konkurrencte kështu që kontributet e paguara investohen nga ana e shoqërive pensionale të specializuara, të licencuara të cilat menaxhojnë me fondet pensionale. Në këtë mënyrë sigurohen qëllimet ekonomike për ta përcaktuar strategjinë investuese duke krijuar mundësi për maksimin e kontributit të përgjithshëm në interes të anëtarëve. Diversifikimi i reziqeve të investimeve (duke përfshirë diversifikimin ndërkombëtar) është një nga karakteristikat më të rëndësishme të këtij sistemi.

Më tej, karakteristika të rëndësishme të financimit kapital të sigurimit pensional janë e drejta e zgjedhjes personale dhe iniciativa e personit individual. Të gjithë të punësuarve para 1 janarit të vitit 2003 i ishte dhënë mundësia të vendosin nëse do të përfshihen në shtyllën e dytë të sistemit pensional dhe të zgjedhin në cilin fond pensional të detyrueshëm duan të anëtarësohen ndërkohë të gjithë personat e sapopunësuar pas 1 janarit të vitit 2003 kanë mundësi të zgjedhin fondin pensional të detyrueshëm me dëshirën e vet. Gjithashtu me ndryshimet në ligjin për sigurim pensional të detyrueshëm me financin kapital nga dhjetori i vitit 2018 anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme të cilët vullnetarisht u përfshin në shtyllën e dytë (të punësuar për herë të parë para vitit 1.1.2003) dhe të cilët kanë lindur para vitit 1.1.1967, i jepet mundësia të zgjedhin nëse do ta shpëputen ose do të vazhdojnë anëtarësinë në shtyllën pensionale të dytë. Të gjithë punonjësit të rinj pas 1 janarit të vitit 2019 të cilët në datën e përfshirjes në sigurimit të detyrueshëm pensional dhe invalidor kanë moshën më të vogël se 40 vjeç, kanë mundësi të zgjedhin fond pensional të detyrueshëm sipas dëshirës së vetë. Me tej anëtarësimi në fondet pensionale vullnetare është me zgjedhje vetjake të personit invalid ose nëpërmjet pjesëmarrjes në skemë pensionale profesionale e financuar nga ana e punëdhënësit ose nga shoqata e qytetarëve.

Transferimi i mjeteve është gjithashtu një e drejtë e rëndësishme në një sistem të financimit kapital të sigurimit pensional. Të gjithë anëtarët të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar

kanë të drejtën e kalimit nga një fond në një fond pensional tjetër gjatë të cilit transferohen edhe mjetet e kursyera të tyre. Dhe në rast të pjesëmarrjes në skemat pensionale profesionale personi ka të drejtë gjatë kalimit tek sigurues tjetër ti transferoj mjetet e kursyera ose në skemë pensionale profesionale tjetër ose në llogari individuale vullnetare.

Financimi kapital i sigurimit pensional siguron një shkallë të lartë të transparencës, që përfaqëson një nga karakteristikat e tij më të rëndësishme dhe një e re e domosdoshme në sistemin pensional. Shoqëritë kanë detyrim ligjor të paktën një herë në vit ti informojnë me shkrim anëtarët dhe anëtarët në pension të fondit pensional me të ashtuquajturin „zarf jeshil“, me raport për kursimin pensional. Zarfi jeshil gjithashtu përmban të dhëna për investimin e fondit pensional, për kompensimet e paguara dhe për kontributin e realizuar të fondit pensional

2.3. Institucionet në financimin kapital të sigurimit pensional

Institucionet të cilët marrin pjesë në sistemet pensionale treshtyllëshe janë:

- **Ministria për punë dhe politikë sociale** – kompetente për krijimin dhe udhëheqjen e politikës të sigurimit pensional dhe invalidor dhe për kryerjen e kontrollit për sa i përket zbatimit të ligjshmërisë të këtij sigurimi.
- **Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional** – institutinë sigurimin pensionale me financim kapital. MAPAS arkëton kompensim nga shoqëritë pensionale të cilin e llogarit si përqindje nga kontributet e paguara në fondet pensionale. Për vitin 2020 kjo përqindje ishte 0,8%.
- **Shoqëria pensionale** – shoqëri aksionere e themeluar nga institucionet financiare me kapital të madh dhe me eksperiencë, veprimtaria e vetme të cilës është menaxhimi i mjeteve të fondeve pensionale. Në sistemin pensional të reformuar ka mundësi për themelimin e tre llojeve të shoqërive:
 - » Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale të detyrueshme,
 - » Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale vullnetare,
 - » Shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.
- **Kujdestari i pasurisë së fondit pensional** – në mënyrë të sigurt i ruan mjetet e fondit pensional në llogari të veçantë, të ndara nga mjetet e shoqërisë.
- **Drejtoria e tatimeve** – kryen arkëtimin të centralizuar të kontributeve dhe tek Fondi i PIOSM i dorëzon kontributet totale të sigurimit pensional invalidor.
- **Fondi i sigurimit pensional invalidor në Maqedoninë e Veriut** kryen shpërndarjen e kontributeve për sigurimin pensional midis shtyllës së parë dhe të dytë dhe kryen transferim të kontributeve dhe të dhënave vetjake të anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme të zgjedhura të shtyllës së dytë. Çdo shoqëri e cila menaxhon me fond pensional të detyrueshëm ka për detyrë të paguaj kompensim mujor në Fondin e PIOSM në masën prej 0,1% nga çdo kontribut të paguar në muajin e mëparshëm në fondin pensional të detyrueshëm me të cilin menaxhon.

Shoqëria pensionale është shoqëri aksionere që është themeluar dhe punon në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe me Ligjin për sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital dhe Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital. Shoqëri pensionale themelohet në bazë të licensës nga MAPAS dhe menaxhon me fondin pensional në bazë të udhëzimeve për menaxhimin me fondin pensional. Shoqëri për menaxhimin me fondin pensional të detyruar është themeluar dhe menaxhon vetëm me fondet pensionale të detyrueshëm, shoqëri për menaxhim me fondet pensionale vullnetare është themeluar dhe menaxhon vetëm me fondet pensionale vullnetare ndërsa shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare është themeluar dhe menaxhon me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Shoqëria për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare duhet të kenë kapital themelor në shumën jo më të vogël se 1,8 milion euro e konvertuar në denarë sipas kursit mesatar të bankës popullore të RMV, shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme duhet të kenë kapital themelor jo më të vogël se 1.5 milion euro dhe shoqëri për menaxhim me fondet pensionale vullnetare duhet të ketë kapital themelor jo më pak se 0,5 milion euro. Në rast të ritjes të mjeteve në fondin

pensional të detyrueshëm dhe /ose vullnetarë me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar ta ris kapitalin themelor në përputhje me dispozitat ligjore. Veprimtaria e vetme e shoqërive pensionale është menaxhimi i fondeve pensionale përfaqësimin e tyre para personave të tretë dhe aktivitete që dalin direkt nga kryerja e punës për menaxhimin me fondet pensionale. Përgjegjësitë dhe aktivitetet themelore të shoqërive pensionale janë: anëtarësimi, menaxhimi me mjetet, menaxhimi me rreziqet dhe mekanizmat kontrollues për zbutjen e rreziqeve, administrimin dhe mbajtjen e evidencës, respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore, informim të regullt të anëtarëve, të publikut dhe të MAPAS, pagesën e tërheqjeve të programuara të anëtarëve në pension etj.

Shoqëria pensionale punon në përputhje me rregullat për menaxhim korporativ të mirë të shoqërisë dhe ka detyrim fiduciar të punoj vetëm në interes të interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve që janë në pension të fondit pensional me të cilin menaxhon e cila duhet ta zbatoj me zbatimin e standarteve të larta të etikës dhe integritetit dhe pa konflikt interesi. Për kryerjen e këtyre funksioneve shoqëria pensionale në përputhje me ligjin arkëton tre lloje kompensimesh. (Më shumë detaje për kompensimet ka në kapitujt 5.7 dhe 6.7.)

Fondi pensional (i detyrueshëm ose vullnetar) përfaqëson fond investues të hapur që themelohet dhe punon në përputhje me Ligjin për investimin e fondeve, nëqoftëse me ligjin për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital ose me Ligjin për sigurimin pensional me financim kapital vullnetar nuk është rregulluar ndryshe. Fondin pensional i detyrueshëm e përbëjnë kontributet me mjetet e anëtarëve, mjetet e anëtarëve në pension dhe kontributet nga investimi i kontributeve dhe mjeteve të zvogëluara për kompensimet që arkëtohedn nga fondi pensional i detyrueshëm. Fondin pensional vullnetar e përbëjnë kontributet vullnetare të paguara në emër dhe për llogari të anëtarëve, mjetet e anëtarëve, mjetet e anëtarëve në pension dhe kontributet nga investimi i kontributeve dhe mjeteve të zvogëluara për kompensimet që arkëtohedn nga fondi pensional vullnetar. Pronarët e fondit pensional janë anëtarët e tij dhe anëtarët në pension ndërsa të drejtat e veçanta e pronësisë të tyre janë përcaktuar nga shuma e mjeteve në llogarit e tyre. Mjetet e fondit pensional nuk mund të jenë objekt i kërkesave as edhe mbi këto mjete mund të zbatohen përmbarime nga ana e ose në emrin e kreditorëve të shoqërisë pensionale që menaxhon me atë fond pensional.

Në vitin 2005, MAPAS nëpërmjet tenderit publik ndërkombëtar lëshoi dy licenca për themelim të shoqërive me të cilin ishin themeluar dy shoqëri për menaxhimin me fondet pensionale ndërsa në vitin 2009 MAPAS dy shoqërive aktuale për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme i lëshoi lejë për kryerje veprimtarie-menaxhim me fondet pensionale vullnetare dhe aprovim për menaxhim me fondin pensional vullnetar. Gjatë vitit 2017 dhe gjysma e parë e vitit 2018 u zbatua procesi i shitjes të shoqërisë aksionere për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Nov Penziski Fond" Shkup ose u krye transferimi 100% të aksioneve të lëshuara nga NLB Nov Penziski Fond AD Shkup³ në Pozavorovallnica Sava d.d Ljubana, Republika e Sllovenisë. Në qershor të vitit 2018 MAPAS dha aprovim për ndryshim të emrit të shoqërisë Shoqëri Aksionere për menaxhim me fondet pensional të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Nov Penziski Fond" Shkup në Shoqëri për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava shoqëri pensionere a.d Shkup, dha aprovim për ndryshim të emrit të fondit pensional Fond Pensional i detyrueshëm i hapur – „NLB fond pensional“ Shkup në fond pensional i detyrueshëm i Hapur Sava fond pensional dhe dha aprovim për ndryshimin e emrit të fondit pensional Fond Pensional vullnetar i hapur Cava – „NLB Penzija plus“ Shkup në Fond pensional vullnetar i hapur në Sava penzija plus. Në vitin 2019, МАПАС dha lejë për themelimin e shoqërisë për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme Zavorovallnica Triglav DD Ljubana, Republika e Sllovenisë dhe aprovim për menaxhim me fondin pensional vullnetar.

Më 31.12.2020, në RMV ekzistojnë tre shoqëri pensionale të cilat menaxhojnë me nga një fond të detyrueshëm dhe me nga një fond vullnetar siç është pasqyruar në tabelën 2.1.

³ Aksioner të shoqërisë aksionere për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare "NLB Nov penziski fond" Shkup ishin Nova Ljubanska banka, DD, Ljubana, Republika e Sllovenisë e cila merrte pjesë 51% në kapitalin themelor të shoqërisë dhe NLB banka Ad Shkup Republika e Maqedonsië së Veriut e cila merrte pjesë me 49% në kapitalin themelor të shoqërisë

Tabela 2.1. Shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale në RMV

Shoqëria për menaxhim të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare Sava shoqëri pensionale a.d. Shkup	KB Shoqëria e parë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare AD Shkup	Shoqëria për menaxhim të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare TRIGLAV SHOQËRI PENSIONALE AD Shkup
e cila menaxhon me:	e cila menaxhon me:	e cila menaxhon me:
- Fond pensional i detyrueshëm i hapur Fondi pensional Sava - Fond pensional i detyrueshëm i hapur Fondi penzional Sava pension plus	- KB Fond i parë pensional i detyrueshëm i hapur – Shkup - KB Fond i parë penzional vullnetar i hapur – Shkup	- Triglav Fondi pensional i detyrueshëm i hapur – Shkup - KB Fond pensional vullnetar i hapur – Shkup
Ruajtës i pasurisë së fondeve pensionale: NLB Banka AD Shkup	Ruajtës i pasurisë së fondeve pensionale: Shparkase Makedonija AD Shkup	Ruajtës i pasurisë së fondeve pensionale: Komerzijallna banka AD Shkup
Aksioner: -Pozavavarovalnica Sava d.d Lubjana, Republika e Sllovenisë - 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.	Aksionerë: -Skupina Prva zovarovallniski holding DD, Lubjana, Republika e Sllovenisë - 51% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë -Komerzijallna Banka Ad Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut - 49% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë	Aksioner: -Zavarovallnica Triglav DD Lubjana, Republika e Sllovenisë - 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë
Kapitali themelues: 2,1 milion EURO	Kapitali themelues: 1,8 milion EURO	Kapitali themelues: 2,1 milion EURO

Një nga shoqëritë pensionale ka kombinim të aksionereve të vendit (49% pjesëmarrje) dhe të huaj (51% pjesëmarrje) ndërsa dy shoqëritë pensionale kanë të njëjtin aksioner të jashtëm (100% pjesëmarrje). Aksionerët e tre shoqërive pensionale janë përmendur në tabelën 2,1.

Mjetet e fondit pensional janë tërësisht të ndarë nga mjetet e shoqërisë që menaxhon me këtë fond dhe ruhen në bangën ruajtëse të pasurisë. Kjo ndarje e mjeteve është e rëndësishë së veçantë me qëllim që të arihet një nivel i lartë sigurie të mjeteve dhe kontroll suplementar të transaksioneve me mjetet e fondit penzional. Funkcioni – ruajtës i pasurisë edhe për fondet pensionale të detyrueshme edhe për ato e kryejnë bankat tregtare që përmbushin kushtet ligjore vullnetare dhe me të cilat shoqëria ka lidhur kontrata për ruajtjen e pasurisë të fondeve pensionale. Të tre shoqëritë pensionale kanë zgjedhur ruajtës të pasurisë për dy fondet pensionale me të cilat ato menaxhojnë siç është treguar në tabelën 2,1. Për funksionin e vet të ruajtjes së pasurisë të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare kujdestarëve të pasurisë i paguhet kompensim nga shoqëritë pensionale. Kompensimet përlllogariten si përqindje nga mjetet e fondeve pensionale në përputhje me kontratat e lidhura për ruajtjen e pasurisë të fondeve pensionale. Në tabelën 2.2 është dhënë një pasqyrë të kompensimeve që i paguhet kujdestarëve të pasurisë nga shoqëritë pensionale për vitin 2020.

Tabela 2.2 Kompensime të cilat i paguhen kujdestarëve të pasurisë nga shoqëritë pensionale për ruajtjen e pasurisë së fondeve pensionale

Për fondet e detyruara pensionale	Shuma (në nivel vjetor)	Për vlerën e mjeteve (në miliona euro)	Data e zbatimit
Sparkasse Maqedoni AD Shkup si kujdestare e pronës së KBPz		0,036%	3 Tetor v. 2019
		0,034%	3 tetor v. 2020
		0,032%	3 tetor v. 2021
		0,030%	3 tetor v. 2022
Komercijalna Banka AD Shkup si kujdestar i pronës së SAVAz	0,092%	deri në 100	21 korrik v. 2015
	0,087%	mbi 100 deri në 200	
	0,077%	mbi 200 deri në 300	
	0,070%	mbi 300 deri në 400	
	0,064%	mbi 400 deri në 500	
	0,060%	mbi 500 deri në 600	
	0,053%	mbi 600 deri në 700	
	0,046%	mbi 700 deri në 800	
	0,042%	mbi 800 deri në 900	
	0,034%	mbi 900	
NLB Banka AD Shkup si kujdestar i pasurisë së SAVAz	0,058%	deri në 100	4 prill v. 2019
	0,055%	mbi 100 deri në 200	
	0,050%	mbi 200 deri në 300	
	0,048%	mbi 300 deri në 400	
	0,040%	mbi 400 deri në 500	
	0,037%	mbi 500 deri në 600	
	0,035%	mbi 600 deri në 700	
	0,032%	mbi 700 deri në 800	
	0,029%	mbi 800 deri në 900	
	0,025%	mbi 900 deri në 1000	
Komercijalna Banka AD Shkup si kujdestar i pronës së TRIGLAVz	0,050%	deri në 50	1 prill v. 2019
	0,041%	mbi 50 deri në 100	
	0,038%	mbi 100 deri në 200	
	0,035%	mbi 200 deri në 300	
	0,033%	mbi 300 deri në 400	
	0,028%	mbi 400 deri në 500	
	0,026%	mbi 500 deri në 600	
	0,025%	mbi 600 deri në 700	
	0,023%	mbi 700 deri në 800	
	0,020%	mbi 800 deri në 900	
	0,018%	mbi 900 deri në 1000	
	0,017%	mbi 1000	
Për fondet e detyruara pensionale	Shuma (në nivel vjetor)	Për vlerën e mjeteve (në miliona euro)	Data e zbatimit
Sparkasse Maqedoni AD Shkup si kujdestar i pronës së KBPz		0,06%	3 tetor v. 2018
Komercijalna Banka AD Shkup si kujdestarë i pronës së SAVAd	0,25%	deri në 50	15 korrik v. 2009
	0,20%	mbi 50	
NLB Banka AD Shkup si kujdestarë i pasurisë së SAVAd	0,180%	deri në 50	4 prill v. 2019
		mbi 50	

3. Ndryshime dhe shtesa të akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë financimin kapital të sigurimin pensional

3. Ndryshime dhe shtesa të akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë financimin kapital të sigurimit pensional

Gjatë vitit 2020 janë marë dy urdhëresa me fuqi ligjore për sa i përket financimit kapital të sigurimit pensional, nga ana tjetër gjatë viti 2020 Këshilli i ekspertëve të MAPAS miratoi pesë ndryshime të rregulloreve për sa i përket sigurimit pensional me financim kapital të detyrueshëm ose vullnetar

Gjatë vitit 2020 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi dy urdhëresa me fuqi ligjore për sa i përket zbatimit të dispozitave të ligjeve që i përkasin sigurimit pensional me financim kapital dhe konkretisht:

1. Urdhëresa me fuqi ligjore për zbatimin e dispozitave të Ligjit për sigurim pensional me financim kapital të detyrueshëm për kohën e gjendjes së jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e RMV“ nr.94/2020 dt 7.4.2020) dhe
2. Urdhëresa me fuqi ligjore për zbatimin e dispozitave të Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga financimi kapital i sigurimit pensional për kohën e gjendjes së jashtëzakonshme („Gazeta zyrtare e RMV“ nr.94/2020 dt 7.4.2020)

Këto dy urdhëresa për atë kohë sa zgjat gjendja e jashtëzakonshme në vend në kushte të pandemisë të virusit Korona. Në përputhje me urdhëresën që i përket Ligjit për sigurim pensional me financim kapital të detyrueshëm, afatet janë përcaktuar për marjen e veprimeve të veçanta nga ana e MAPAS për sa i përket liçensimit dhe provimit për agjentët ndërsa në lidhje me procedurat drejtuese vazhdojnë të rrjedhin për kohën e zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe vazhdojnë edhe pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme. Në përputhje të urdhëresës që i përket Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital, afatet të cilat në bazë të Ligjit për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga sigurimi pensional me financim kapital janë përcaktuar për marjen e veprimeve të veçanta të Fondit të PIOSM në procedurën për realizimin e të drejtës për pension pleqërie nga shtylla e dytë të cilave i kalon afati gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme pushojnë të rrjedhin gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme dhe vazhdojnë pas mbarimit të gjendjes së jashtëzakonshme por vetëm për aq ditë sa ngelën dhe konkretisht nga dita e mbarimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2020 MAPAS përgatiti ndryshime dhe plotësime të akteve nënligjore ekzistuese që i përkasin sigurimit pensional me financim kapital të detyrueshëm ose vullnetar dhe konkretisht:

1. Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për rregullat dhe standartet minimale për përcaktimin e normave të kamatave („Gazeta zyrtare e RMV“ “ nr.6/2020 dt, 10.1.2020);
2. Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për rregullat dhe standartet minimale për përcaktimin e normave të kamatave („Gazeta zyrtare e RMV“ “ nr.174/2020 dt 30.6.2020);
3. Rregullore për ndryshim të Rregullores për mënyrën dhe procedurën e marketingut të fondeve pensionale („Gazeta zyrtare e RMV“ “ nr.116/2020 dt 5.5.2020);
4. Rregullore për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për mënyrën e anëtarësisë në fondin pensional vullnetar („Gazeta zyrtare e RMV“ “ nr.211/2020 dt.2.9.2020);

5. Rregullore për ndryshim dhe plotësi të Rregullores për njoftimin e Agjensisë për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital nga ana e Kujdestarit të pasurisë („Gazeta zyrtare e RMV“ “ nr.294/2020 dt 11.12.2020);

Ndryshimet në rregulloret ishin kryer për shkak të precizimit të procedurave të caktuara dhe rakordimin me ndryshimet me aktet relevante. Pikërisht me ndryshimet në rregullore që i përket rregullave dhe standarteve minimale për përcaktimin e normave të kamatave krye plotësim të dispozitës që i përket kushteve për përcaktimin e normës nominale të kamatës në raste kur fondi punon më pak se tre vite kalendarike rishikohet dhe preçizohet në standartet minimale për zgjedhje të normës së kamatës për faktor anuitetit të lidhura me letrat me vlerë shtetërore afatmesëme dhe afatgjate dhe u përcaktua se norma e kamatës që pëdoret për përllogaritje nuk duhet të jetë më e vogël se zero. Më pas me ndryshimin e rregullores që i përket marketingut të fondeve pensionale ndërpre detyrimi i shoqërive pensionale, materialet e marketingut të shpallura në formë audio të përmbajnë informacione të MAPAS me qëllim që të ritet efektiviteti për informin të publikut nëpërmjet marketing materiale të radios dhe të zvogëlohet mundësia e konfuzionit me të dhënat e kontaktit të MAPAS dhe shoqërive pensionale. Me ndryshimin e Rregullores së anëtarësisë në fondin vullnetar shpjegohet në mënyrë të plotë dispozita që i përket prishjes së kontratës për anëtarësi në fondin pensional vullnetar midis paguesit dhe anëtarëve dhe kryhet plotësim i dispozitave që i përkasin transferimit të mjeteve nga llogaria profesionale në llogari vullnetare individuale me të cilën konfirmohet se nëqoftëse pjesëmarsi në skemën pensionale profesionale është anëtar i pensionuar shoqëria i ruan mjetet në llogarinë profesionale. Me ndryshimin e Rregullores për njoftim të Agjensisë për supervizion të financimit kapital të sigurimit pensional nga ana e Kujdestarit të pasurisë u përputhën dispozitat me Rregulloren për vlerësim të mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, përputhje të cilën shoqëritë pensionale gjatë përcaktimit të vlerës së tregut për një pjesë të caktuar të letrave me vlerë me të cilën tregëtohet në tregun e BE dhe vendet anëtare OECD, krahas Bloomberg mund të përdoren informacionet për instrument financiar dhe nga servisi financiar-informativ Refinitiv.

Gjatë vitit 2020 MAPAS i azhurnoi udhëzimet eksistuese dhe përgatiti të reja dhe miratoi udhëzimet e mëposhtme:

1. Udhëzim për plotësimin e raporteve për kursimin pensional (Janar 2020);
2. Udhëzim teknik për agjentët e shoqërive pensionale (Maj 2020);

4. Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale

4.1. Të ardhura dhe shpenzime të shoqërive pensionale për vitin 2020

4.2. Rezultati financiar i shoqërive pensionale

4.3. Kapitali, Kapitali themelor dhe mjetet e veta të shoqërive pensionale

4.4. Indikatorë

4. Të dhëna për punën financiare të shoqërive pensionale

Shoqëritë pensionale me punën e vet financiare za përgatisin raporte financiare në përputhje me Ligjin për shoqëri tregtare, me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e raporteve financiare të shoqërive financiare dhe me Rregulloren për mbajtjen e kontabilitetit dhe standartet e vlefshme ndërkombëtare të kontabilitetit. Të dhënat në bazë të cilave bëhen analiza në këtë kre janë nga raportet financiare vjetore të parishikuara të tre shoqërive pensionale deri më 31.12.2020.

4.1. Të ardhura dhe shpenzime të shoqërive pensionale për vitin 2020

Për kryerjen e veprimtarisë së vetme – menaxhim me mjetet e fondeve pensionale, shoqëritë pensionale financiohen nëpërmjet kompensimeve ligjore të përcaktuara, domethënë i paguhet kompensim nga kontributet, kompensim nga mjetet e fondeve pensionale dhe kompensim për kthim. Gjithashtu shoqëritë pensionale kanë të ardhura financiare si rezultat i investimeve të mjeteve monetare të lira në depozita dhe letra me vlerë të cilat janë lejuar në përputhje me Ligjin për sigurim pensional ma financim kapital vullnetar. Të ardhurat nga tre shoqëritë pensionale për vitin 2020 janë pasqyruar në tabelën 4.1.

Tabela 4.1. Të ardhurat e shoqërive pensionale për vitin 2020. (në denarë)

BAZA	SAVA		KB SË PARI		TRIGLAV	
Të ardhura nga menaxhimi i fondit të detyruar pensional						
Kompensim nga kontributet	86.584.659	33,57%	94.206.834	32,92%	4.200.769	44,02%
Kompensim nga mjetet	134.526.679	52,16%	150.520.633	52,60%	2.639.638	27,66%
Kompensim nga transferimi	3.776	0,00%	2.790	0,00%	1.851	0,02%
Totali i të ardhurave të menaxhimit të fondit të detyruar pensional	221.115.114	85,73%	244.730.257	85,52%	6.842.258	71,70%
Të ardhura nga menaxhimi i fondit vullnetar pensional						
Kompensim nga kontributet	4.161.449	1,61%	4.216.912	1,47%	0	0,00%
Kompensim nga mjetet	12.471.639	4,84%	9.317.016	3,26%	0	0,00%
Kompensim nga transferimi	0	0,00%	0	0,00%	0	0,00%
Totali i të ardhurave të menaxhimit të fondit të detyruar pensional	16.633.088	6,45%	13.533.928	4,73%	0	0,00%
Të ardhura financiare	17.884.298	6,93%	25.877.053	9,04%	2.628.117	27,54%
Të ardhura të tjera të shoqërisë	2.296.995	0,89%	2.019.805	0,71%	72.471	0,76%
Totali i të ardhurave	257.929.495	100,00%	286.161.043	100,00%	9.542.846	100,00%

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre të vetme, shoqëritë pensionale në përgjithësi kanë shpenzime për menaxhim me mjetet e fondeve pensionale, për vlerësimin e mjeteve, për anëtarësimin, mbajtjen e llogarive të anëtarëve dhe për informimin të anëtarëve si dhe për pagesën e kompensimeve për MAPAS, për Fondin PIOSM dhe për Kujdestarin e pasurisë dhe për mbulimin e shpenzimeve lidhur: shpenzime për menaxhimin e fondit pensional të detyrueshëm dhe shpenzime për menaxhimin e

fondit pensional vullnetar dhe shpenzime nga menaxhimi me shoqëritë. Shpenzimet e tre shoqërive pensionale në vitin 2020 janë pasqyruar në tabelën 4.2.

Tabela 4.2. Shpenzimet e shoqërive pensionale për vitin 2020* (në denarë)

BAZA	SAVA		KB PRVO		TRIGLAV	
Të ardhura nga menaxhimi i fondit të detyruar pensional						
Shpenzime për agjentët e shoqërisë	929.055	0,61%	854.595	0,65%	3.041.533	7,29%
Shpenzime për marketing	10.621.718	6,98%	7.438.096	5,69%	2.150.196	5,15%
Shpenzime për transaksione	38.559	0,03%	0	0,00%	0	0,00%
Shpenzime për MAPAS	34.608.160	22,75%	37.654.926	28,82%	1.685.603	4,04%
Shpenzime për kujdestarin e pasurisë	13.456.118	8,84%	14.878.157	11,39%	369.213	0,88%
Shpenzimet për Fondin PIOSM	4.277.862	2,81%	4.709.521	3,60%	208.698	0,50%
Shpenzime të tjera nga menaxhimi me fondin	1.150.830	0,76%	1.137.429	0,87%	1.222.112	2,93%
Shpenzime totale për menaxhimin me fondin e detyruar pensional	65.082.302	42,77%	66.672.724	51,03%	8.677.355	20,79%
Shpenzime për menaxhimin me fondin vullnetar pensional						
Shpenzime për agjentët e shoqërisë	3.774.829	2,48%	581.579	0,45%	0	0,00%
Shpenzime për marketing	731.018	0,48%	718.180	0,55%	0	0,00%
Shpenzime për transaksione	33.932	0,02%	0	0,00%	0	0,00%
Shpenzime për MAPAS	1.293.467	0,85%	1.240.577	0,95%	0	0,00%
Shpenzime për kujdestarin e pasurisë	1.881.324	1,24%	623.137	0,48%	0	0,00%
Shpenzimet për Fondin PIOSM	56.183	0,04%	67.565	0,05%	0	0,00%
Shpenzime të tjera nga menaxhimi me fondin	7.770.753	5,11%	3.231.038	2,47%	0	0,00%
Shpenzime për menaxhimin me shoqërinë pensionale						
Pagesa dhe kompensime për punonjësit	49.458.717	32,51%	35.852.733	27,44%	15.978.212	38,28%
Shpenzime për shërbimet	14.593.653	9,59%	6.211.414	4,75%	10.032.386	24,03%
Shpenzime për lëndë të para dhe materiale të tjera	1.022.806	0,67%	1.023.211	0,78%	527.526	1,26%
Amortizimi	1.850.417	1,22%	4.175.263	3,20%	2.919.576	6,99%
Shpenzime financiare	132.541	0,09%	5.010.332	3,84%	0	0,00%
Shpenzime të tjera të punës	11.987.619	7,88%	7.059.157	5,40%	2.802.448	6,71%
Rezervime për shpenzime dhe rreziqe	255.471	0,17%	1.408.530	1,08%	806.253	1,93%
Shpenzime në total nga menaxhimi me shoqërinë	79.301.224	52,12%	60.740.640	46,49%	33.066.401	79,21%
Shpenzime në total	152.154.279	100,00%	130.644.402	100,00%	41.743.756	100,00%


* Për shpenzimet, të dhënat, të cilat nuk mundën të ndahen sipas fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar shoqëria pensionale si masë për ndarje përdor numrin e anëtarëve në fondin pensional të detyrueshëm dhe atë vullnetar.

Në kuadër të pjesës së të ardhurave edhe tek SAVA edhe tek KB Prvo shënohet një ritje të ardhurave totale në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 prej 6% tek SAVA dhe 5% tek KB Prvo. Më pa pjesa më e madhe tek SAVA dhe KB Prvo në vitin 2020 rrjedh nga kompensimet nga mjetet nga fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (rreth 57% tek SAVA dhe 56% tek KB Prvo), më pas pason kompensimi nga kontributet në fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (rreth 35% tek SAVA dhe 5% tek KB Prvo). Në krahasim me vitin e kaluar tek të dy shoqëritë pensionale përqindja e pjesëmarjes të të ardhurave nga kompensimet nga kontributet në totalin e të ardhurave u zvogëlua me pesë pikë në përqindje tek SAVA dhe katër pikë në përqindje tek KB Prvo. Pjesëmarja e të ardhurave nga kompensimet nga mjetet në përqindje është ritur rreth pesë pikë në përqindje edhe tek SAVA edhe tek KB Prvo. Në krahasim me vitin 2019 pjesëmarja në përqindje të ardhurave financiare tek SAVA ngelet afërsisht në të njëjtin nivel ndërsa tek KB Prvo është ulur për rreth një pikë përqindjeje. Pjesëmarja në përqindje e të ardhurave të tjera të shoqërive është më e vogël dhe ngelet afërsisht në të njëjtin nivel me vitin e kaluar tek të dy shoqëritë pensionale.


Në kuadër të pjesës së shpenzimeve për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 edhe tek SAVA edhe tek KB Prvo shënohet një ulje të shpenzimeve totale dhe konkretisht rreth 0,5 % tek SAVA dhe 2,5% tek KB Prvo. Kështu që tek SAVA pjesën më të madhe të shpenzimeve ose rreth 52% e shpenzimeve i përkasin punës së shoqërisë në të cilën shpenzimet më të mëdha janë për rrogat dhe kompensimet e punonjësve më pas vijnë shpenzimet për shërbime dhe shpenzime e tjera nga puna tek KB Prvo në vitin 2020 shpenzimet e që i përkasin punës së shoqërisë zënë rreth 46 %. Përsëri pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve i përkasin shpenzimeve për rroga dhe kompensime për punonjësit dhe pas tyre vijnë shpenzimet e tjera nga puna dhe shpenzimet për shërbime. Pjesa tjetër prej 54% e shpenzimeve të KB Prvo i përkasin shpenzimeve për menaxhim me fondet pensionale. Tek SAVA shpenzimeve për menaxhim me fondet pensionale janë në masën rreth 48%. Pastaj vijnë shpenzimet për marketing dhe agjent që janë rreth 11% të shpenzimeve totale tek SAVA dhe rreth 7% të shpenzimeve totale tek KB Prvo që do të thotë krahasuar me vitin e kaluar tek të dy shoqëritë pensionale pjesëmarja e këtyre shpenzimeve ngeli afërsisht në të njëjtin nivel. Rreth 37% të shpenzimeve tek SAVA dhe 45% të shpenzimeve tek KB Prvo i përkasin kompensimeve për MAPAS, Fondit të PIOSM dhe rritjesve të pasurisë.

TRIGLAV filloi me aktivitete për menaxhimin e fondeve pensionale dhe me punë marketingu të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar dhe studim të mendimit publik nga dt 1.4.2019. Deri në fund të vitit 2020 në Triglav fondi pensional vullnetar –Shkup akoma nuk kishte evidentuar pagesë të kontributit vullnetar. Ose në vazhdimësi deri më 31.12.2020 punon vetëm Triglav fondi pensional i detyruar i hapur. Kështu që edhe të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2020 të TRIGLAV janë të lidhura vetëm me fondin pensional të detyruar. Duket një dallim domethënës në shumat dhe ndarjet e të ardhurave dhe shpenzimeve në krahasim me SAVA dhe KB Prvo të cilat punojnë pesëmbëdhjetë vite. Tek TRIGLAV tek ana e të ardhurave pjesëmarje më të madhe kanë të ardhurat nga kompensimet nga kontributet konkretisht rreth 44% e të ardhurave totale. Të ardhurat nga kompensimi i mjeteve kanë pjesëmarje më të vogël rreth 28 %. Kjo ishte e pritshme pasi në vitet e para të punës të fondit mjetet në fondin pensional të detyruar janë në një masë më të vogël. Pjesëmarje domethënëse (rreth 28%) të ardhurave totale në TRIGLAV kanë të ardhurat financiare që i detyrohet madhësisë së shumës të mjeteve të veta të cilat i investon shoqëria dhe madhësinë e kapitalit themelues. Për sa i përket shpenzimeve pjesën më të madhe të shpenzimeve rreth 79% të shpenzimeve i përkasin punës së shoqërisë ku më të mëdha janë shpenzimet për rroga dhe kompensime të punonjësve pastaj pasojnë shpenzimet për shërbime dhe shpenzime të tjera nga puna. Shpenzimet për menaxhim me fondin pensional të detyrueshëm janë rreth 21%. Më pas shpenzimet për marketing dhe agjentë janë rreth 12 % të shpenzimeve totale. Rreth 5% të shpenzimeve i përkasin kompensimeve për MAPAS, Fondit PIOSM dhe për Kujdestarit e pasurisë dhe rreth 3% janë shpenzimet e tjera për menaxhim me fondin pensional të detyrueshëm.

Grafik 4.1. Struktura e të ardhurave sipas shoqërive për vitin 2019 dhe 2020



Grafik 4.2. Struktura e shpenzimeve sipas shoqërive për vitin 2019 dhe 2020



4.2. Rezultati financiar i shoqërive pensionale

SAVA dhe KB Prvo edhe gjatë vitit 2020 realizuan rezultat financiar pozitiv. Të dy shoqëritë pensionale e mbyllën vitin 2020 me fitim-neto (fitim pas tatimit). KB Prvo ka realizuar fitim-neto më të madh nga SAVA kjo më shumë i detyrohet faktit se KB Prvo ka realizuar të ardhura më të mëdha, dhe njëkohësisht ka shpenzime më të vogla se SAVA për vitin 2020. Të dy shoqëritë pensionale në vitin 2020 shënojnë një fitim-neto më të madh krahasuar me vitin 2019 dhe konkretisht SAVA për 18 % dhe KB Prvo për 13%. Gjithashtu të dy shoqëritë pensionale realizuan fitim total gjithpërfshirës dhe konkretisht SAVA në masën 97 milion denarë dhe KB Prvo në masën 140 milion denarë. Fitimi i akumuluar (deri më 31.12.2020) i SAVA ka qenë rreth 354 milion denarë dhe i KB Prvo kap shumën 369 milion denarë. TRIGLAV shënon rezultat financiar negativ edhe gjatë vitit të dytë. Rezultati i këtillë është i zakonshëm dhe i pritshëm për vitet fillestare të punës të një shoqëri pensionale. TRIGLAV punon vetëm me fondin pensional të detyrueshëm në të cilin akoma anëtarësojnë relativisht një numër i vogël anëtarësh dhe mjetet janë të një vëllimi më të vogël që ndikon në masën më të vogël të ardhurave nga njëra anë ndërsa nga ana tjetër ka shpenzime domethënëse për arsye të vendosjes së sistemit, infrastrukturës së shoqërisë dhe punonjësve, shpenzime për marketing si dhe shpenzime aktuale për menaxhimin me fondin. Të dhëna më të detajuara për rezultatin financiar për shoqëritë pensionale janë pasqyruar në tabelën 4.3.

Tabela 4.3. Rezultate financiare të shoqërive pensionale për vitin 2020 (në denarë)

Përshkrimi*	SAVA	KB prvo	TRIGLAV
Fitimi / Humbja (për vitin 2020)	105.775.216	155.516.640	-32.200.910
Fitimi / Humbja pas tatimit (për vitin 2020)	97.420.623	139.764.187	-32.200.910
Shpenzime të jashtëzakonshme	0	0	0
Fitimi neto (për vitin 2020)	97.420.263	139.764.187	-32.200.910
Fitimi tjetër gjithëpërfshirës**	7.169.000	0	0
Fitimi total gjithëpërfshirës***	104.589.263	139.764.187	-32.200.910
Fitimi i akumuluar / Humbja e transferuar (deri më 31.12.2020)	354.319.402	369.044.604	-32.200.910

*Të dhëna për fitimin tjetër gjithëpërfshirës dhe për fitimin total gjithëpërfshirës janë nga raportet financiare të rishikuara të shoqërive pensionale për vitin 2020.

**Të dhëna për fitim tjetër gjithëpërfshirës përfshin fitime ose humbje të përcaktuara të cilat nuk janë pasqyruar në bilancin e suksesit.

***E dhëna për fitimin total gjithëpërfshirës përfshin fitimin –neto dhe fitimin tjetër gjithëpërfshirës

4.3. Kapitali, Kapitali themelor dhe mjetet e veta të shoqërive pensionale.

Të një rëndësie të madhe për sistemin dhe për anëtarët është shoqëritë pensionale të jenë të forta dhe institucione stabël dhe të kenë kapital themelor adekuat. Të tre shoqëritë pensionale duhet të kenë kapital themelor na masën jo më të vogël 1,8 milion Euro të konvertuar në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore në PMV. Në rast të ritjes së mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, shoqëria është e detyruar që të rit kapitalin në përputhje me dispozitat ligjore.

Kapitali themelor i shoqërisë pensionale paguhet vetëm me mjete monetare. Me qëllim që të rritet fuqia financiare e shoqërive pensionale nuk lejohet kapitali themelor të ketë origjinë nga borxhe dhe kredite dhe nuk mund të jetë i ngarkuar në asnjë mënyrë. Kapitali themelor i shoqërisë duhet të ketë origjinën nga burime të ligjshme dhe të jetë i taksuar në përputhje me rregullat në RMV dhe me rregullat e vendit në të cilën çdo aksioner i huaj është themeluar si person juridik.

Shoqëria është detyruar në çdo kohë që ta mbaj shumën e kapitalit por jo më pak gjysma e shumës të kapitalit themelor. Shoqëria është detyruar në çdo kohë që të mbaj mjete të veta në shumën jo më të vogël se gjysma e kapitalit kryesor.

Tabela 4.4. Kapitali, kapitali themelor dhe mjetet e veta të shoqërive pensionale (në denarë)

Përshkrimi	SAVA	KB prvo	TRIGLAV
Kapitali dhe rezervat	631.328.656	656.471.715	133.181.832
Kapitali themelor	130.001.478	110.459.024	184.483.800
Kapitali shtesë mbi minimumin e përcaktuar me ligj	485,63%	594,31%	72,19%
Mjetet individuale*	554.696.956	608.150.692	118.165.222
Mjete shtesë (excess) individuale mbi minimumin e caktuar me ligj**	131,27%	124,72%	113,49%

*Mjete personale përlogariten në përputhje me Rregulloren për metodologjinë për përlogaritje të mjeteve të veta të shoqërisë pensionale.

** Në përputhje me detyrimin ligjor SAVA nga Janari i vitit 2020 është e detyruar që të mbaj kapital të rritur në krahasim me kapitalin themelor dmth kapital në shumën prej 7,8 milion Euro e konvertuar në denarë për shkak se madhësia e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me të cilat menaxhon e tejkaluan masën prej 600 milion euro. Ndërkohë që KB prvo nga gushti i vitit 2020 është e detyruar të mbaj kapital të rritur në krahasim me kapitalin themelor dmth kapital në shumën prej 8,8 milion euro e konvertuar në denarë pasi madhësia e mjeteve për fondin pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me të cilin menaxhon e tejkaloi shumën prej 700 milion euro.

4.4. Indikatore

Gjatë analizës të të dhënave financiare të shoqërive pensionale është e rëndësishme lëvizja e indikatorëve të veçantë për anëtar si dhe koeficienti i efikasitetit. Në tabelën 4.5 janë pasqyruar indikatorët më të rëndësishëm për anëtarë dhe koeficienti i efikasitetit për të tre shoqëritë pensionale për vitin 2020.

Tabela 4.5. Indikatorët (në denarë)

Përshkrimi	SAVA	KB prvo	TRIGLAV
Indikatorët për të ardhurat dhe shpenzimet për çdo anëtar			
Të ardhura mesatare për çdo anëtar	999,25	1.020,90	544,99
Shpenzime mesatare për çdo anëtar	589,46	466,08	2.384,00
Fitimi / Humbja për çdo anëtar	409,78	554,82	-1.839,00
Indikatorët e efikasitetit			
Koeficienti i efikasitetit (totali i shpenzime / totali i të ardhurave)	58,99%	45,65%	437,44%

Në krahasim me vitin 2019 të ardhurat mesatare për anëtarë shënojnë një ritje prej 3% edhe tek SAVA edhe tek KB Prvo ndërsa tek TRIGLAV shënojnë ulje prej 9%. Më pas në krahasim me vitin 2019 shpenzimet mesatare për anëtar tek të tre shoqëritë shënojnë ulje (3% tek SAVA, 5% tek KB Prvo dhe 9% tek TRIGLAV). Më pas tek të dy shoqëritë të cilat punojnë më shumë se pesëmbëshjetë vite ka rritje të fitimit për anëtarë në krahasim me vitin 2019 dhe konkretisht rreth 15% tek SAVA dhe rreth 10% KB Prvo. Gjithashtu vihet re se koeficienti i efikasitetit tek të dy shoqëritë tregon ulje në krahasim me vitin 2019 dhe konkretisht rreth 6% tek SAVA dhe rreth 8% tek KB Prvo. Triglav shënon humbje për anëtar edhe në vitin 2020 njëkohësisht edhe koeficienti i efikasitetit tregon përfshirje të madhe në shpenzimet totale në krahasim me të ardhurat totale.

Në grafikun 4.3 dhe tabela 4.6 është pasqyruar lëvizja e indikatorëve për përfitim ROA (fitimi-neto-mjetet totale) dhe ROE (fitimi-neto-kapitali), krahasuar me SAVA,KB Prvo për periudhën nga viti 2006 deri më 2020 edhe për TRIGLAV për vitin 2019 dhe vitin 2020. Mund të shihet se në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 norma e kthimit të mjeteve tek SAVA është afërsisht në të njëjtin nivel ndërsa tek KB Prvo shënon një ulje të vogël. Norma e kthimit të kapitalit në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 tek SAVA shënon një ritje prej 1 pikë përqindje ndërsa tek KB Prvo është afërsisht në të njëjtin nivel. Koeficientet ROA dhe ROE për TRIGLAV janë negativ edhe për vitin 2020 (-23% ROA dhe -24% ROE).

Grafik 4.3. ROA dhe ROE sipas shoqërive dhe sipas viteve




Tabela 4.6. Indikatorë për përfitim

Shoqëria pensionale	SAVA		KB prvo		TRIGLAV	
Viti / Përshkrimi	ROA	ROE	ROA	ROE	ROA	ROE
2006	-0,60%	0,00%	-2,69%	-4,45%		
2007	4,97%	5,57%	7,19%	10,19%		
2008	18,66%	20,55%	21,30%	28,53%		
2009	15,09%	16,26%	21,80%	26,54%		
2010	16,66%	17,60%	20,24%	23,00%		
2011	14,09%	14,75%	20,02%	22,03%		
2012	15,21%	15,84%	20,84%	22,31%		
2013	18,88%	19,68%	22,71%	23,80%		
2014	13,94%	15,09%	22,35%	23,71%		
2015	14,77%	15,65%	20,20%	21,00%		
2016	16,34%	17,34%	20,23%	21,09%		
2017	16,35%	17,23%	22,89%	23,78%		
2018	16,79%	17,49%	22,96%	23,71%		
2019	13,70%	14,26%	20,52%	21,24%	-10,99%	-11,55%
2020	14,13%	15,43%	19,66%	21,29%	-23,13%	-24,18%

5. Informacione për fondet pensionale të detyrueshme

- 5.1. Anëtarësi në fondet pensionale të detyrueshme**
- 5.2. Të dhëna për anëtarësim në fondet pensionale të detyrueshme**
- 5.3. Kalimi i një anëtari nga një fond në një fond tjetër pensional të detyrueshëm**
- 5.4. Kontribute në fondet pensionale të detyrueshme**
 - 5.4.1. Kompensim për transferime të vonuara të kontributeve
 - 5.4.2. Mjete të kthyer në Fondin PIOSM
- 5.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale të detyrueshme**
- 5.6. Mjetet - neto, njësitë kontabile dhe norma e kontributeve të fondeve pensionale të detyrueshme**
- 5.7. Kompensime të fondeve pensionale të detyrueshme**
- 5.8. Pagesa e pensioneve nga financimi kapital i sigurimit pensional të detyrueshëm**

5. Informacione për fondet pensionale të detyrueshme

5.1. Anëtarësi në fondet pensionale të detyrueshme

Një i siguruar mund të fitoj anëtarësi në fondin pensional të detyrueshëm në dy mënyra:

- 1) me nënshkrim të kontratës për anëtarësi në fondin pensional të detyrueshëm dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve që e mban MAPAS;
- 2) me shpërdarjen në fondin pensional të detyrueshëm me zgjedhje të rastit nga ana e Fondit PIOSM në rastin kur i siguruari i cili është i detyruar të bëhet anëtar i fondit pensional të detyrueshëm nuk ka nënshkruar kontratë për anëtarësim në periudhën e zgjedhjes të fondit pensional të detyrueshëm dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve që e mban MAPAS.

Ndryshimet dhe plotësimet të Ligjit për sigurim pensional me financim kapital të detyrueshëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.245/2018 ngaviti 28.12.2018 dhe nr.180/2019 dt.2.9.2019) parashikojnë disa ndryshime thelbësore për sa i përket qasjes në sigurimin pensional me financim kapital të detyrueshëm të cilat vlejnë deri më 1.1.2019

Pra ekzistojnë dy kategori të të siguruarish të cilët janë anëtarë të shtyllës së dytë:

- Anëtarë të detyruar –
 - » të siguruarit të cilët janë punësuar ose u regjistruan në sigurimin pensional dhe invaliditeti të detyrueshëm për herë të parë më 1 Janar të viti 2003 dhe kanë lindur pa 1 Janarit të vitit 1967;
 - » të siguruarit të cilët janë punësuar ose u regjistruan në sigurimin pensional dhe invaliditeti të detyrueshëm për herë të parë më 1 Janar 2019 dhe të cilët më datën e regjistrimit janë më të rinj se 40 vjeç.
- Anëtarë vullnetarë –
 - » të siguruarit të cilët janë punësuar për herë të parë para 1 Janarit të vitit 2003 të cilët me dëshirën e vet me lidhje kontrate për anëtarësi u qasën në sigurimin pensional me financim kapital të detyrueshëm dhe kanë lindur pas 1 Janarit të vitit 1967;
 - » të siguruarit të cilët janë punësuar për herë të parë para 1 Janarit të vitit 2003 të cilët me dëshirën e vet me lidhje kontrate për anëtarësi u qasën në sigurimin pensional me financim kapital të detyrueshëm dhe kanë lindur para 1 Janarit të vitit 1967 dhe nënshkruan deklarata për zgjatjen e anëtarësisë në sigurimin pensional me financim kapital të detyrueshëm;


Të siguruarit të cilëve stazhi i sigurimit i llogaritet me afat të zgjatur dhe të siguruarit që i përkasin kapitullit VII – „Fitimi dhe realizimi i të drejtave të kategorive të siguruarve të caktuar në kushte të veçanta nga Ligji për sigurim pensional dhe invaliditeti“ (të punësuar me stazh të shtuar nga MPB, shtëpitë ndëshkuese - korrigjuese, ARM dhe të ngjashme) nuk përfshihen në shtyllën dytë nëqoftëse kanë stazh të plotë të siguruar me afat të zgjatur i cili mundëson uljen e kufirit të vjetërsisë për fitimin e të drejtës të pensionit të pleqërisë përmë së pakti një vit. Kur të siguruarit të cilët janë anëtarë të fondit pensional të detyruar do ta mbushin stazhin e sigurimit me afat të zgjatur që mundëson uljen e kufirit të vjetërsisë për përfitimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për të paktën një vit në përputhje me nenin 118 paragrafi (3) i Ligjit për sigurim pensional dhe invaliditeti kanë të drejtën të zgjedhin ta zgjatën anëtarësinë në shtyllën e dytë me deklarata me shkrim për zgjatjen anëtarësisë në fondin pensional të detyrueshëm për një afat prej tre muajsh pas plotësimit të stazhit të sigurimit. Nëqoftëse këta anëtarë nuk japin mendim i ndërpritet anëtarësia në fondin pensional të detyrueshëm pas përfundimit të këtij afati.

5.2. Të dhëna për anëtarësim në fondet pensionale të detyrueshme

Të sigurvearit të cilët janë anëtarë të financimit kapital të sigurimit të detyruar pensional janë të detyruar të anëtarësohen në fondin pensional të detyrueshëm në një afat prej tre muajsh llogaritur nga data e punësimit të parë. Fondi i PIOSM ndërkohë i shpërdan këta të sigurvearit në fondet pensionale të detyrueshme me zgjedhje të rastit nga momenti i punësimit të tyre me qëllim që mjetet e tyre të investohen menjëherë pas punësimit. Nëqoftëse në afatin ligjor nuk nënshkruajnë kontratë për anëtarësim me asnjë shoqëri këta të sigurvearit ngelen anëtar të fondit pensional të detyrueshëm në atë fond ku kanë qenë të shpërndarë më përpara.

Ponderi sipas të cilit kryhet shpërndarja kohore e të sigurvearve në fondet pensionale të detyrueshme me zgjedhje të rastit u përcaktua nga ana e MAPAS për çdo fond pensional të detyrueshëm në ditën e parë të punës të çdo muaji. Ponder varet nga vlera e kompensimit nga kontributet që i arkëton shoqëria pensionale dhe nga kontributi në vlerë nominale që realizoni fondi pensional ku ndikim më të madhe ka kontributi (70%) në krahasim me kompensimin nga kontributet (30%)⁴. Ponderet që përdoren për shpërndarjen e të sigurvearve në fondet pensionale të detyrueshme gjatë vitit 2020 janë pasqyruar në grafikun 5.1.

Grafik 5.1. Ponderi për shpërndarjen e anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme



Më 1.4.2019 filloi punë fondi pensional i detyrueshëm TRIGLAVz me të cilin duke filluar nga prill 2019 të sigurvearit janë shpërndarë në tre fonde pensionale të detyrueshme. Me qëllim mbështetjen e punës në vitet fillestare të punës të fondit pensional të detyrueshëm dhe në përputhje me udhëzimet e definuara në rregullore për derisa fondi pensional i detyrueshëm ka punuar më pak se 12 muaj si vlerë për kontribut (për arsye të përlogaritjes të ponderit) meret mesatarja e kontributeve në shumë nominale në fondet pensionale të detyrueshme aktuale. Më pas nëqoftëse fondi ka punuar më pak se 36 muaj por më shumë se 12 atëhere si vlerë për kontribut (për arsye të përlogaritjes së ponderit) merret vlera më e madhe midis: kontributit në shumë nominale të fondit pensional të detyrueshëm dhe mesatares nga kontributet në shumë nominale të të gjithë fondeve pensionale të detyrueshme aktuale duke përfshirë edhe kontributin në shumë nominale të fondit pensional të detyrueshëm.

⁴ Formula për llogaritjen e ponderit është përshkruar në Rregulloren për anëtarësim në fondin pensional të detyrueshëm

Ky princip i shpërndarjes së të siguruarve është i justifikueshëm për arsye të nxitjes të konkurrencës në sigurimin pensional me financim kapital me qëllim që të rritet mundësia e zgjedhjes të fondeve pensionale për anëtarët dhe të nxiten rezultate më të mira investuese të fondeve pensionale. Në katër muajt e parë të vitit 2020 ponderet për të tre fondet pensionale të detyrueshëm kanë afërsisht të njëjtën vlerë duke patur parasysh se në llogaritjen e ponderit për kontribut në TRIGLAVZ meret mesatarja e kontributeve në shumë nominale të fondeve pensionale të detyrueshme aktuale. Më tej në tetë muajt e ardhshëm ponderi tek TRIGLAVZ është më i vogël se tek SAVAZ dhe KPBz pasi në llogaritjen e ponderit për kontribut tek TRIGLAVZ meret mesatarja e kontributeve në shumë nominale të tre fondeve pensionale të detyrueshme. Kontributi në TRIGLAVZ në këtë periudhë ishte dukshëm më i vogël dhe ndikonte në mesataren e kontributeve në shumë nominale në të tre fondet pensionale të detyrueshme. Më tej edhe krahas asaj se shumica e kompensimit nga kontributet për vitin 2020 u zvogëlua duke patur parasysh faktin se të tre shoqëritë pensionale arketojnë kompensin nga kontributet në të njëjtin nivel dhe faktin se kontributi i realizuar në shumë nominale tek SAVAZ dhe KPBz nuk dallohej shumë, ponderët në vitin 2020 – për SAVAZ dhe KPBz kanë afërsisht të njëjtën vlerë.


Numri total i anëtarëve dhe shpërndarja përkohësisht të siguruarve në fondet pensionale të detyrueshme deri më 31 dhjetor 2020 është 529.983 që do të thotë rritje të numrit të anëtarëve në shtyllën e dytë për 22.427 ose për rreth 4%, në krahasim me vitin 2019. Rritja e anëtarësisë në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 e mban të njëjtin ritëm të ngadalësuar si në vitin e kaluar për të cilën kanë ndikuar më shumë lëvizjet e disfavorshme të tregut të punës në kushtet e pandemisë të virusit Korona.

Për sa i përket shpërndarjes së anëtarëve sipas fondeve pensionale të detyrueshme pritet që edhe në vitin 2020 numri më i madh i të siguruarve të jenë anëtarë në SAVAZ dhe KPBz. Domethënë nga numri total i anëtarëve dhe shpërndarjen e përkohshme të siguruarve sipas fondeve pensionale të detyrueshme me gjendje më 31.12.2020 50% janë tek KPBz, 47% janë tek SAVAZ dhe 3% janë në TRIGLAVZ.

Nga numri i anëtarëve në shtyllën e dytë 62.668, ose 12% janë anëtarë vullnetar ndërsa 467.315 ose 88% janë anëtarë të detyruar. Nga numri total i anëtarëve të detyruar, 172.155 anëtarë nënshkruan kontratë për anëtarësi, 265.221 nuk nënshkruan kontratë dhe janë të shpërndarë përkohësisht dhe 29.939 të siguruar janë shpërndarë përkohësisht. Në vitin 2020 vetëm rreth 4% të siguruarve të cilët kanë detyrim të anëtarësohen në fondin pensional të detyrueshëm në vitin 2020 dhe për të cilët i ka kaluar afati për zgjedhje të fondit pensional të detyrueshëm, nënshkruan kontratë për anëtarësi, ndërsa të tjerët rreth 96%, nuk nënshkruan kontratë dhe mbeten në fondin kur ishin shpërndarë më parë.


Në strukturën e anëtarëve dhe në shpërndarjen e përkohshme të siguruarve sipas statusit të anëtarit në vitin 2020 për SAVAZ dhe KPBz nuk ndodhën ndryshime të papritura dhe të rëndësishme. Struktura e anëtarëve dhe shpërndarja e përkohshme të siguruarve sipas statusit të anëtarit në vitin 2020 është e ngjashme tek SAVAZ dhe KPBz. Më tej, mund të vihet re se në çdo tremujor pjesëmarrja në përqindje të anëtarëve vullnetar u zvogëlua ndërsa anëtarësia në anëtarët e detyrueshëm u rrit, gjë që është e pritshme pasi çdo vit rritet hyrja e anëtarëve të detyrueshëm. Gjithashtu mund të vihet re se pjesëmarrja në përqindje të anëtarëve të detyrueshëm të cilët nënshkruan kontratë për anëtarësi gradualisht zvogëlohet nga një tremujor në tjetrin në dallim nga pjesëmarrja e anëtarëve të detyrueshëm të cilët janë shpërndarë përkohësisht dhe që gradualisht rritet nga tremujor në tremujor. Struktura e anëtarëve dhe shpërndarja e përkohshme të siguruarve sipas statusit të anëtarësisë në TRIGLAVZ dukshëm dallohet në krahasim SAVAZ dhe KPBz, gjë që është e pritshme sepse TRIGLAVZ punon më pak se dy vjet. Mund të vihet re se në tremujorin e katërt të punës në TRIGLAVZ, më e madhe është pjesëmarrja në përqindje të anëtarëve të detyrueshëm të cilët janë shpërndarë dhe më pas pason pjesëmarrja në përqindje të siguruarve të shpërndarë përkohësisht. Në tremujorët e ardhshëm gradualisht rritet pjesëmarrja edhe të anëtarëve të detyrueshëm të cilët nënshkruan kontratë për anëtarësi edhe pse rritet gradualisht në mënyrë minimale edhe pjesëmarrja në anëtarët vullnetar. Anëtarët vullnetarë në TRIGLAVZ janë të siguruarit që nënshkruan kontratë për kalim nga SAVAZ dhe KPBz në TRIGLAVZ. Gjithashtu në tremujorët e ardhshëm u rrit pjesëmarrja në përqindje të anëtarëve të detyrueshëm të cilët janë shpërndarë, ndërsa ulet pjesëmarrja të siguruarve të shpërndarë përkohësisht. Struktura e anëtarëve edhe të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas fondeve pensionale të detyrueshme dhe sipas statusit të anëtarit në vitin 2020 është paraqitur në nivel tremujor në grafikun 5.2.

Grafik 5.2. Struktura e anëtarëve dhe të siguruarve të shpërndarë përkohësisht sipas statusit të anëtarit në fpsh




Analiza e strukturës të anëtarëve sipas moshës tregon se anëtarët në numë më të madh janë persona të rinj. Anëtarët e detyruar janë persona të rinj kështu që 79% nga anëtarët e detyruar janë në moshë deri në 40 vjeç ndërsa anëtarët vullnetarë janë pak më të moshuar dhe 83% nga ata janë në moshën deri 50 vjeç. Mosha mesatare e anëtarëve të detyruar është 34 për burra dhe 35 për gra ndërsa tek anëtarët vullnetarë është 46 vjeç (edhe për burra edhe për gra) ndërsa mosha e të gjithë anëtarëve gjithsej është 36 vjeç. Struktura e anëtarëve e të sistemit pensional dyshtyllësh sipas moshës, gjinisë dhe kategorisë së anëtarësimit është pasqyruar në grafikun grafikoni 5.3.

Grafik 5.3. Struktura e anëtarëve të sistemit pensional dyshtyllësh sipas moshës, gjinisë dhe sipas kategorisë së anëtarësimit



Sipas të dhënave të DZC⁵ në fund të vitit 2020 numri total i popullsisë⁶ së aftë për punë në RMV ishte 1.685.589 ndërsa popullsia⁷ totale aktive ishte 950.857. Me gjendjen në fund të vitit rreth 31% e popullsisë totale të aftë për punë në RMV janë anëtarë të sistemit dyshtyllësh ose rreth 56% e popullsisë totale aktive në RM janë anëtarë të sistemit pensional dyshtyllësh. Struktura e anëtarëve në sistemin pensional dyshtyllësh të popullsisë totale të aftë për punë dhe popullsisë aktive në RMV sipas grupmoshave dhe sipas gjinisë gjendja më 31.12.2020 është paraqitur në grafikun 5.4. Mund të vihet re se përqindje domethënëse (mbi 70%) nga popullsia aktive në moshën nga 15 deri në 49 vjeç është përfshirë në sistemin pensional dyshtyllësh.

Grafik 5.4. Struktura e anëtarëve të sistemit pensional dyshtyllësh në popullsinë totale të aftë për punë dhe popullsinë aktive sipas grupmoshave dhe gjinisë.




Në përputhje me të dhënën e Fondit PIOISM për numrin e të siguruarve më 31.12.2020 rreth 93% e numrit të përgjithshëm të siguruarve në Fondin e PIOISM janë anëtarë në sistemin pensional dyshtyllësh. Në grafikun 5.5. mund të shihet rritja e pjesëmarrjes së anëtarëve në sistemin pensional dyshtyllësh në numrin total të siguruarve në Fondin e PIOISM nga fillimi i punës të shtyllës së dytë.

⁵ Nxjerë: Instituti shtetëror statistikor-Popullsia aktive e RMV, Rezultate nga anketa për fuqi punëtore viti, 2019

⁶ Popullsia e aftë për punë - e përbëjnë të gjithë personat e moshës nga 15 deri në 79 vjeç


⁷ Popullsia aktive ekonomike- e përbëjnë personat e punësuar dhe të papunë

Grafik 5.5. Pjesëmarja e anëtarëve në sistemin pensional dyshtyllësh të siguruar në Fondin PIOsM sipas viteve 2006-2020



Struktura e anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme sipas rajoneve statistikore⁸ në RMV është dhënë në grafikun 5.6. Më shumë anëtarë në të tre fondet pensionale të detyrueshme ka nga rajoni i Shkupit. Më pak anëtarë SAVAz ka nga rajoni i verilindjes, më pak anëtarë në KBPz ka nga rajoni juglindor dhe më pak anëtarë në TRIGLAVz ka nga rajoni i Lindjes,

Grafik 5.6. Struktura e anëtarëve në shtyllën e dytë sipas rajoneve statistikore



⁸ Rajonet statistikore janë definuar sipas DZC – njësi teritoriale. Nomenklatura e njësive teritoriale është bazuar mbi organizimin teritorial të vetqeverisjes lokale në RMV dhe është në përputhje me klasifikacionet e BE.

5.3. Kalimi i një anëtarë nga një fond në një fond tjetër pensional të detyrueshëm

Çdo anëtar i fondit pensional të detyrueshëm ka të drejtë të kalojë në një fond pensional të detyrueshëm në tjetër në qoftëse nuk është i kënaqur nga fondi pensional i detyrueshëm ku është anëtar dmth nga shoqëria që menaxhon me të. Nëqoftëse personi ka qenë anëtarë në fondin pensional të detyrueshëm më pak se 24 muaj gjatë kalimit ai është i detyruar të paguaj kompensim për kalim. Nëqoftëse personi ka qenë anëtarë të ndonjë fondi më shumë se 24 muaj atëherë kalimi në fond tjetër është falas. Gjatë kalimit transferohen edhe mjetet totale nga llogaria e anëtarit.


Në tabelën 5.4. janë pasqyruar të dhëna për numrin e anëtarëve të cilët kanë kaluar nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër dhe për shumën e mjeteve që transferohen nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër mbi atë bazë gjatë vitit 2020.

Tabela 5.4. Kalime të anëtarëve nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër

2020		FDP në të cilën kanë kaluar anëtarët, dmth në të cilat janë transferuar fondet			Gjithsej
		SAVAz	KBPz	TRIGLAVz	
Anëtarët që kanë kaluar nga FDP	SAVAz	-	87	1.280	1.367
	KBPz	150	-	1.420	1.570
	TRIGLAVz	2	2	-	4
Gjithsej		152	89	2.700	2.941
Mjetet që janë transferuar nga FDP (në denarë)	SAVAz	-	40.519.599	248.714.419	289.234.018
	KBPz	46.810.791	-	289.560.411	336.371.202
	TRIGLAVz	228.810	685.680	-	914.490
Gjithsej		47.039.601	41.205.279	538.274.830	626.519.710

Lëvizja në trendin e kalimit të anëtarëve nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër që ishte nxitur me fillimin e punës të fondit të tretë pensional të detyrueshëm në vitin 2019 vazhdoi në vitin 2020. Gjatë vitit 2020 numri total i anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme të cilët kaluan nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër ka qenë 29.41, që përbën 0,55% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Edhe pse në përqindje pjesëmarja e anëtarëve të cilën e ndëruan fondin pensional të detyrueshëm në numrin total të anëtarëve është akoma e vogël prapësëprapi në vitin 2020 numri i anëtarëve që kryen ndrimin e fondit pensional të detyrueshëm është mjaft më i madh në krahasim me vitin 2019. Prandaj 152 anëtarë kaluan në SAVAz, 89 kaluan në KBPz dhe 2.700 anëtarë kaluan në TRIGLAVz. Gjatë kalimit rreth 47 milion denarë ishin transferuar në SAVAz, rreth 41 milion denarë ishin transferuar në KBPz dhe rreth 538 milion denarë ishin transferuar në TRIGLAVz. Në grafikun 5.7. është dhënë një pasqyrë e të gjithë kalimeve të anëtarëve nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër dhe transferimet totale të mjeteve totale nga një fond në një fond pensional të detyrueshëm tjetër nga viti 2008 deri në vitin 2020.


Grafik 5.7. Kalimet nga një fond në fond tjetër pensional të detyrueshëm sipas viteve 2008-2020



5.4. Kontribute në fondet pensionale të detyrueshme

Pagesa e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor e kryen debitori për pagesën e kontributit ose punëdhënësi në emër të punëtorit. Drejtoria e tatimeve kryen arkëtime të integruara të kontributeve nga sigurimi social i detyrueshëm (kontribut për sigurim pensional dhe invaliditeti, kontribut për sigurim shëndetsor dhe kontribut për punësim në rast papunësie dhe tatim personal mbi të ardhurat.

Grafik 5.8. Pasqyrim skematik të arkëtimeve dhe të shpërndarjes së kontributeve



Për të siguruarit që marin pjesë në sistem me një shtyllë kontributet totale të paguara ngelen në Fondin PIOSM (për vitin 2020 kapte shumën 18,8% nga paga bruto). Për të siguruarit që përfshihen në sistemin me dy shtylla Fondi i PIOSM kryen shpërndarje të kontributeve të paguara midis shtyllës së parë dhe të dytë.

Shuma e kontributit që transferohet në fondin pensional të detyrueshëm është 6% nga paga bruto ndërsa në Fondin e PIOSM ngelet kontributi në shumën që fitohet si rezultat i diferencës të kontributit total për sigurim pensional dhe invaliditeti dhe kontributit të paguar në fondin pensional të detyrueshëm (për vitin 2020 kap shumën 12,8% të pagës bruto (12,8% = 18,8% – 6%)).

Menjëherë dhe jo më vonë se pesë ditë punë nga pranimi i kontributeve Fondi i PIOSM i transferon kontributet e anëtarëve në fondet pensionale të detyrueshme në llogaritë individuale në fondet pensionale të detyrueshme me kusht në të njëjtin afat të pranohen edhe të dhënat përkatëse në përputhje me ligjin të cilët i mundësojnë Fondit të PIOSM ta kryej atë detyrim. Nëqoftëse Fondi i PIOSM nuk i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme në llogaritë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura menjëherë dhe jo më vonë se pesë ditë punë nga dita e pranimi të kontributeve për arsye të mungesës së të dhënave, Fondi i PIOSM është i detyruar në një afat jo më të gjatë se tre muaj nga dita e pranimi të kontributeve të siguroj të dhëna përkatëse dhe të kryej transferim të kontributeve të anëtarëve në llogaritë e fondet pensionale të detyrueshme të zgjedhura tek Kujdestari i pasurisë. Pastaj Fondi i PIOSM dorëzon të dhëna tek shoqëritë dhe tek MAPAS në lidhje me transferimin e kryer të kontributeve.


Gjatë viti 2020 në fondet pensionale të detyrueshme ishin transferuar kontribute në një shumë prej rreth 9,3 miliardë denarë ose sipas muajve (në milion denarë) siç është pasqyruar në tabela 5.5.

Tabela 5.5. Kontribute të paguara në shtyllën e dytë (në milion denarë)

	Gjithsej 2019	Jan.	Shku.	Mar.	Prill.	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Gjithsej 2020
SAVAz	4.090	321	324	355	397	329	358	338	371	411	328	339	457	4.328
KBPz	4.438	350	353	386	431	360	395	365	401	448	358	369	494	4.710
TRIGLAVz	163	10	11	14	16,42	14	17	17	19	22	19	21	29	211
Gjithsej	8.691	682	689	756	844	703	769	720	791	881	706	729	980	9.249

Në grafikun 5.9. janë pasqyruar kontributet totale (në milion denarë) të paguara në shtyllën e dytë çdo muaj nga fillimi i punës në sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital deri më 31.12.2020 dhe numri total i anëtarëve në fund të çdo muaji në të njëjtën periudhë

Grafik 5.9. Kontribute të paguara dhe anëtarë në shtyllën e dytë



Mund të vihet re se në përgjithësi me ritjen e numrit të anëtarëve rriten dhe kontributet e paguara në fondet pensionale të detyrueshme (edhe pse trendi i pagesave nuk është plotësisht linear por ka edhe rënie të pasigurta dhe ritje të ndjeshme në muaj të veçantë). Ritjet më të mëdha të kontributeve të paguara në muajt e gjysmës së parë të vitit 2019 sigurojnë i detyrohen edhe kontributeve të paguara për të siguruarit të cilët nuk ishin shpërndarë në shtyllën e dytë në kohë ishin. Zvogëlimi i gjendjes të antarësimit në muajin e parë të viti 2019 i detyrohet përfundimit të antarësimit për kategori të caktuar të siguruarish më 1.1.2019 në përputhje me ndryshimet e ligjit.

5.4.1. Kompensim për transferime të vonuara të kontributeve

Ndryshimet në Ligjin për sigurim pensional me financim kapital nga dt 28.12.2018 parashikon detyrim të Fondit të PIO SM për pagesën e kompensimit për transferime të vonuara të kontributeve në rast se Fondi i PIO SM nuk i ka shpërndarë të siguruarit të cilët ishin anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë në përputhje me kriteriumet para miratimit të ndryshimeve të ligjit, në rast se Fondi i PIO SM nuk ka kryer shpërndarje të siguruarve të cilët janë anëtarë të detyrueshëm të shtyllës së dytë në përputhje me kriteriumet e reja për antarësim në një afat prej tre muajsh pas qasjes së tyre në sigurimin pensional dhe invaliditetit dhe në rast se Fondi i PIO SM nuk i ka transferuar kontributet e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme në llogaritë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura në një afat prej tre muajsh nga dita e pranimi të kontributeve. Mjetet për sigurim pensional të detyrueshëm me financim kapital të realizuara mbi bazën e pagesës së vonuar dhe jo të plotë të kontributit transferohen në llogarinë individuale të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm.

Shuma e kompensimit për transferime të vonuara të kontributeve shpërndahet⁹ në bazë të vlerësimit të gjendjes së llogarisë individuale hipotetike të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm e cila ka histori identike të pagesave të kontributeve me të siguruarin me shpërndarje jo në kohë ose në bazë të vlerësimit të gjendjes të një pjesë të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm, shumës së kontributeve totale të transferuara të vonuara dhe kompensimet nga kontributet që i arkëton shoqëria pensionale.

Në vitin 2020 në fondet pensionale të detyrueshme Fondi i PIO SM transferoi gjithsej rreth 4 milion denarë si kompensim për transferime të vonuara të kontributeve për anëtarët për të cilët nuk i transferoi kontributet në llogarinë e fondeve pensionale të detyrueshme të zgjedhura në një afat prej tre muajsh nga dita e pranimi të kontributeve. Në tabelën 5.7. janë pasqyruar të dhëna të detajuara për kompensimet e transferuara për transferime të vonuara të kontributeve sipas fondeve.

Tabela 5.7. Kompensime të paguara për transferime të vonuara të kontributeve në shtyllën e dytë në vitin 2020 (në milion denarë)

Fondi pensional i detyruar	Kompensimi për transferime të vonuara të kontributeve
SAVAz	2,09
KBPz	1,67
TRIGLAVz	0,13
Gjithsej	3,89

⁹ Formula për llogaritjen e kompensimit për transferime të vonuara të kontributeve është e përshkruar në Rregullore për transferime të vonuara të kontributeve.

5.4.2. Mjete të kthyer në Fondin PIO SM

Gjatë vitit 2020 një pjesë e mjeteve të paguara në fondet pensionale të detyrueshme (rreth 2,8 miliardë denarë) ishte kthyer në Fondin e PIO SM për shkak të disa arsyeve:

- realizimi i të drejtës të pensionit familjar dhe pensionit të invaliditetit;
- teprice kontributesh të paguara në shtyllën e dytë për shkak të gabimeve teknike ose teprice pagesash nga ana e punëdhënësit;
- prishje kontratash të anëtarësimi ose anulim të shpërndarjes;
- përfundimi i anëtarësisë të siguruarve të cilët gjatë sigurimit e plotësuan stazhin e sigurimit me zgjatje të ritur që mundëson uljen e kufirit të vjetërsisë për fitimin e të drejtës së pensioni të pleqërisë për më së pakti një vit

Në vitin 2020 pjesa më e madhe e mjeteve të kthyer në Fondin e PIO SM (85%) i përket përfundimi të anëtarësisë të siguruarve të cilët gjatë sigurimit e plotësuan stazhin e sigurimit ma zgjatje të ritur që mundëson uljen e kufirit të vjetërsisë për realizimin e të drejtës së pensionit të pleqërisë për më së pakti një vit dhe nuk dhanë deklarata me shkrim për zgjatjen e anëtarësisë në fondin pensional të detyrueshëm në një afat prej tre muajsh pas plotësimit të stazhit të sigurimit.

Struktura e mjeteve të kthyer në Fondin e PIO SM sipas fondeve pensionale të detyrueshme në mënyrë të detajuar janë paraqitur në tabelën 5.8.

Tabela 5.8. Struktura e mjeteve të kthyer në Fondin e PIO SM sipas fondeve pensionale të detyrueshme (në milion denarë)

Shkaqet	Nga fondi pensional i detyruar			Gjithsej
	SAVAz	KBPz	TRIGLAVz	
Pension i realizuar	24,93	26,14	0,35	51,42
- pension invaliditeti	3,82	7,71	0,17	11,70
- pension familjar	21,11	18,43	0,18	39,72
Pagesat e tepërta të kontributeve	177,87	190,22	7,979	376,06
Anulimi i marrëveshjeve dhe anulimi i shpërndarjeve	0,01	0,00	0,04	0,06
Përfundimi i anëtarësisë	1.043,10	1.303,86	0,00	2.346,96
- anëtarët të cilët gjatë sigurimit kanë kryer një shërbim sigurimi me kohëzgjatje të shtuar që lejon uljen e kufirit të moshës për ushtrimin e të drejtës për pension pleqërie për të paktën një vit	1.043,10	1.303,86	0,00	2.346,96
Gjithsej	1.245,91	1.520,22	8,372	2.774,50

5.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale të detyrueshme

Zakonisht në sistemet pensionale të detyrueshme me financim kapital në fazën fillestare përdoren kontrolli proaktiv dhe kufizime kuantitative dhe kualitative të investimeve. Duke u nisur nga kjo në ligjin dhe në aktet nënligjore janë definuar qëllimet dhe arsyet investuese, llojet e instrumentave në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, kushtet që duhet ti plotësojnë tregjet sekondare të regulluara të kapitalit ku tregëtohet me mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, kualiteti i instrumentave në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, shtetet ose grupshtetet në të cilat mund të investohen fondet pensionale të detyrueshme, kufizimet investuese në kuadrin e instrumentave dhe emetuesve, investimet e ndaluara, tejkalimi i kufizimeve investuese etj.

Shoqëria është e detyruar që mjetet e fondit pensional të detyrueshëm ti investoj në përputhje dispozitave ligjore dhe nënligjore dhe me strategjinë e saj investuese me qëllim që të realizohet një rendimet sa më i lartë vetëm e vetëm në favor të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondit pensional të detyrueshëm dhe nëpërmjet diversifikacionit dhe analizës financiare ta minimizoj rizikun nga humbjet, të cilat ndodhën për shkak të mos pagesës të emetuesit ose të palës tjetër kontraktgjënë, që rrjedhin nga ndikimi i tregjeve financiare të vendit dhe të huaja, humbje në vlerën reale të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm për shkak të inflacionit dhe humbje të cilat janë pasojë nga shitja e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondit pensional të detyrueshëm. Më pas anëtari i këshillit drejtues dhe i këshillit mbikqyrës të shoqërisë gjatë menxhimit dhe kontrollit të investimi të mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm është i detyruar të zbatoj shkallë përgjegjësie, krijimtari dhe aftësi, të cilët do ti zbatonte një njëri i mençur gjatë investimit të mjeteve. Çdo anëtar i këshillit drejtues dhe mbikqyrës në shoqëri duhet ta plotësoj obligimin në përputhje me detyrimet besuese dhe duhet të siguroj zbatimin e tyre nga ana e çdo punonjësi ose të angazhuari në punë në shoqëri.

Në ligjin dhe në aktet nënligjore është rregulluar se mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme mund të investohen në depozitat bankare dhe në çertifikata për depozita, obligacione dhe në letra me vlerë debiti të tjera, në aksione dhe shënime komercijaliste të lëshuara nga emetues me seli në RMV dhe jashtë shtetit, në shtetet e EU ose në OECD. Duke pasur parasysh se është e domosdoshme që të arihet diversifikacion përkatës midis llojeve të investimeve të ndryshme janë parashikuar kufizime maksimale për investime në kompani të caktuara dhe kufizime maksimale të shumave të cilat mund të investohen në lloje të caktuara instrumentesh. Me qëllim që të ndalohen investimet në instrumente të cilat nuk janë të përshtatshme për të investuar fondet pensionale të detyrueshme, ligjërisht ndalohen investimet në aksione, obligacione dhe në letra me vlerë të tjera, të cilët nuk kuotojnë në tregun oficial ose me të cilat publikisht nuk tregëtohet, instrumente me të cilat nuk mund të disponohet në mënyrë juridike, instrumente të cilat nuk mund të vlerësohen menjëherë, një numër i madhe formash të pasurisë të cilat nuk mund të vlerësohen menjëherë dhe norma të vlerës të pasigurta, përshebull antikuitete, vepra arti etj.

Duke parë se mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme janë në ritje të vazhdueshme, ritja e tyre është ndjekur me mundësi për daljen në një numër më të madh trgësh të kapitalit dhe në një shkallë më të gjerë, pasi tregu i vendit bëhet përherë dhe më i vogël në krahasim me nevojat për të investuar mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme, si dhe me qëllim të mundësohet një diversifikim më të madh të mjeteve gjatë investimit të tyre dhe zgjedhje më të madhe të kompanive për investim të mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme nga ana e shoqërive. Kufizimet maksimale investuese janë paraqitur në tabelën 5.9.


Tabela 5.9. Kufizimet maksimale investuese

Investimet jashtë vendit (EU dhe ñ OECD)	50%
- obligacione dhe letra me vlerë të tjera të lëshuara nga shtete të huaja dhe banka qendrore	50%
- letra me vlerë të lëshuara nga kompani të huaja joshitetërore, banka dhe fonde investuese	30%
Letra me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga RMV në tregun e vendit ose NBPSM	80%
Depozita bankare, çertifikata për depozita, obligacione, letra me vlerë në bazë të hipotekës dhe letra me vlerë të tjera të lëshuara nga bankat e vendit	60%
- depozita bankare	30%
Obligacione të lëshuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore dhe nga shoqëritë aksionere të vendit të cilat nuk janë banka dhe shënimet komercialiste nga shoqëritë aksionere të vendit nga të cilat nuk janë banka	40%
- obligacione të lëshuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore	10%
Aksione të lëshuara nga shoqëritë aksionere të vendit	30%
Dokumenta për pjesëmarrje në aksione në fondet investuese të hapura, të mbyllura dhe private në RMV	5%
- dokumenta për pjesëmarrje në fondet investuese private	1,5%


MAPAS mund të caktoj kufizime të investimeve të llojeve të veçanta të instrumentave të ndryshme nga kufizimet të vendosura me ligjin, të cilat do të jenë vlefshme për një afat i cili gjithashtu është caktuar nga MAPAS, por jo më gjatë se pesë vjet. Në vitin 2019 ishin miratuar vendime për kufizime plotësuese sipas të cilave përqindja maksimale nga vlera e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar të cilat mund të investohen në depozita në bankat e licensuara nga NBPSM, në qoftëse mbartin kamatë ose në obligacione dhe letra me vlerë të tjera që i lëshon ose garanton RMV në tregun e brendshëm, në periudhë prej një viti nga data e pagesës së parë në fondin pensional të detyrueshëm dhe vullnetar, është 100%.

Struktura e investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme SAVAZ dhe KPBz, nga fillimi i funksionimit të sistemit (për periudhën 2006 – 2019 në nivel vjetor ndërsa për vitin 2020 2020 në nivelë tremujorsh) është paraqitur në grafikun 5.10. dhe në grafikun 5.11. Struktura e investimeve të fondit pensinal të detyrueshëm TRIGLAVz nga fillimi i punës të fondit (1.4.2019) në nivel tremujorsh është paraqitur në grafikun 5.12.


Grafik 5.10. Struktura e investimeve në SAVAZ



Grafiku 5.11. Struktura e investimeve të KBPz




Grafiku 5.12. Struktura e investimeve TRIGLAVz




Struktura e investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme gjendja më 31.12.2020 nuk dallohet shumë në krahasim me strukturën e investimeve gjendja 31.12.2019 dhe ajo është paraqitur në grafikun 5.13. Fillimi i punës të fondit pensional të detyrueshëm TRIGLAVz nuk ndikon shumë në strukturën totale të investimeve të fondeve pensionale të detyrueshme duke pasur parasysh faktin se vitet e para të punës fondi i ri disponon me mjete të vëllimit të vogël që përfaqësojnë pjesëmarje të vogël në totalin e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme. Pjesëmarja e obligacioneve të vendit të cilat përfshijnë obligacione shtetërore të vendit (59,72%) dhe obligacione korporative (obligacion i përhershëm i lëshuar nga banka – 0,03%) është 59,75% që do të thotë është rritur minimalisht në krahasim me gjendje më 31.12.2019 (58,86%). Një pjesë shumë e vogël nga investimet të fondeve pensionale të detyrueshme i përket letrave me vlerë afatshkurta nga emetuesit e brendshëm që përfshijnë shënim shtetëror 12-mujorsh (0,03%). Pjesëmarja nga depozitat bankare është ulur minimalisht 9,89%. Në aksionet e brendshme i takon një pjesë e vogël nga portofoli (2,74%) dhe ajo pjesëmarje ngelet pothuajse në të njëjtin nivel në krahasim me gjendjen më 31.12.2019. Një pjesë shumë e vogël nga investimet e fondeve pensionale të detyrueshme i takon investimeve sipas pjesëmarjeve nga fondet investuese të vendit (0,02%). Në vitin 2020 pjesëmarja e investimeve jashtë shtetit është pothuajse në të njëjtin nivel në krahasim me vitin e kaluar 26,83%. Investimet në letra me vlerë të huaja përfshijnë investimet në pjesëmarje të fondeve investuese (22,53%) dhe investimet në aksione (4,75%). Mjete e tjera janë mjete monetare 0,09% dhe kërkesa 0,20%.

Grafik 5.13. Struktura e investimeve në shtyllën e dytë gjendja më 31.12.2019



Gjatë vitit 2020 të tre fondet pensionale të detyrueshme investojnë në kuadrin kufizimeve investuese maksimale. Në grafikon 5.14. është paraqitur pjesmatja në përqindje në portofolin sipas klasave të mjeteve tek SAVAz, KBPz dhe TRIGLAVz dhe kufizimet ligjore me gjendje më 31.12.2020.


Grafik 5.14. Klasat e mjeteve në portofolin e FPD krahasuara me kufizimet ligjore



Si në vitin e mëparshëm edhe në vitin 2020 një përqindje të vogël nga mjetet e fondeve pensionale të detyrueshme (2,74%) janë investur në aksione tek emetuesit të brendshëm. Në vitin 2020. Në vitin 2020 edhe tek SAVAz dhe tek KBPz, ekspozimi i aksioneve në krahasim me vitin 2019 është pothuajse në të njëjtin nivel. Kështu që ekspozimi i aksioneve në emetuesit e brendshëm është dy herë më e madhe tek SAVAz (3,83%) në krahasim me KBPz (1,81%). ekspozimi i aksioneve në emetuesit e brendshëm në TRIGLAVz në vitin e dytë të punës së vet në krahasim me vitin 2019 është rritur me 1,04%.

Lëvizja¹⁰ e vlerës së Indeksit të Bursës Maqedonase - MBI 10, Indeksit të obligacioneve të bursës Maqedonase - OMB dhe vlerave të njësive kontabël të fondeve pensionale të detyrueshëm gjatë vitit 2020 të krahasuara janë paraqitur në grafikun 5.15. Vlera e njësisë kontabël të SAVAz u rrit me 3.15%, njësia e KBPz u rrit me 4.28% dhe njësia e llogaritjes së TRIGLAVz u rrit me 0.09%. MBI10, gjatë vitit 2020, u rrit me rreth 1,20%. OMB, gjatë vitit 2020, u rrit me rreth 0,08%¹¹.

Grafik 5.15. Lëvizja e vlerave të krahasuara MBI10, OMB dhe vlera e njësive kontabël në FPD viti 2020




Gjysma e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme në vitin 2020 i përkasin letrave me vlerë shtetërore dhe konkretisht letrave me vlerë shtetërore të brendshme (57.03% tek SAVAz, 62.44% tek KBPz dhe 48.42% tek TRIGLAVz). Analizuar nga sektorët, atëherë, rreth një e treta e mjeteve të SAVAz dhe KBPz janë investime në instrumente nga emetuesit / shoqëritë aksionare nga sektori financiar, dmth 30.97% tek SAVAz dhe 35.49% tek KBPz të totalit të mjeteve të fondit. Në TRIGLAVz pjesëmarrja në instrumente nga emetuesit / shoqëritë aksionare në sektorin financiar është më e lartë dhe arrin në 44.61%. Në kuadrin e këtij sektori tek SAVAz pjesëmarrja më e madhe në depozitat e brendshme bankare (46.5%) dhe pjesëmarrja në fondet e investimeve të huaja dhe të brendshme (46.4%) dhe pjesëmarrja më e vogël është në shërbimet financiare (5.4%), në aksionet në bankat vendase dhe të huaja (1.5%) dhe obligacionet e emetuara nga bankat vendase (0.2%). Në KBPz brenda sektorit financiar, mbizotëron pjesa e fondeve të investimeve të huaja (83.6%), e ndjekur nga depozitat e brendshme bankare (16.4%). Në TRIGLAVz në kuadrin e sektorit financiar mbizotëron pjesëmarrja e fondeve të investimeve të huaja (65.4%), pasuar nga depozitat e brendshme bankare (34.6%). Përveç sektorëve të mësipërm, fondet e pensionit të detyrueshëm investojnë edhe në sektorë të tjerë: farmaci,

¹⁰ Lëvizjet janë paraqitur nëpërmjet ndryshimit të indekseve /njësive në krahasim me indeksin fillestar barazi me 100 më 31.12.2019

¹¹ Nxjerë: Bursa Maqedonase AD Shkup – buletini statistikor vjetor 2020.


mallra të konsumit, industri, mallrat bazë, teknologjia e informacionit, shërbimet e komunikimit dhe energjia, por me një pjesëmarje shumë më të vogël (nga 0.10% në 2.65%). Struktura e investimeve të fondeve të pensionale të detyrueshme sipas sektorëve është paraqitur në Grafikon 5.16.

Grafik 5.16. Struktura e investimeve ne FPD sipas sektorëve




Sipas strukturës valutore të fondeve pensionale të detyrueshme që është paraqitur në grafikon 5.17., mund të shihet se gjatë vitit 2020 edhe tek SAVAz (46,93%) edhe tek KBPz (40,92%), pjesën më të madhe të fondeve pensionale të detyrueshme janë investuar në euro kështu që tek të dy fondet pensionale mund të vihet re ulje të pjesëmarjes në instrumente, në euro, në krahasim me vitin e kaluar. Ndërkohë pjesëmarja në instrumente në valutë të brendshme është 34,51% tek SAVAz dhe 32,10% tek KBPz, pra tek të fondet pensionale mund të vihet re rritje në krahasim me vitin e kaluar. Më pas mund të vihet re rritje e vogël e pjesëmarjes në instrumente në dollarë amerikan në krahasim me vitin 2019 edhe tek SAVAz (17,66%) edhe tek KBPz (26,99%). Një pjesë e vogël të mjeteve të SAVAz janë investuar në franga zviceriane (0,90%). Struktura valutore e TRIGLAVz dallohet në krahasim me strukturën valutore të SAVAz dhe KBPz. Por struktura valutore TRIGLAVz në vitin e dytë e punës së vet dallohet dukshëm në krahasim me strukturën valutore në vitin 2019. Megjithatë pesha e mjeteve të TRIGLAVz akoma është në anën e mjeteve të cilat investohen në instrumente në denarë (60,91%), më pas 20,84% e mjeteve investohen në instrumente në euro, dhe të tjerat 17,80% në instrumente në dollarë amerikanë dhe 0,46% franga zviceriane.

Grafiku 5.17. Struktura e valutës së mjeteve të FPD, 2019-2020



Nëqoftëse bëhet një krahasim me vendet e rajonit të cilët kanë sisteme pensionale të ngjashme me sistemin maqedonas mund të shihet ngjashmëri por edhe ndryshime të dukshme në portofolet investuese të fondeve pensionale të detyrueshme. Në grafikun 5.18 janë paraqitur portofolet e fondeve pensionale (të cilët korespondojnë me fondet pensionale të detyrueshme në Maqedoninë e Veriut) në disa vende dhe në RMV më 31.12.2019¹².

Grafik 5.18. Portofoli i fondeve pensionale në disa vende dhe në RMV



Përderisa portofolet e fondeve pensionale të detyrueshme shqyrtohen sipas llojeve të instrumenteve mund të shihet se tek disa shtete më shumë se 50% e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme investohen në obligacione dhe në letra me vlerë të tjera për të cilat garanton shteti ose qeverisja vendore (68% në Rumani, 65% në Kroaci B 60%¹³, në Maqedoninë e Veriut dhe 53% në Bullgari). Pjesa e ngelur e mjeteve janë investuar në mënyra të ndryshme. Në aksion dhe pjesëmarje më shumë investohet në Republikën e Maqedonisë (30%), pasojnë Kroacia B (28%), Bullgaria (28%) dhe Rumania (25%). Investimet më të mëdha në depozita kanë fondet pensionale në Maqedoni (10%), e ndjekur nga Rumania, Kroacia B dhe Bullgaria (1%) vetëm një pjesë e vogël e fondeve pensionale investohen në depozita, Fondet pensionale kanë investuar edhe në obligacione korporative konkretisht 9% në Bullgari, 4% në Rumani 2% dhe Kroacia B. Në krahasim me fondet pensionale të shteteve të tjera pjesëmarja në investime në obligacionet korporative në Republikën e Maqedonisë në mënyrë të dukshme është më e vogël 0,03%. Investimet në pasuri të paluajtshme kanë vetëm fondet pensionale në Bullgari (2%) (në shtetet e tjera ky instrument shpeshherë nuk është i lejuar). Në krahasim me ekspozimin e portofoleve të fondeve pensionale të detyrueshme të instrumentave të lëshuar nga emetues nga jashtë¹⁴, mund të shihet se ekspozimin më të madh jashtë shtetit kanë fondet pensionale në Republikën e Maqedonisë (27%) më pas në Kroaci V (19%) dhe në Rumani (12%).

¹² Nxjerrë: www.hanfa.hr; www.fsc.bg; www.asfromania.ro dhe llogaritje të veta.

¹³ Në Kroaci ekzistojnë multifonde konkretisht tre kategori të fondeve pensionale: A (me rizik më të madh), B (portofolet ekzistuese në momentin e venies në funksion të multifondeve) dhe C (me rizik më të vogël)

¹⁴ E dhëna për investimet e jashtme në Bullgari gjendje më 31.12.2020 nuk ishte i disponueshëm

5.6. Mjetet -neto, njësitë kontabile dhe norma e kontributeve të fondeve pensionale të detyrueshme

Kontributet të paguara në fondet pensionale të detyrueshme të zvogëluara për kompensimin nga kontribute menjëherë investohen. Shuma totale e realizuar i shtohet mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm ose më saktë i shtohet llogarive individuale të anëtarëve. Njëherë në muaj shoqërive i paguhet dhe kompensim për menaxhimin e mjeteve që përllogaritet çdo ditë si përqindje nga mjetet-neto të fondit pensional të detyrueshëm. Përveç kësaj gjatë çdo transaksioni me mjetet e fondit pensional të detyrueshëm i paguhen komisione transaksioni nga vetë fondi pensional i detyrueshëm. Çdo ditë kryhet vlerësimi i vlerës së mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm. Ajo përcaktohet mbi bazë vlerës së tregut të çdo mjeti në veçanti ose në bazë të vlerës së amortizuar të mjeteve nëqoftëse instrumenti ruhet deri në dorëzim ose në portofolin në disponuar për shitje ose nëqoftëse nuk mund vlerësohet vlera e saj tregtare.

Ndryshimi i mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme nga fillimi deri në fund të vitit bëhet për arsye të shkaktuara nga:

- fluksi i kontributeve,
- fluksi i kompensimeve për transferimin jo në kohë të kontributeve në raste të tranferimeve jo në kohë të kontributeve,
- dalje për shkak të kompensimeve dhe komisineve të transaksionit,
- fluks për shkak të kalimit nga fondi pensional i detyrueshëm tjetër (për persona të cilët në kohë kanë qenë shpërndarë në fond tjetër dhe pastaj ka nënshkruar kontratë me fondin aktual dhe për persona që kanë qenë anëtarë në fond tjetër dhe më pas kanë kaluar në fondin aktual),
- dalje për shkak kalimi në fondin pensional të detyrueshëm tjetër (për persona të cilët në kohë kanë qenë të shpërndarë në fondin përkatës por më pas kanë nënshkruar kontratë me fondin tjetër dhe persona që kanë qenë anëtarë me fondin përkatës dhe më pas kanë kaluar në fondin tjetër),
- dalje e personave të cilët kanë ndëprerë kontratat për antarësi, për shkak të tepicës të kontributeve të paguar, dalje për shkak të realizimit të drejtës së pensionit të invalidit ose të familjes dhe dalje e personave të cilëve i përfundoi anëtarësia në fondin pensional të detyrueshëm të cilët gjatë sigurimit e plotësuan stazhin e sigurimit me kohëzgjatje të ritur që mundëson uljen e kufirit të vjetërsisë për realizimin e të drejtës të pensionit të pleqërisë për të paktën një vit,
- dalje për shkak pagesës së trashëgimisë,
- dalje për shkak të pagesave të njëhershme për persona të cilët nuk kanë realizuar të drejtën e pensionit të pleqërisë,
- dalje për shkak të pagesës të pensionit të pleqërisë – tërheqje të programuara,
- fitime ose humbje të (pa)realizuara nga investimet

Duke u nisur nga mjetet-neto në fund të vitit të kaluar dhe duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e lartpërmendura arihet në vlerën e mjeteve neto në fund të vitit që është paraqitur në tabelën 5.10.

Tabela 5.10. Ndryshime në mjete e ZPF (në milion denarë)


	SAVAz	KBPz	TRIGLAVz
Mjete - neto më 31.12.2019	35.512,31	39.715,32	369,17
Kontributet	4.328,48	4.709,52	210,86
Kompensimet nga kontributet	86,58	94,21	4,22
Kontributet e reduktuara për kompensimet e kontributeve	4.241,89	4.615,31	206,64
Kompensimi për transferime të vonuara të kontributeve	2,09	1,67	0,13
Kompensimet e mjeteve	134,53	150,52	2,62
Shpenzimet për provizione ndërmjetësuese	1,77	0,12	0,15
Transferimi nga fondi tjetër	47,27	42,27	538,42
Transferimi në fondin tjetër	290,09	336,55	1,28
Transferimi nga fondi për shkak të ndërprerjes së marrëveshjes, kthimit të kontributit, daljes në pension dhe përfundimit të anëtarësimit	258,09	272,96	8,66
Pagesa e trashëgimisë	4,35	9,34	0,00
Pagimi i pensionit të moshës – tërheqje të programuara	0,19	0,94	0,00
Pagesa për një herë	0,07	0,15	0,00
Fitimi- bruto nga investimet	1.386,44	2.034,48	16,05
Fitimi- neto nga investimet	1.250,14	1.883,84	13,28
Mjetet neto më 31.12.2020	40.500,92	45.638,47	1.117,71

Totali i mjeteve-neto të fondeve pensionale të detyrueshme gjendja më 31.12.2020 është rreth 87,26 miliardë denarë ose rreth 1,42 miliardë denarë që përfaqëson rreth 13,14% BDP në RMV¹⁵.

Në grafikun 5.19. janë paraqitur vlerat e mjeteve -neto në fund të vitit (2008-2020) dhe ritja e tyre në përqindje në krahasim me mjetet -neto në vitin e kaluar SAVAz dhe KBPz dhe vlera e mjeteve-neto në TRIGLAVz në fund të vitit 2020 ritja e tyre një përqindje në krahasim me vitin 2019. Më tej mund të vihet re se mjetet-neto edhe në SAVAz edhe në KBPz rriten me të njëjtin ritëm. Ritja më e madhe edhe tek SAVAz edhe tek KBPz vihet re në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Tek TRIGLAVz vihet re rritje e madhe të mjeteve -neto në vitin e dytë të punës të fondit në krahasim me vitin e parë.


¹⁵ Nxjerë për BDP: DZC– Njoftim – prodhimi i brendëshëm-neto, tremujori i katërt v. 2020 – të dhëna të vlerësuara.

Grafik 5.19. Ritja e mjeteve neto të FPD në përqindje në krahasim me vitin e kaluar




Lëvizja e vlerës së mjeteve -neto dhe kontributeve kumulative si dhe ritja e kontributeve të paguara dhe ritja e mjeteve-neto të SAVAz dhe KBPz nga fillimi i punës të sistemit (dmth nga data e pagesës së parë më 1.1.2020) deri më 31.12.2020, janë paraqitur në grafikun 5.20. dhe në grafikun 5.21. Ritja e mjeteve –neto të fondeve pensionale të detyrueshme është implikuar nga ritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultat investuese. Për vitin 2020 pjesa më e madhe nga ritja e mjeteve –neto i detyrohet kontributeve të paguara. Megjithatë në krahasim me vitet e para të punës së fondeve pjesëmarrja në kontributet e paguara në ritjen totale të mjeteve-neto shënon ulje graduale. Gjithashtu, mund të vihet re se gjatë viteve të para pjesëmarrja e kontributeve kumulative në totalin e mjeteve –neto dukshëm është e madhe, më tej gradualisht zvogëlohet dhe në pesë vitet e fundit mesatarisht është 80%


Grafik 5.20. Ritja e mjeteve – neto në krahasim me ritjen kontributet e paguara në SAVAz



Grafik 5.21. Ritja e mjeteve – neto në krahasim me ritjen kontributet e paguara në KBPz



Grafik 5.22. Ritja e mjeteve – neto në krahasim me ritjen kontributet e paguara në TRIGLAVz



Tek SAVAz dhe KBPz, mjetet neto dhe kontributet kumulative rriten në mënyrë të vazhdueshme nga fillimi i funksionimit të sistemit. Ritjen më të madhe të mjeteve-neto (rreth 150%) si dhe të kontributeve të paguara (rreth 40%) edhe tek SAVAz edhe tek KBPz është shënuar në vitin 2007. Kjo i detyrohet sigurisht ritjes së madhe të përqindjes së anëtarësisë, ose të kontributeve në krahasim me vitin e kaluar si dhe në ritjen goxha të lartë të njësive. Më tej pason rënie e ritjes edhe të mjeteve – neto të kontributeve të paguara. Me kalimin e viteve ka stabilizim gradual kështu që ritja e mjeteve - neto në pesë vitet e fundit mesatarisht është rreth 16%, ndërsa ritja e kontributeve të paguara në të njëjtin periudhë mesatarisht është rreth 12%. Gjatë vitit 2020 vihen re parametra më të vegjël në krahasim me vitin 2019, ose ritje e mjeteve –neto prej 14% tek SAVAz dhe 15% tek KBPz, ndërsa ritja e kontributeve të paguara është rreth 6% edhe tek SAVAz dhe tek KBPz.

Lëvizja e vlerës së mjeteve neto dhe kontributeve kumulative si dhe ritja e kontributeve të paguara dhe ritja e mjeteve –neto në TRIGLAVz, për dy vitet e para të punës të pinës n TRIGLAVz, vitet 2019 dhe 2020, janë paraqitur në grafikun 5.22. Edhe tek TRIGLAVz vihet ritje e mjeteve-neto dhe kontributeve kumulative për vitin 2020 në krahasim me 2019. Ritja e mjeteve –neto në TRIGLAVz krahas asaj që është implikuar nga ritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet investuese në një masë të madhe i detyrohet mjeteve të transferuara në TRIGLAVz nga SAVAz dhe KBPz në bazë të kontratave të lidhura për kalim të anëtarve që kaluan nga SAVAz dhe KBPz në TRIGLAVz.

Për evidentim të mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme përdoren njësitet e kontabilitetit. Një njësi kontabël përfaqëson pjesë proporcionale të totalit të mjeteve – neto të fondit pensional të detyrueshëm. Vlera e njësive të kontabilitetit është e njëjtë me vlerën e mjeteve – neto e pjesëtuar me numrin total të njësive të kontabilitetit të të gjitha llogarive dhe nënlllogarive individuale. Vlera fillestare e njësive të kontabilitetit të fondit pensional është 100 denarë. Fondet pensionale përfshirë edhe ato maqedonaset i nënshtrohen dukurive dhe lëvizjeve ciklike që nënkuptojnë ritje ose rënie të vlerave të njësive të kontabilitetit të tyre në varësi të investimit të mjeteve dhe nga lëvizja e vlerës të instrumentave në të cilat janë investuar mjetet e fondeve pensionale si dhe nga arkëtimet e kompensimeve dhe komisioneve.


Lëvizja vlerës së njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale të detyrueshme nga fillimi i funksionimit të sistemit deri më 31.12.2020 është dhënë në tabelën 5.11., në grafikun 5.23. dhe në grafikun 5.24. Më tej nga fillimi i punës të SAVAz dhe KBPz vihet re një trend në ritje të njësive të kontabilitetit. Më 1.4.2019 filloi me punë fondi i tretë pensional i detyrueshëm TRIGLAVz. Në vitin 2020 njësitet e kontabilitetit të tre fondeve pensionale të detyrueshme shënojnë lëkundje të mëdhaja nga të zakonshmet të shkaktuara nga gjendjet jo të favorshme të tregjeve financiare në kushtet e pandemisë të Virusit Korona. Megjithatë gjatë vitit 2020 njësitet e kontabilitetit të tre fondeve pensionale të detyrueshme edhe pse është i vonuar ka shënuar ritje. Në këtë mënyrë njësitet e kontabilitetit tek SAVAz dhe KBPz kanë trend të ngjashëm, kështu që, në fund të vitit vlera e njësive të kontabilitetit tek SAVAz shënon ritje prej 3,15%, në krahasim me vitin 2019 ndërsa në KBPz një ritje prej rreth 4,28%. Njësia kontabël tek TRIGLAVz gjithashtu shënon ritje në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 afërsisht 0,09%, pritshmëria e të cilës ishte më modeste në krahasim me ritjen e njësive të kontabilitetit të SAVAz dhe KBPz të cilat punojnë pesëmbëdhjetë vite. Megjithatë fondet pensionale sipas natyrës së tyre punojnë për një afat të gjatë kështu që performancat e tyre duhet të vlerësohen për një afat të gjatë.

Tabela 5.11. Vlera e njësive kontabël nga fillimi i sitemit


Data	Vlera e njësive së kontabilitetit (në denarë)		
	SAVAz	KBPz	TRIGLAVz
31.12.2006	105,929336	106,265900	
31.12.2007	115,511364	115,303221	
31.12.2008	100,155213	107,116421	
*31.12.2009	116,874672	120,667142	
31.12.2010	125,009646	129,590887	
31.12.2011	129,003093	130,697013	
31.12.2012	139,225567	142,372582	
31.12.2013	151,117506	153,757419	
31.12.2014	160,733889	164,578077	
31.12.2015	170,193521	174,392410	
31.12.2016	179,771032	184,786292	
31.12.2017	189,686331	195,037486	
31.12.2018	193,113009	196,706281	
31.12.2019	213,757775	218,317207	101,578448
31.03.2020	203,707016	205,658419	96,870254
30.06.2020	212,474547	216,507724	99,551529
30.09.2020	214,306380	220,182008	100,290501
31.12.2020	220,489334	227,667060	101,665261

*Në pjesën e dytë të vitit 2009 të dyja SAVA dhe KBPrvo miratuan vendim për riklasifikim të instrumentave financiare të cilët ruhen deri sa të dorëzohen në kategorinë e instrumentave financiare të disponueshëm për shitje dhe në këtë procedurë shoqëritë kryen vlerësim të përsëritur të vlerës të njësive të kontabilitetit me aplikimin e vlerës së drejtë objektive dhe përcaktimin e vlerës të mjeteve, të mjeteve –neto, vlerën e njësive të kontabilitetit dhe numrin e njësive të kontabilitetit që shkatohet koregjim relativ të lartë të vlerës të njësive të kontabilitetit.

Grafik 5.23. Vlera e njësise kontabël të FPD nga fillimi i sitemit



Grafik 5.24. Vlera e njësise kontabël të FPD për vitin 2020



Zakonisht kontributi për fondet pensionale llogaritet për disa vitet e fundit i ndjekur në nivel vjetor. Kështu që edhe në sistemin pensional maqedonas, ligjërisht është rregulluar që kontributi të llogaritet për një periudhë tetë vjeçare (periudha e përlllogaritjes) i ndjekur në nivel vjetor në shumë nominale dhe reale. Nëqoftëse fondi ekziston më pak se 84 muaj por më gjatë se 12 muaj kontributi llogaritet në fund të qershorit ose në dhjetorit për periudhën nga 1 qershorit, ose në fund të dhjetorit pas themelimit të fondit, deri në fund të qershorit, ose dhjetorit kur bëhet përlllogaritja. Në këtë rast periudha e përlllogaritjes është 78, 72, 66, 60, 54, 48, 42, 36, 30, 24, 18 ose 12 muaj.¹⁶

Kontributi në shumë nominale¹⁷ përfaqëson ndryshim (ritje) në përqindje të vlerës së njësise konbale në datën e fundit të vlerësimit nga periudha e përlllogaritjes dhe vlera e njësise kontable në ditën e fundit të muajit i cili i paraprin muajit të parë të periudhës së përlllogaritjes

¹⁶ TRIGLAVz përfshihet në analizat krahasuese për kontribut me kontribut të llogaritur për periudhat përkatëse në përputhje me rregullativën pasi ekziston më shumë se 12 muaj dhe më pak se 84 muaj

¹⁷ Formulat e përlllogaritjes së kontributit në shumën nominale dhe reale janë përcaktuar në Rregulloren për vlerësimin e mjeteve të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare.

e konvertuar në normën ekuivalente vjetore të kontributit në shumë nominale. Kontributi në shumë reale për çdo periudhë të përlllogaritur i konvertuar në normë ekuivalente vjetore të kontributit në shumë reale llogaritet në bazë të normës vjetore të kontributit në shumë nominale dhe ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetës në periudhën e përlllogaritjes e ndjekur në nivel vjetor. Kontributi i fondeve pensionale të detyrueshme sipas periudhave i ndjekur në nivel vjetor është paraqitur në tabelën 5.12.

Tabela 5.12. Kontributi i FPD*

Periudha ¹⁸	SAVAz		KBPz		TRIGLAVz	
	në shumën nominale	në shumën reale	në shumën nominale	në shumën reale	në shumën nominale	në shumën reale
01.01.2006 - 31.12.2008	0,05%		2,32%			
31.12.2006 - 31.12.2009	3,33%		4,32%			
31.12.2007 - 31.12.2010	2,67%		3,97%			
31.12.2008 - 31.12.2011	8,80%		6,86%			
31.12.2009 - 31.12.2012	6,00%		5,66%			
31.12.2006 - 31.12.2013	5,20%	2,16%	5,41%	2,37%		
31.12.2007 - 31.12.2014	4,83%	2,67%	5,21%	3,05%		
31.12.2008 - 31.12.2015	7,87%	6,45%	7,21%	5,80%		
31.12.2009 - 31.12.2016	6,34%	4,74%	6,27%	4,67%		
31.12.2010 - 31.12.2017	6,13%	4,63%	6,01%	4,51%		
31.12.2011 - 31.12.2018	5,93%	4,72%	6,01%	4,80%		
31.12.2012 - 31.12.2019	6,31%	5,74%	6,29%	5,72%		
31.03.2013 - 31.03.2020	5,23%	4,68%	5,05%	4,51%	-	-
30.06.2013 - 30.06.2020	5,73%	5,20%	5,69%	5,16%	-	-
30.06.2019 - 30.06.2020	-	-	-	-	-0,64%	-2,27 %
30.09.2013 - 30.09.2020	5,60%	4,96%	5,66%	5,02%	-	-
30.06.2019 - 30.09.2020	-	-	-	-	0,08%	-1,29%
31.12.2013 - 31.12.2020	5,54%	4,84%	5,76%	5,06%	-	-
30.06.2019 - 31.12.2020	-	-	-	-	0,97%	-0,49%
Fillo** - 31.12.2020	5,41%	3,44%	5,63%	3,66%	0,95%	-0,40%

** Fillimi i punës të SAVAz dhe KBPz është në 1.1.2006 Fillimi i punës të TRIGLAVz është 1.4.2019


Kontributi i llogarisë individuale është i ndryshueshëm dhe varet nga kontributi i fondit pensional të detyrueshëm dhe nga kompensimet të paguara nga shoqëria. Kontributi ose fitimi është parametër i cili realisht nuk mund të parashikohet pasi varet nga kushtet e tregut të kapitalit dhe nga ekonomia totale.

Duke patur parasysh natyrën afatgjatë të sigurimeve pensionale është e rëndësishme që të lëogarithet edhe kontributi i fondeve pensionale të detyrueshme nga fillimi i sistemit ose nga fillimi i punës të fondit pensional të detyrueshëm i ndjekur në nivel vjetor i cili tek SAVAz është 5,41% në shumë nominale dhe 3,44% në shumë reale, për KBPz 5,63% në shumë nominale odnosno 3,66% në shumë reale. Kontributi nga fillimi i punës në TRIGLAVz i ndjekur në nivel vjetor 0,95% në shumë nominale dhe -0,40% shumë reale.

¹⁸ Deri në miratimin e ndryshimeve të Ligjit të sigurimit pensional vullnetar me financim kapital, janari i vitit 2013, të ardhurat e fondit pensional vullnetar janë llogaritur për një periudhë 3-vjeçare, vetëm në shumën nominale.

Lëvizja e kontributit në shumë nominale gjatë pesëmbëdhjetë viteve ekzistencë të financimit kapital të sigurimit pensional të detyrueshëm mund të shihet në grafikun 5.25 ku janë paraqitur kontributet sipas periudhave (nga fillimi i sistemit deri në datën përkatëse), nga fillimi i sistemit deri më 31.12.2020, sipas fondeve (për SAVAz dhe për KBPz). Në grafikun janë paraqitur edhe kontributet sipas periudhave nga fillimi i punës së TRIGLAVz deri në datën përkatëse. Në fillimin e ekzistencës së sistemit vihet re rritje e kontributit kështu që në fund të vitit 2006 dhe 2007ka kontribute të larta, ndërsa në fund të vitit 2008 vihen re kontributet më të ulta si rezultat i ndodhjeve negative në tregjet financiare të vendit dhe të huaja. Më pas pason rimëkëmbje nga kriza dhe rritja e kontributeve deri në fund të vitit 2009 si dhe në fund të vitit 2010. Në fund të vitit 2011 vihet re ulje e vogël të kontributit në krahasim me fundin e vitit 2010. Gjatë viteve pasuese vihet re rritje (me përjashtime të vogla nga rritja e kontributeve në fund të vitit 2015 dhe gjysmës së parë të vitit 2016 dhe kontributeve në vitin 2018). Shumat më të vogla në vitin 2018 më shumë i detyrohen ndikimit të çmimeve në tregjet financiare botërore të cilat shënuan një paqëndrueshmëri të madhe gjatë vitit 2018 dhe ulje në fund të vitit 2018. Gjatë vitit 2019 vihet re rritje graduale të kontributeve, Në vitin 2020 vihen re kontribute më të vogla në krahasim me vitin 2019 tek SAVAz dhe KBPz, më shumë për arsye të gjendjeve të pafavorshme të tregjeve financiare në kushte pandemie të virusit Korona. TRIGLAVz në vitet fillestare të punës së vet dhe në rrethana të jashtëzakonshme për arsye të gjendjeve të pafavorshme të tregjeve financiare në kushte pandemie të virusit Korona shënoi kontribut në shumë nominale më të vogël se zero i cili në periudhën pasuese ishte zëvendësuar.

Grafik 5.25. Kontribut i FPD (në shumë nominale)




Lëvizja e kontributit në shumë reale në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2019 (në nivel vjetor) dhe në vitin 2020 (në nivel tremujor sipas periudhave shtatëvjeçare i kovertuar në normë vjetore ekuivalente të kontributit, sipas fondit pensional të detyrueshëm mund të shihen në grafikun 5.26. Në këtë grafik është paraqitur edhe lëvizja e kontributit në shuma nominale dhe reale në TRIGLAVz për periudhat përkatëse në përputhje me rregullativën pasi ekziston më gjatë se 12 muaj por më pak se 84 muaj. Gjatë vitit 2020 kontributi në shumë nominale dhe kontributi në shumë reale shënojnë rritje edhe tek SAVAz (nga 5,23% deri 5,54% në shumë nominale ose nga 4,68% deri 4,84% shumë reale) dhe tek KBPz (nga 5,05% deri 5,76% në shumë nominale ose nga 4,51% deri 5,06% shumë reale). Por megjithatë kriza ekonomiko-shëndetsore ndikonte edhe në kontributet të llogaritura për periudhën shtatëvjeçare në vitin. Kështu që shuma më e vogël e kontributit edhe në shumë nominale edhe në shumë reale vihet re në periudhën nga 31.03.2013 - 31.03.2020 tek fondet pensionale të cilat ekzistojnë më shumë se shtatë vjet dhe i njëjti është më i vogël mesatarisht se një pikë përqindje në krahasim me kontributin e periudhës 31.12.2012 - 31.12.2019. Në tremujoret pasues ose në fund të vitit 2020 kontributi

shtatëvjeçar tek fondet pensionale shënon shuma më të mëdha (tek SAVAz në tre tremujorët vihet re një ulje e butë, tek KBPz në tremujorin e katërt ka një ritje të vogël në krahasim me tremujorin e tretë) por akoma nuk janë në nivelin e kontributit shtatëvjeçar i aritur në fund të vitit 2019. Kontributi në tremujorin e tretë dhe të katërt në fondin e tretë pensional të detyrueshëm që filloi me punë në Prill të viti 2019 shënoi ritje në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2020 dhe për periudhën 30.06.2019 - 31.12.2020 shënoi kontribut në shumë nominale mbi zero por akoma kontribut negativ në shumë reale. Në periudhën e shqyrtuar (vitet 2013-2020) ndryshimi i nivelit të shpenzimeve të jetës në periudhat e përllogaritura, i ndjekur në nivel vjetor shënon ulje që ndikon mbi afrimin gradual të kontributeve në shumë reale tek kontributet në shumë nominale.

Kontributi shtatëvjeçar në nivel të financimit kapital të sigurimit pensional të detyrueshëm për periudhën 31.12.2013 – 31.12.2020 i llogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar¹⁹ të njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale të detyrueshme e ndjekur në nivel vjetor është 5,55% në shumë nominale dhe 4,85% në shumë reale.

Grafik 5.26. Kontributi në shumë nominale dhe reale në FPD, vitet 2013 -2020



¹⁹ Vlera mesatare është llogaritur si mesatare e ponderuar të njësive kontabël të fondeve pensionale të detyrueshme në krahasim me mjetet-neto të fondeve pensionale të detyrueshme.

5.7. Kompensime të fondeve pensionale të detyrueshme

Për kryerjen e funksioneve të tyre për menaxhimin me mjete e fondit pensional të detyrueshëm, vlerësim të mjeteve, anëtarësim, mbajtja e llogarive individuale të anëtarëve dhe informim të anëtarëve si dhe pagesa e kompensimeve për MAPAS, për Fondin e PIOSM dhe për Kujdestarin e pasurisë dhe mbulimin e shpenzimeve të veta, shoqëritë në përputhje me Ligjin arkëtojnë kompensim nga kontributet, kompensim nga mjetet dhe kompensim për kalim.

Mënyra e tillë e financimit e shoqërive pensionale është normale për shoqëritë të cilat funksionojnë në sistemin pensional të ngjashëm me atë maqedonas. Kompensimi që arkëtohet si përqindje nga kontributet paguhet njëherë nga pagesa e kontributit dhe pastaj i njëjti kontribut investohet deri në tërheqjen e mjeteve, ndërsa kompensimi që arkëtohet nga mjetet arkëtohet në fund të çdo muaji nga totali i mjeteve që menaxhohen. Kompensimet të bazuara në kontribute kanë peshë, në fillim” ose janë relativisht të larta në vitet e para. Kompensimet të bazuara në mjetet kanë peshë „në fund“ pasi mjetet e akumuluar janë shumë më të mëdha sa më afër daljes në pension²⁰. E parë në afat të gjatë, kompensimi nga kontributet nuk do të ketë ndikim të dukshëm mbi shumën e pensionit të anëtarit ndërsa kompensimi nga mjetet do bëhet më i rëndësishëm me kalimin e viteve.

Llojet dhe shumat e kompensimeve të cilat i arkëton shoqëritë të cilat menxhojnë me fondet pensionale të detyrueshme në vitin 2020 janë pasqyruar në tabelën 5.13.

Tabela 5.13. Kompensime të cilat i arkëtojnë shoqëritë të cilat menxhojnë me fondet pensionale të detyrueshme për vitin 2020

Lloji i kompensimit	SAVA	KBP	TRIGLAV***
Kompensimi nga kontributet	2,00%*	2,00%*	2,00%
Tarifë mujore nga vlera e mjeteve neto të fondit të pensionit të detyrueshëm	0,030%**	0,030%**	0,030%**
Kompensimi për kalim			
Numri i ditëve ****	Shuma e kompensimit për kalim	Shuma e kompensimit për kalim	Shuma e kompensimit për kalim
Numri i ditëve ≤ 720	15 euro	15 euro	15 euro
Numri i ditëve > 720	Nuk pagohet kompensimi për kalim	Nuk pagohet kompensimi për kalim	Nuk pagohet kompensimi për kalim

* Shuma është njëjtë me maksimumin ligjor të përcaktuar për vitin 2020 (më parë ishte 2,25% tek të gjitha FPD).

** Shuma është njëjtë me maksimumin ligjor të përcaktuar për vitin 2019 (më parë ishte 0,035% edhe tek SAVAZ edhe tek KBPz).

*** Shuma është njëjtë me maksimumin ligjor të përcaktuar për vitin 2019. Nga Prilli i vitit 2019

**** Numri i ditëve llogaritet nga data nga e cila anëtarit fitoi statusin e anëtarit në fondin pensional të detyrueshëm aktual (ose nga para muajit kur anëtarit fitoi të drejtën e kontributit në fondin pensional të detyrueshëm aktual, në rastin e anëtarësimit të parë) deri në datën e transferimit të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit në fondin pensional të detyrueshëm të ardhshëm.

²⁰ Administrative Charges for Funded Pensions: An International Comparison and Assessment, Edward Whitehouse, June 2000.

Fillimisht kompensimi nga kontributet ishte i përcaktuar me tender ndërsa kompensimi fillestar që e arkëtonin SAVA dhe KB Prvo ishte 8,50%. Më pas me zhvillimin e sistemit dhe me uljen e kompensimeve të cilat i arkëtonin institucionet shtetërore nga shoqëritë si dhe me ritjen e kontributeve dhe mjeteve të cilat janë bazë për përlogaritje pasonte ulje graduale e kontinuar të këtij kompensimi. Shuma e kompensimeve nga kontributet të cilat arkëtohen nga fillimi i ekzistencës të sistemit deri më vitin 2020 është pasqyruar në tabelën 5.14.

Tabela 5.14. Shuma e kompensimeve nga kontributet të cilat i arkëtojnë shoqëritë pensionale në shtyllën e dytë

Shoqeria pensionale	Shuma	Data e zbatimit
SAVA	9,90%	Në tender
	8,50%	Nga fillimi i sistemit (v. 2006)
	7,90%	Nga korriku v. 2007
	6,90%	Nga shkurti v. 2008
	6,50%	Nga maji v. 2009
	5,50%	Nga janari v. 2010
	4,50%	Nga janari v. 2011
	4,00%	Nga janari v. 2012
	3,75%	Nga qershori v. 2013
	3,50%	Nga janari v. 2014
	3,25%	Nga janari v. 2015
	3,00%	Nga janari v. 2016
	2,75%	Nga janari v. 2017
	2,50%	Nga janari v. 2018
	2,25%	Nga janari v. 2019
	2,00%	Nga janari v. 2020
KB Prvo	9,90%	Në tender
	8,50%	Që nga fillimi i sistemit (v. 2006)
	7,90%	Nga korriku v. 2007
	6,80%	Nga shkurti v. 2008
	5,50%	Nga janari v. 2010
	4,50%	Nga janari v. 2011
	4,00%	Nga janari v. 2012
	3,75%	Nga qershori v. 2013
	3,50%	Nga janari v. 2014
	3,25%	Nga janari v. 2015
	3,00%	Nga janari v. 2016
	2,75%	Nga janari v. 2017
	2,50%	Nga janari v. 2018
	2,25%	Nga janari v. 2019
	2,00%	Nga janari v. 2020
TRIGLAVz	2,25%	Nga prilli v. 2019
		Nga janari v. 2020

Kompensimi nga mjetet ishte përcaktuar me ligj dhe deri në maj të vitit 2013 ishte 0,05% në muaj nga vlera e mjeteve –neto të fondit pensional të detyrueshëm më pas deri në dhjetor të vitit 2014 ishte 0,045%. Nga janari i vitit 2015 kompensimi ishte 0,04%, deri në dhjetor të vitit. Nga janari i vitit 2017 kompensimi nga mjetet ishte 0,035%. Nga janari i vitit 2019 kompensimi i mjeteve nga mjetet ishte 0,030%.

Nga viti 2013 me Ligj ishte përcaktuar shuma maksimale e kompensimit nga kontributet dhe kompensimi nga mjetet që do të mund ta arkëtojnë shoqëritë pensionale dhe ishte parashikuar ulja graduale e mëtejme.

Arkëtimi i kompensimeve (në milion denarë) nga ana e shoqërive gjatë vitit 2020 është paraqitur në tabelën 5.15.

Tabela 5.15. Arkëtim të kompensimeve nga ana e shoqërive në vitin 2020 (në milion denarë)

	Jan.	Shku.	Mar.	Prill.	Maj	Qesh.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Nën.	Dhje.	Gjithsej
SAVAz - gjithsej	17,19	17,38	17,54	18,58	17,50	18,29	18,05	18,81	19,74	18,21	18,64	21,17	221,11
Nga kontributet	6,43	6,48	7,11	7,94	6,58	7,16	6,77	7,42	8,22	6,56	6,78	9,14	86,58
Nga mjetet	10,77	10,90	10,43	10,64	10,92	11,13	11,29	11,40	11,51	11,64	11,86	12,04	134,53
KBPz – gjithsej	19,07	19,30	19,28	20,41	19,32	20,30	19,91	20,81	21,86	20,27	20,75	23,44	244,73
Nga kontributet	7,01	7,07	7,72	8,62	7,19	7,89	7,30	8,03	8,95	7,17	7,38	9,88	94,21
Nga mjetet	12,06	12,23	11,56	11,79	12,13	12,41	12,61	12,78	12,91	13,10	13,37	13,57	150,52
TRIGLAVz – gjithsej	0,33	0,36	0,44	0,50	0,47	0,53	0,56	0,63	0,70	0,67	0,74	0,91	6,84
Nga kontributet	0,21	0,23	0,28	0,33	0,29	0,33	0,33	0,38	0,44	0,38	0,43	0,58	4,22
Nga mjetet	0,12	0,13	0,15	0,18	0,19	0,20	0,22	0,24	0,26	0,29	0,31	0,33	2,62

Komisionet e transaksionit në lidhje me transaksionet për fitimin ose transferimin e mjeteve të fondit pensional të detyrueshëm paguhen nga mjetet e fondit pensional të detyrueshëm personave juridik të zgjedhur të cilët kryejnë shërbime të letrave me vlerë në vend dhe jashtë vendit. Komisionet e transaksioneve përlllogariten si përqindje nga vlerës për çdo transaksion të kontraktuar.

Gjatë vitit 2020 nga SAVAz ishin arkëtuar gjithsej 1,77 milion denarë kompensime transaksioni, nga KBPz ishin arkëtuar gjithsej 0,12 milion denarë dhe nga TRIGLAVz ishin arkëtuar gjithsej 0,15 milion denarë kompensime transaksioni.

5.8. Pagesa e pensioneve nga financimi kapital i sigurimit pensional të detyrueshëm

Kushtet për perfitimin e të drejtës së pensionit janë të njëjta edhe për shtyllën e parë dhe për të dytën: kufiri i moshës deri më 64 vite për burra dhe 62 vite për gra me minimum 15 vite stazh pune.

Nga shtylla e parë kryhet pagesa e një pjese nga pensioni i pleqërisë, të familjes dhe të invaliditetit si dhe nga pensioni minimal. Pensioni nga shtylla e parë përlllogaritet si pension i definuar sipas formulës të përcaktuar më parë (përqindje të caktuar, në varësi të viteve të stazhit, i shumëuar me bazën e pensionit e përcaktuar nga rroga e vlerësuar nga totali i stazhit të punës).

Nga shtylla e dytë kryhet pagesa e një pjese të pensioni të pleqërisë të llojit sipas zgjedhjes të anëtarit:

- pensioni vjetor me shumën totale të mjeteve të akumuluar në llogarinë individuale të anëtarit; pensioni vjetor paguhet në fund të jetës nga shoqëria e sigurimit e autorizuar për këtë qëllim овластено ose
- tërheqje të programuara nga mjetet e akumuluar të llogarive individuale të anëtarit dhe paguhet nga shoqëria që menaxhon me fondin pensional të detyrueshëm ose
- kombinim të metodave të sipërmendura

Sigurimi i pensioneve vjetore, tërheqja e programuar është regulluar me Ligjin e pagesës të pensioneve dhe kompensimeve nga sigurimi pensional me financim kapital.

Në qoftëse i siguruari që përfitoi të drejtën e pensionit të invaliditetit është anëtar i shtyllës së dytë shuma totale e mjeteve të llogarisë të atij anëtar transferohen në Fondin PIOSM dhe pagesa totale e pensionit të invaliditetit paguhet nga Fondi i PIOSM. Me përjashtim nëqoftëse mjetet e akumuluar të llogarisë të anëtarit janë më të mëdha nga shuma e duhur për pagesën e pensionit të invaliditetit, në përputhje me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor, atëherë anëtar mund të zgjedhë në vend të atij pensioni zgjedh pensionin e shtyllës së dytë.

Në rast vdekje të anëtarit të fondit pensional të detyrueshëm nga shtylla e dytë anëtarët e të cilit kanë të drejtën e pensionit familjar shuma totale e mjeteve e atij anëtar transferohen në fondin e PIOSM dhe pagesa totale e pensionit familjar paguhet nga Fondi i PIOSM. Me përjashtim nëqoftëse mjetet e akumuluar në llogarinë e anëtarit janë më shumë nga shuma e duhur për pagesën e pensionit familjar në përputhje me Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor atëherë përfituesi i pensioni familjar mund të zgjedhë në vend të atij pensioni mund të përfitoj pension të shtyllës së dytë.

Gjatë vitit 2020 ishin realizuar 46 pensione invaliditeti dhe 162 pensione familjare nga ana e anëtarëve të të shtyllës së dytë ose anëtarëve të familjes të personit të vdekur për arsye se mjete e tyre të akumuluar ishin transferuar në Fondin e PIOSM nga ku paguhet invaliditeti ose pensioni familjar. Në vitin 2020 asnjë anëtarë i fondit pensional të detyrueshëm nuk përfitoi të drejtën e pagesës nëpërmjet tërheqjeve të programuara. Në vitin 2020 paguhej pensioni i pleqërisë nëpërmjet tërheqjeve të programuara por vetëm 18 anëtarë të cilët filluan ti tërheqin mjetet e viteve të kaluara.

Janë parashikuar edhe raste në të cilat kryhet pagesa e mjeteve nga llogaria individuale e anëtarit dhe pastaj të mos ketë përfitim të së drejtës së pensionit dhe konkretisht:

- kur anëtar i vdekur i fondit pensional të detyrueshëm nuk ka anëtarë të familjes të cilët kanë të drejtën e pensioni familjar atëherë mjetet e llogarisë të atij anëtar bëhen pjesë e pasurisë të trashëgimlënësit dhe me ato veprohet në përputhje me Ligjin për trashëgimi;
- kur një anëtar i fondit pensional të detyrueshëm nuk do ta fitoj të drejtën e pensionit të pleqërisë sipas Ligjit për sigurim pensional dhe invaliditeti për arsye që ska mbushur stazhin e pensionit më së pakti 15 vjet, mund të përfitoj vetëm nga mjetet e shtyllës së dytë nëqoftëse pensioni është më i madh dhe i njëjtë me 40% nga shuma e pensionit më të vogël, ndërsa nëqoftëse shuma e përlllogaritur e pensionit është më e vogël se 40% nga shuma minimale e pensionit, fondi pensional i detyrueshëm i anëtarit menjëherë do ti paguaj mjetet e akumuluar në llogarinë e tij. Përfitimi i pensionit vetë me mjetet e shtyllës së dytë dhe pagesa e totali të mjeteve të akumuluar në këto raste mund të kryhet pas mbushjes së moshës 65 vjeç.

Gjatë vitit 2020 ishin paguar mjete si trashëgimi nga llogaritë individuale të 79 anëtarëve të vdekur.


Pasqyrë e detajuar e pensioneve të realizuara dhe pagesa e anëtarëve të shtyllës së dytë në vitin 2020 sipas fondeve të detyrueshme është dhënë në tabelën 5.16.

Tabela 5.16. Pensione dhe pagesa të realizuara në shtyllën e dytë në vitin 2020

Lloji i pensionit dhe pagesa / Fondi i detyrueshëm i pensionit	SAVAz	KBPz	TRIGLAVz	Gjithsej
Pension invaliditeti	16	29	1	46
Pension familjar	71	90	1	162
Pension i pleqërisë - tërheqje të programuara	0	0	0	0
Pagesë e njehershme - anëtar	2	2	0	4
Pagesë e njehershme - trashëgimi	49	30	0	79
Gjithsej	138	151	2	291

Në grafikun 5.27. është pasqyruar struktura e pesnioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e dytë, në katërmëdhjetë vitet e ekzistencës të shtyllës së dytë për vitin 2020. Numri i pagesave është shumë i vogël pasi anëtarët janë persona të rinj. Pjesa më e madhe e pagesave janë në rast vdekje të anëtarit nëpërmjet pensionit familjar të realizuar ose pagesës së trashëgimisë dhe pagesave mbi bazën e pensionit të invaliditetit të realizuar, ndërsa më i vogël është numri i pagesave të njehershme të anëtarëve dhe pagesa e anëtarëve nëpërmjet tërheqjeve të programuara.

Grafik 5.27. Struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e dytë nga fillimi i sistemit



6. Informacione për fondet pensionale vullnetare

- 6.1. Qëllimi i financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar**
- 6.2. Anëtarësia në fondet pensionale vullnetare**
- 6.3. Kalimi i anëtarit nga një llogari në një tjetër në të njëjtin ose në fond pensional vullnetar tjetër**
- 6.4. Kontributet në fondet pensionale vullnetare**
- 6.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale vullnetare**
- 6.6. Mjetet-neto, njësia e kontabilitetit dhe norma e kontributit të fondeve pensionale vullnetare**
- 6.7. Kompensime tek fondet pensionale vullnetare**
- 6.8. Pagesa e kompensimeve pensionale nga financimi kapital i sigurimit pensional vullnetar**

6. Informacione për fondet pensionale vullnetare

6.1. Qëllimi i financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar

Qëllimi parësor i financimit kapital të sigurimit pensional është sigurimi e një të ardhure më të lartë pas daljes në pension, për të siguruarit të cilët janë të siguruar në sistemin pensional një shtyllësh ose dyshtyllësh, të sigurohet pension për personat të cilët nuk janë përfshirë në sigurimin pensional të detyrueshëm personalisht për vete ose nga persona të tjerë dhe sigurimin e parakushteve për vendosjen e skemave pensionale profesionale në procesin e përputhshmërisë të sistemit të sigurimit social në RMV me sistemin e BE. Shkaqet kryesore të financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar janë: sigurimin e mjeteve suplementare në kohën e pleqërisë, anëtarësimin mbi bazë vullnetare, financim kapital mbi principin të kontributeve të definuara, investim të mjeteve në bazë të sigurisë, deversifikim të rrezikut dhe mbajtjen e likuiditetit adekuat si dhe transparencë.

Sigurimi pensional vullnetar mundëson përfshirje të një grupi të madh të popullsisë në RMV, si të personave të cilët nuk janë shtetas të RMV. Kjo mundëson kursim suplementar për pleqëri me të cilën rritet sigurimi material gjatë pleqërisë. Më pas në përputhje me praktikat e zakonshme në shumë shtete evropiane ku ekzistojnë skemat pensionale profesionale nëpërmjet të cilëve punëdhënësit ose shoqatat e qytetarëve, organizojnë dhe financojnë sigurim pensional vullnetar për punonjësit e vet ose anëtarë kjo është mundësuar edhe në RMV. Përderisa sistemet evropiane për sigurim social janë nën presion i cili vazhdimisht rritet, pensionet profesionale në të ardhmen gjithnjë e më shumë do të kenë rolin e plotësimit të të ardhurave pas daljes në pension. Nga këto arsye duhet të zhvillohen pensionet profesionale, sigurimi social plotësues me qëllim sigurimin e një sigurimi social të sigurt, të përhershëm dhe efikas i cili duhet të garantoj një standart jetese të mirë gjatë pleqërisë. Në shtyllën e tretë punëdhënësi ose shoqatat e qytetarëve (siguruesi) mund të organizoj dhe financoj skemë pensionale profesionale dhe të paguaj kontribut në fondin pensional vullnetar për të gjithë punonjësit dhe anëtarët. Shumica e punëdhënësve ose shoqatave të qytetarëve mundet së bashku të organizojnë dhe të financojnë skema pensionale. Siguruesi nënshkruan kontratë që e zgjedhi të menaxhoj me fondin pensional vullnetar në të cilin do të jetë përfshirë skema pensionale profesionale.

Pritet që financimi kapital i sigurimit pensional vullnetar të ketë ndikim më të madh suplementar mbi ekonominë në tërësi nëpërmjet rritjes së kursimit të popullsisë, rritjen e fuqisë të investimit dhe në nxitjen e zhvillimit dhe thellimin e tregut të kapitalit nëpërmjet investimit të mjeteve të fondeve pensionale vullnetare, rritjes së kërkesës për instrumenta të rinj nëpërmjet shërbimeve të reja financiare e tj.

Financimi kapital i sigurimit pensional vullnetar u bë operativ në gjysmën e dytë të vitit 2009 kështu që në shoqëritë ekzistuese i ish-in ndarë licenca për menaxhim me fondet pensionale vullnetare. Sigurimi pensional vullnetar „NLB pension plus “ – Shkup filloi punë më 15.7.2009 ndërsa KB Fondi i parë pensional vullnetar i hapur – Shkup më 31.12.2009. Në qershor të vitit 2018 MAPAS dha miratim për ndryshim të emërimit të fondit vullnetar fond pensional vullnetar i Hapur „NLB pension plus“ Shkup në fond pensional Fond pensional vullnetar i Hapur SAVA pension plus. Triglav fondi pensional vullnetar filloi punë më dt 1.3.2021²¹.

²¹ Analizat në raportin nuk e përfshijnë Triglav fond pensional vullnetar i hapur – Shkup pasi Raporti i referohet vitit 2020

6.2. Anëtarësia në fondet pensionale vullnetare

Një person mund ta fitoj anëtarësinë në fondin pensional vullnetar në tre mënyra:


- 1) me nënshkrimin e kontratës për anëtarësi në fondin pensional vullnetar midis personit dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë individuale,
- 2) me nënshkrimin e kontratës së anëtarësisë në fondin pensional vullnetar midis personit, person fizik i cili paguan në emër dhe në llogari të personit (paguesi) dhe shoqërisë dhe me hapjen e llogarisë vullnetare individuale,
- 3) me pjesëmarrje në skemën pensionale profesionale i organizuar nga punëdhënësi i vet ose nga shoqata në të cilën është anëtar dhe me hapjen e llogarisë profesionale.

Një person mund të ketë vetëm një llogari individuale vullnetare dhe një llogari profesionale. Këto llogari mund të jenë në të njëjtin fond pensional vullnetar ose në fonde të ndryshme.

Rritja e anëtarësisë në fondet pensionale vullnetare në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 e mban të njëjtin ritëm modest si në vitin e kaluar. Në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital gjendje më dt 31.12.2020 ka gjithsej 26.016 anëtarë që do të thotë 835 anëtarë më shumë se më 31.12.2019 ose ka në rritje të anëtarësisë për rreth 3,3%. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve në shtyllën e tretë 11,018 ose 42 % janë anëtarë me llogari individuale vullnetare ndërkohë 14.998 ose rreth 58% pjesëmarrës në skemën pensionale me llogari profesionale. Për sa i përket shpërndarjes së anëtarëve sipas fondeve pensionale vullnetare me gjendje më 31.12.2020 nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm në krahasim me gjendjen e vitit të kaluar ose rreth 43% të anëtarëve janë në SAVAd ndërsa 57%, janë në KBPd.

Nga grafiku 6.1., ku janë paraqitur struktura e anëtarëve sipas fondeve pensionale vullnetare dhe sipas tipit të anëtarësisë në vitin 2020, në nivel tremujor mund të vihet re një dallim i dukshëm persa i përket llojit të anëtarësisë tek të dy fondet pensionale vullnetare me llojin e anëtarësisë. Pra SAVAd ka një numër ë të madh anëtarësh me llogari individuale vullnetare (68%), ndërsa KBPd ka më shumë anëtarë në skema pensionale me llogari profesionale (77%). Për sa i përket strukturës të anëtarëve sipas tipeve me gjendje më 31.12.2020 edhe tek SAVAd edhe tek KBPd nuk ka ndryshim të dukshëm në krahasim me gjendjen e vitit të kaluar.


Grafik 6.1. Struktura e anëtarëve sipas FPV dhe sipas tipit të anëtarësisë



Nga eksperiencia e deritanishme më shpesh anëtarët në cilët kanë llogari individuale vetë i paguajnë mjetet ndërsa në një numër të vogël rastesh ka anëtarë për të cilat paguesi e paguan kontributin(nga 11,018 anëtarë gjithsej të cilët kanë llogari individuale vetëm 559 anëtarë ose 5% kanë pagues). Financimi kapital i sigurimit pensional vullnetarmundëson anëtarësim edhe të personave që nuk janë shtetas të RMV. Në ekzistencën e deritanishme në shtyllën e tretë ekzistojnë një numër i vogël anëtarësh të cilët janë shtetas të huaj (0,02% të totalit të anëtarëve).


Në lidhje me pjesëmarrjen e anëtarëve në skemën pensionale profesionale në SAVAd, 3.560 anëtarë janë pjesëmarrës në 1.202 skema pensionale profesionale ndërsa në KBPD 11,438 anëtarë janë pjesëmarrës në 2,893 skema pensionale profesionale. Ekzistojnë skema pensionale profesionale me disa dhjetëra anëtarë dhe skema pensionale profesionale me nga vetëm 1 ose 2 anëtarë. Nga totali i skemave 14 skema pensionale profesionale kanë nga mbi 100 anëtarë, tre skema kanë me nga mbi 500 anëtarë nga të cilët njëra ka mbi 1000 anëtarë. Shpërndarja e anëtarëve në skemat pensionale profesionale sipas fonde ve është dhënë në grafikun 6.2., në të cilin një për një janë paraqitur vetëm skemat që kanë nga 100 anëtarë ndërsa skemat e tjera janë përfshirë në grupimin, të tjera”.

Grafik 6.2. Shpërndarje në shtyllën e dytë në skemat pensionale profesionale



Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë sipas moshës, gjinisë dhe sipas tipit të anëtarësisë është paraqitur në grafikun 6.3.


Grafik 6.3. Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë sipas moshës, gjinisë dhe tipit të anëtarësisë



Nga kjo paraqitje grafike mund të vihet re se në shtyllën e tretë në krahasim me shtyllën e dytë ka më shumë anëtarë më të moshuar. Diçka më tepër se 60% e anëtarëve me llogari individuale vullnetare janë në moshën deri më 45 vjeç ndërsa diçka më tepër se 60% e anëtarëve me llogari profesionale janë në moshën deri 50 vjeç, Anëtarët të cilët kanë llogari profesionale janë më të moshuar në krahasim me anëtarët me llogari individuale. Mosha mesatare e anëtarëve me llogari individuale është 44 vjeç për burra dhe 43 vjeç për gra ndërsa për anëtarët me llogari individuale është 48 vjeç për burra dhe 47 për gra ndërkohë mosha mesatare të të gjithë anëtarëve gjithsej është 46 vjeç.

Pjesëmarrja në numrin total të anëtarëve në shtyllën e tretë në popullsinë totale të aftë për punë dhe në popullsinë totale aktive është modeste. Me gjendjen në fund të vitit 2020 vetëm rreth 1,5% e popullsisë totale të aftë për punë në RMV janë anëtarë të shtyllës së tretë ose rreth 2,7% nga popullsia aktive totale në RMV janë anëtarë të shtyllës së tretë. Struktura e anëtarëve të shtyllës së tretë në popullsinë totale të aftë për punë dhe popullsinë aktive në RMV sipas grupmoshave dhe sipas gjinisë me gjendje më 31.12.2020 është paraqitur në grafik 6.4.


Grafik 6.4. Struktura e anëtarëve në shtyllën e tretë në popullsinë totale të aftë për punë dhe në popullsinë aktive sipas grupmoshave dhe gjinisë



Nga kjo paraqitje grafike mund të vihet re se sipas grupmoshave pjesëmarrje më të madhe në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital ka tek popullsia aktive e moshës mbi 65 vjeç (rreth 9% edhe burra edhe gra) është përfshirë në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital. Ky rezultat tregon se ekziston potencial i dukshëm për zhvillimin e shtyllës së tretë.

Struktura e anëtarëve në fondet pensionale vullnetare sipas rajoneve statistikore²² në RMV është dhënë në grafikun 6.5.

Grafik 6.5. Struktura e anëtarëve të shtyllës së tretë sipas rajoneve statistikore



Më shumë anëtarë në të dy fondet pensional vullnetarë ka në rajonin e Shkupit, 6327 anëtarë në KBPd dhe 4,842 anëtarë në SAVAd. Më pak anëtarë në SAVAd ka nga rajoni Verilindor (598 anëtarë), ndërsa më pak anëtarë në KBPd ka nga rajoni juglindor (591).

6.3. Kalimi i anëtarit nga një llogari në një tjetër në të njëjtin ose në fond pensional vullnetar tjetër

Personat kanë të drejtën e zgjedhjes të fondit pensional vullnetar dhe të drejtën e ndërrimit të fondit pensional vullnetar të zgjedhur me dëshirën e vet në çdo kohë. Nëqoftëse anëtari është anëtar i fondit pensional vullnetar ekzistues më pak se 12 muaj gjatë kalimit duhet të paguaj kompensim për kalim. Ndryshe kalimi është falas. Gjatë kalimit transferohen edhe mjetet totale nga llogaria e anëtari. Gjithashtu edhe gjatë kalimit të pjesëtarit në skemën pensionale profesionale nga një sigures në tjetër ai ka të drejtë të transferoj mjetet e kursyera në skemën profesionale në llogarinë profesionale ose në llogarinë vullnetare individuale nëqoftëse siguresi tjetër nuk ka organizuar skemë pensionale profesionale ose nuk e ka përfshirë personin në të. Anëtari i cili është pjesëtar në skemën pensionale profesionale ka të drejtën e transfeimit të mjeteve në llogarinë individuale vullnetare nëqoftëse nuk punësohet ose nuk anëtarësohet në shoqatat e qytetarëve.

Në tabelën 6.1. janë dhënë të dhëna për numrin e anëtarëve të cilët kaluan nga një fond pensional vullnetar në një tjetër dhe për shumën e mjeteve të transferuara nga fond pensional vullnetar në një tjetër gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2020, 17 anëtarë kaluan nga SAVAd në KBPd, ndërkohë 14 anëtarë kaluan nga KBPd në SAVAd (gjithsej 0,12% nga numri total i anëtarëve).

²² Rajonet statistikore janë definuar sipas DZC – njësi teritoriale. Nomenklatura e njësive teritoriale është bazuar mbi organizimin teritorial të vetqeverisjes lokale në RMV dhe është në përputhje me klasifikacionet e BE.

Gjatë kalimit rreth 4,8 milion denarë janë transferuar nga SAVAd në KBPd dhe rreth 2,2 milion denarë janë transferuar nga KBPd në SAVAd. Gjithashtu gjatë viti 2020 kishte edhe kalime në kuadrin e të njëjtit fond pensional nga një skemë profesionale në një tjetër dhe nga llogari profesionale në një llogari individuale vullnetare.

Tabela 6.1. Kailmi i anëtarëve nga një fond pensional vullnetar në tjetër

2020	Anëtarë të cilët kaluan NGA fondi pensional vullnetar	Mjetet që janë transferuar NGA fondi pensional vullnetar	Anëtarë të cilët kaluan NË fondin pensional vullnetar	Mjetet që janë transferuar NË fondi pensional vullnetar
SAVAd	17	4.823.019	14	2.175.824
KBPd	14	2.175.824	17	4.823.019

6.4. Kontributet në fondet pensionale vullnetare

Pagesë të kontributit vullnetar mund të kryhet vetëm për persona i cili i ka mbushur kushtet për anëtarësi në fondin pensional vullnetar në përputhje me Ligjin për sigurimin pensional vullnetar me financim kapital. Pagesë të kontributit vullnetar në emër dhe për llogari të një anëtar i cili ka llogari individuale profesionale mund ta kryej anëtar i ose paguesi. Pagesa e kontributit vullnetar në emër dhe për llogari të një anëtar i cili ka llogari profesionale mund ta kryej vetëm siguresi. Pagesat kryhen nga llogaria e transaksionit të anëtarit ose/dhe paguesit ose nga siguresi. Kontributi vullnetar paguhet në llogari monetare të veçantë në fondin vullnetar e cila mbahet tek Kujdestari i pasurisë dhe shpërndahet në llogarinë individuale vullnetare ose në llogarinë profesionale të anëtarit në varësi të mënyrës së anëtarësisimit dhe pas mbushjes së kushteve të anëtarësisë.

Anëtar i, paguesi dhe siguresi, kanë të drejtë lirshëm të përcaktojnë masën e shumës së kontributeve të paguara në kontributin vullnetar dhe dinamikën e pagesës, ndërsa ndryshimi i masës së pagesës ose ndërprerja e pagesës nuk ndikon në të drejtën e anëtarësisë në fond, dmth nuk do të thotë ndërprerje të anëtarësisë. Shumat e kontributeve vullnetare i përcakton siguresi për të gjithë pjesëmarrsit me skemë pensionale profesionale skemë të cilën ai e organizon dhe e financon dhe i përcakton si përqindje nga paga e anëtarit i cili është përfshirë në skemën pensionale profesionale.


Gjatë vitit 2020 në fondet pensionale vullnetare janë paguar gjithsej rreth 317 milion ose sipas muajve siç është paraqitur në tabelën 6.2.

Tabela 6.2. Kontribute të shtyllës së tretë sipas muajve dhe fondeve (në milion denarë)

	Gjithsej 2019	Jan.	Shku.	Mar.	Prill.	Maj	Qer.	Korr.	Gush.	Shta.	Tet.	Noe.	Dek.	Gjithsej 2020
SAVAd	169,68		Noe.	Dek.	9,63	12,52	8,57	9,70	7,89	8,16	16,70	10,33	27,31	161,68
KBPd	134,14	14,52	14,30	11,41	6,66	6,47	11,60	7,90	6,45	9,26	9,28	13,77	43,45	155,07
Gjithsej	303,83	31,76	29,89	29,46	16,28	18,98	20,17	17,60	14,34	17,42	25,98	24,10	70,76	316,76

Në vitin 2020 kontributet vullnetare totale të paguara në shtyllën e tretë shënojnë një ritje prej 4% në krahasim me vitin 2019. Kështu që në krahasim me vitin e kaluar shuma e kontributeve vullnetare totale të paguara në SAVAd është ulur me rreth 5%, ndërsa KBPD shënon një shumë të ritur të totalit të kontributet vullnetare të paguara për rreth 16%. Në vitin 2019 në SAVAd, është paguar një shumë më e madhe në kontributet vullnetare në krahasim me KBPD. Në vitin 2020 pjesëmarrja e kontributeve vullnetare në të dy fondet pensionale vullnetare që janë paguara në llogaritë profesionale është 55%, ndërkohë pjesëmarrja e kontributeve vullnetare të paguara në llogaritë individuale vullnetare është 45%. Ekziston dallim i dukshëm në këtë shpërndarje për sa i përket fondeve kështu që tek SAVAd kjo rindarje është pothuajse e njëjtë ndërsa tek KBPD 64% e totalit të kontributeve vullnetare janë paguar në llogaritë profesionale. Rindarja e pagesave sipas tipit të llogarisë në të cilën janë paguar edhe sipas fondit në nivel mujor është dhënë në grafikun 6.6.

Grafiku 6.6. Shpërndarja e pagesave në shtyllën e tretë sipas llojit të llogarisë dhe sipas fondit



6.5. Investimi dhe struktura e portofolit të fondeve pensionale vullnetare

Edhe në sigurimin pensional vullnetar me financim kapital si në sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital në fazën fillestare përdoren kontrolli proaktiv dhe kufizimet kvantitative dhe kualitative të investimeve. Megjithatë në dallim nga sigurimi pensional i detyrueshëm me financim kapital në atë vullnetar ka kushte më liberale në lidhje me investimin.

Krahas instrumenteve të cilat janë lejuar në fondet pensionale të detyrueshme për investimet jashtë shtetit është lejuar edhe investimi në letrat me vlerë debitoare të lëshuara nga Banka Qendrore Evropiane nga Banka Investuese Evropiane si dhe letra me vlerë debitoare të lëshuara nga vetëqeverisja vendore. Duke qenë se është e domozdoshëm që të arrihet diferzifikim i përshtatshëm midis llojeve të ndryshme të investimeve edhe tek fondet pensionale vullnetare,


janë parashikuar kufizime maksimale të investimeve të cilat mund të jenë investuar në lloje të ndryshme instrumentesh. Me qëllim që të parandalohen investimet në instrumenta të cilat nuk janë të përshtatshme për investim në fondet pensionale vullnetare, ligjërisht ndalohen investimet në aksione, obligacione dhe në letra me vlerë të tjera të cilat nuk kuotojnë në tregun oficial me të cilat publikisht nuk tregtohet, instrumente me të cilat nuk mund të disponohet nga ana juridike, instrumente të cilat nuk mund menjëherë të vlerësohen dhe artikuj me vlerë të pasigurt. Kufizimet maksimale investuese janë paraqitur në tabelën 6.3.

Tabela 6.3. Kufizimet maksimale investuese


Investimet jashtë shtetit (EU, OECD)	50%
-Obligacione dhe letra me vlerë të tjera të lëshuara nga qeveri të huaja dhe banka qendrore në shtetet e huaja dhe letra me vlerë debiti të lëshuara nga Banka qendrore Evropiane Banka investues Evropiane dhe Banka Botërore	50%
-letra me vlerë debiti të lëshuara nga vetëqeverisja vendore, nga kompani dhe banka të huaja jo shtetërore, aksione të lëshuara kompani dhe banka të huaja dhe dokumenta për pjesëmarrje, aksione dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga fondet investuese	30%
Letra me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga RMV në tregun e brendshëm ose nga NBPM	80%
Depozita banka, certifikata për depozita, shënime komerciale, obligacione dhe letra me vlerë mbi bazë të hipotekës të lëshuara nga bankat e vendit	60%
Obligacione të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe nga shoqëritë aksionere të cilat nuk janë banka	40%
-obligacione të lëshuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore	10%
Aksione të lëshuara nga shoqëri aksionere të brendshme	30%
Dokumenta për pjesëmarrje të fondeve investuese maqedonase	5%

Struktura e investimeve të fondeve pensionale vullnetare është paraqitur në grafikun 6.7. dhe në grafikun 6.8.

Grafik 6.7. Struktura e investimeve të SAVAd




Grafiku 6.8. Struktura e investimeve të KBPd




Struktura e investimeve të fondeve pensionale vullnetare me gjendje më 31.12.2020 nuk dallohet shumë në krahasim me gjendjen më 31.12.2019 dhe ajo është paraqitur në grafikun 6.9. Në vitin 2020 pjesëmarja e obligacioneve nga emetuesit e brendshëm të cilat përfshijnë obligacione të shtetërore të brendshme (43,93%) dhe obligacione korporative (obligacione të përhershme të lëshuar nga banka – 1,54%), në krahasim me vitin e kaluar shënon një ritje të vogël dhe është në masën 49,06%. Pjesëmarja e depozitave në bankat e brendshme ngelet pothuajse në të njëjtin nivel në krahasim me vitin e kaluar dhe është në masën 14,16%. Gjithashtu edhe pjesëmarja e aksioneve nga emetuesit e brendshëm ngelet në të njëjtin nivel në krahasim me vitin e kaluar dhe është në masën 8,11%. Një shumë e vogël nga investimet të fondeve pensionale vullnetare i përkasim investimeve në pjesëmarje nga fondet investuese të brendshme (0,01%). Pjesëmarja e investimeve jashtë shtetit është në masën 27,58% (21,90% në pjesëmarje në fondet investuese dhe 5,68% në aksione). Pjesa e mbetur e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare e përbëjnë mjetet monetare 1,06%, kërkesat 0,02%.

Grafik 6.9. Struktura e investimeve në shtyllën e tretë me gjendje më 31.12.2020



Gjatë vitit 2020 të dy fondet pensionale vullnetare i respektojnë kufizimet maksimale investuese. Në grafikun 6.10. është paraqitur pjesëmarrja në përqindje në portofolin sipas klasave të mjeteve tek SAVAd dhe tek KBPd dhe kufizimet ligjore me gjendjen më 31.12.2020.


6.10. Klasat e mjeteve në portofolin e FPV krahasuar me kufizimet ligjore



Fondet pensionale vullnetare kanë ekspozim më të madh të mjeteve në aksione nga emetuesit e brendshëm (8,11%) në krahasim me fondet pensionale të detyrueshme. Kështu që ekspozimi i aksioneve në emetuesit e vendit është më i madh tek SAVAd (13,03%) në krahasim me KBPd (3,27%).

Lëvizja e krahasuar e vlerës të MBI10, OMB dhe vlera e njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare gjatë vitit 2020 është paraqitur në grafikun 6.11. Vlera e njësive të kontabilitetit në SAVAd shënon rritje prej 1,60%, ndërsa vlera e njësive të kontabilitetit në KBPd shënon një rritje prej 3,68%. MBI10, gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin 2019 shënoi në rritje prej rreth 1,20%²⁴. OMB gjatë viti 2020 shënoi rritje prej 0,08%²³.

Grafik 6.11. Lëvizja e krahasuar të MBI10, OMB dhe vlera e njësive të kontabilitetit në FPV viti 2020




²³ Lëvizjet janë paraqitur nëpërmjet ndryshimit të indekseve /njësive në krahasim me indeksin fillestar i barazi me 100, më 31.12.2019

²⁴ Nzjerë: Bursa maqedonase Ad –Shkup Buletini vjetor statistikor 2020


Edhe tek fondet pensionale vullnetare pjesa më e madhe e mjeteve në vitin 2020 ishin investuar në letrat me vlerë shtetërore të vendit (43,93,46% tek SAVAd dhe 52,60% tek KBPd). Menjëherë pas tyre pasojnë investimet në instrumenta nga shoqëritë emetuese /aksionere të sektorit financiar (35,04% tek SAVAd dhe 42,28% kaj KBPd). Në kuadrin e këtij sektori tek SAVAd pjesëmarrje më e madhe është e depoziteve bankare të brendshme (42,8%) dhe pjesëmarrjet në fondet investuese të jashtme dhe të vendit (42,1%) dhe më e vogël është pjesëmarrja në shërbimet financiare (5,3%), obligacione të lëshuara nga bankat e vendit (5,4%). Tek KBPd në kuadrin e sektorit financiar mbizotron pjesëmarrja në fondet investuese të jashtme (68,4%), ndërsa pjesa e mbetur i përket depoziteve bankare të brendshme (31,6%). Krahas në sektorët e lartpërmendura, fondet pensionale vullnetare investojnë edhe në sektorë të tjerë: mallrat bazë, farmaci, mallrat e konsumit, industri, teknologjia informatike, energjia dhe shërbimet komunikatave, por me pjesëmarrje më të vogël (nga 0,36% deri më 5,02%). Struktura e investimeve të fondeve pensionale vullnetare sipas sektorëve është paraqitur në grafikun 6.12.

Grafik 6.12. Struktura e investimeve në FPV sipas sektorëve




Për sa i përket strukturës valutore të mjeteve të fondeve pensionale vullnetare që është paraqitur në grafikun 6.13., mund të vëmë re se pjesa më e madhe e SAVAd janë investuar në instrumente të valutës së vendit (41,94%), ndërsa pjesëmarrja e instrumenteve në euro kap shumën 38,36%. Gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin e kaluar tek SAVAd vihet re ritje e pjesëmarrjes në instrumente në denarë dhe ulje të pjesëmarrjes në instrumente në euro. Tek KBPd pjesa më e madhe nga mjetet janë investuar në instrumente në euro (36,84%), ndërsa pjesëmarrja në instrumente të valutës së brendshme është në masën 36,21%. Gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin e kaluar tek KBPd pjesëmarrja në instrumente në euro dhe denarë ka qenë afërsisht në të njëjtin nivel. Pjesëmarrja e investimeve në dollarë amerikanë (18,60% tek SAVAd dhe 26,96% tek KBPd) ngelen afërsisht në të njëjtin nivel në krahasim me vitin e kaluar. Struktura valutore tek SAVAd përfshin dhe një pjesë të vogël të instrumenteve të cilat janë investuar në franga zviceriane 1,10%.

Grafiku 6.13. Struktura valutore e mjeteve të FPV, 2019-2020



Nëqoftëse bëhet krahasim me vendet të cilat kanë sisteme pensionale të ngjashme me sistemin maqedonas mund të shihen ngjashmëri por edhe dallime në portofolin e investimeve të fondeve pensionale vullnetare. Në grafikun 6.14. është dhënë krahasimi tek investimet gjendja më 31.12.2020 të fondeve pensionale vullnetare në PMV me investimet në fondet pensionale vullnetare të disa shteteve të rajonit të cilat kanë implementuar financimin kapital të sigurimit pensional vullnetar²⁵.

Grafik 6.14. Portofoli i fondeve pensionale vullnetare në disa shtete dhe në PMV



Nëqoftëse portofoli i fondeve pensionale vullnetare shqyrtohet sipas instrumenteve, mund të vihet re se fondet pensionale në pothuajse të gjitha shtetet kanë ekspozim më të madh në obligacione dhe në letra me vlerë të tjera për të cilat shteti ose qeveria vendore janë garant (në Rumani 64%, Kroaci 55%, në bullgari 49%, ndërsa në përqindje më të vogël në Maqedoninë e Veriut 48%). Ekspozimi në depozitat bankare më i madh është në Maqedoninë e Veriut dhe është në masën 14%. Në dallim nga Maqedonia e Veriut, në vendet e tjera ekspozimi i depozitave në mënyrë të dukshme është më i vogël: Rumania (2%), Bullgaria (1%) dhe Kroacia (0,3%). Për sa i përket investimeve në aksione dhe në pjesëmarrje përqindjen më

²⁵ Nxjerrë: www.hanfa.hr; www.fsc.bg; www.asfromania.dhe përlogaritjet e veta

të madhe nga mjetet në aksione dhe në pjesëmarrje janë investuar në fondet pensionale të Maqedonisë së Veriut (36%), më pas Bullgaria (34%), Kroacia (32%) dhe në Rumani (30%). Fondet pensionale kanë investuar edhe në obligacionet korporative dhe konkretisht 7% tek fondet pensionale në Bullgari, 5% në Kroaci dhe 3% në Rumani. Në krahasim me fondet pensionale të vendeve të tjera pjesëmarrja e investimeve në obligacionet korporative tek fondet pensionale në Maqedoninë e Veriut në mënyrë të dukshme është më i vogël 1%. Vetëm në Bullgari fondet pensionale kanë investuar në pasuri të paluajtshme (2%), ndërsa në vendet e tjera shpeshherë ky instrument nuk është i lejuar. Për sa i përket investimit jashtë shtetit²⁶, fondet pensionale të Maqedonisë së Veriut ekspozimin më të madhe e kanë në investimet e huaja me 28% më pas pasojnë fondet pensionale në Kroaci 19% dhe në Rumani me 12%.

6.6. Mjetet-neto, njësia e kontabilitetit dhe norma e kontributit të fondeve pensionale vullnetare

Mënyra e përlllogaritjes së mjeteve-neto, të njësisë së kontabilitetit dhe të kontributit të fondeve pensionale vullnetare është i njëjtë edhe për fondet pensionale.

Ndryshimet e mjeteve të fondeve pensionale vullnetare nga fillimi deri në fund të vitit ndodhin për arsye:

- fluksi i kontributeve,
- dalje për shkak të kompensimeve dhe komisioneve të transaksionit,
- fluks nga kthimi i tatimit personal,
- fluks për shkak të kalimit nga fondi pensional vullnetar tjetër (për persona të cilët kanë qenë anëtarë në fond tjetër dhe më vonë kaluan në fondin aktual),
- dalje për shkak kalimi në fondin pensional të vullnetar tjetër (për persona të cilët në kohë kanë qenë anëtarë në fondin themelor më pas kanë kaluar në fondin tjetër),
- dalji për shkak pagesë trashëgimie,
- dalje për shka pagese të kompensimeve pensionale (pagesa të njëhershme dhe të shumfishta)
- fitime/humbje të/jo realizuara nga investimet

Duke u nisur nga vlera e mjeteve –neto në fund të viti të kaluar dhe duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e lartpërmendura vijmë tek vlera e mjeteve-neto në fund të vitit (që është paraqitur në tabelën 6.4.).

Tabela 6.4. Ndryshime të mjeteve të fondeve pensionale vullnetare (në milion denarë)


	SAVAd	KBPd
Mjetet neto më 31.12.2019.	998,78	990,04
Kontribute	161,68	155,07
Kompensime dhe kotribute	4,16	4,22
Kontribute të zvogëluara për kompensime nga kontributet	157,52	150,85
Pagesa në llogarinë individuale nga kthimi i tatimit personal	0,17	0,12
Kompensimi i mjeteve	12,47	9,32
Shpenzime për komisionet ndërmjetësuese	0,19	0,03
Kalimi nga fond tjetër	2,18	4,82
Kalim në fond tjetër	4,82	2,18
Pagesë trashëgimie	3,28	0,27
Pagesë kompensimi pensional–pagesë e njëhershme/ pagesë e shumfishtë	31,64	28,90
Fitimi-bruto nga investimet	31,38	49,36
Fitimi-neto nga investimet	18,72	40,02
Mjetet neto më 31.12.2020.	1.137,61	1.154,52

²⁶ Të dhënat për investimet jashtë shtetit në Bullgari me gjendje më 31.12.2020 nuk janë të disponueshme në të dhënat e marra.

Totali i mjeteve neto në fondet pensionale vullnetare me gjendje më 31.12.2020 kapin shumë rreth 2,29 miliard denarë ose rreth 37 milion euro që përfaqëson rreth 0,35% prej BPV.²⁷

Në grafikun 6.15. janë paraqitur vlerat e mjeteve –neto në fund të të gjithë viteve dhe rritja e tyre në përqindje në krahasim me mjetet neto të vitit të kaluar. Më tej mund të vihet re se mjetet-neto të dy fondeve pensionale vullnetare rriten me të njëjtin ritëm. Rritja më e madhe vihet re në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010. Në vitin 2020 vihet re vonim të rritjes të mjeteve neto edhe në SAVAd edhe në KBPd.


Grafik 6.15. Rritja e mjeteve –neto në SAVAd dhe në KBPd në përqindje në krahasim me vitin e kaluar




Lëvizja e vlerës së mjeteve –neto dhe kontributeve kumulative si dhe rritje kontributeve të paguara dhe rritja e mjeteve –neto në SAVAd dhe në KBPd, është paraqitur në grafikun 6.16. dhe në grafikun 6.17. Rritja e mjeteve neto të fondeve pensionale vullnetare është i implikuar nga rritja e kontributeve të paguara dhe nga rezultatet e investimeve. Pjesëmarrja e kontributeve kumulative në totalin e mjeteve neto gjatë viteve të para në mënyrë të dukshëm është e madhe dhe pastaj shënon ulje.

²⁷ Nxjerë për BDP: Instituti shtetëror statistikor – shpjegim – prodhimi bruto vendor për vitin 2020

Grafik 6.16. Rritja e mjeteve – neto në krahasim me rritjen e kontributeve të paguara në SAVAd



Grafiku 6.17. Rritja e mjeteve - neto krahasuar me rritjen e kontributeve të paguara në KBPd



Tek SAVAd, në periudhën fillestare (2009 – 2011), vihet re rritje e madhe e mjeteve – neto dhe e kontributeve të paguara. Në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011 rritja e mjeteve – neto është 54%, ndërsa tek kontributet e paguara vihet re një rënie prej 6%. Në gjashtë vitet pasuese rritja e mjeteve neto në SAVAd gradualisht ulet nga 49% deri në 25% në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017. Në vitin 2019 vihet re rritje prej 32%. Në vitin 2020 rritja e mjeteve neto të SAVAd përsëri ngadalësohet dhe është 14%. Ndërsa tek kontributet e paguara në vitin 2014 vihet re një rritje më e madhe në masë prej 50%, dhe në vitet pasuese rritja e kontributeve të paguara gradualisht ulet deri në vitin 2017. Në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 rritja e kontributeve të paguara përsëri është rritur dhe është 22%, ndërsa në vitin 2019 rritja është ulur dhe është në masën 7%. Në vitin 2020 vihet re ulje të kontributeve me 5% në krahasim me viti 2019.


Gjithashtu edhe tek KBPd, në periudhën fillestare (2010 – 2012), vihet re rritje e madhe e mjeteve –neto dhe e kontributeve të paguara. Në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012 rritja e mjeteve – neto ishte në masën 90%, ndërsa rritja e kontributeve të paguara rreth 61%. Në vitet e ardhshme rritja e mjeteve –neto dhe të kontributeve të paguara në KBPd fillojnë gradualisht të bien. Në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 tek KBPd, mjetet neto u ritën me 15%, ndërsa kontributet e paguara për 1%. Në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 tek KBPd, rritja e mjeteve- neto u rit dhe është 25%, por shuma e mjeteve të kontributeve të paguara shënon një rënie prej 5%. Në vitin 2020 përsëri vihet re një rritje të mjeteve neto ose mjetet neto u ritën për 17% në krahasim me vitin 2019. Shuma e kontributeve të paguara në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 u rit për 16%.

Lëvizja e vlerës së njësive të kontabilitetit në fondet pensionale vullnetare nga fillimi i punës të fondeve pensionale vullnetare deri më 31.12.2020 është dhënë në tabelën 6.5., në grafikun 6.18. dhe në grafikun 6.19. I dukshëm është trendi në rritje të njësive të kontabilitetit. Në vitin 2020 njësitë e kontabilitetit në dy fondet pensionale vullnetare shënuan oscilacione të mëdha nga të zakonshmet të shkaktuara nga gjendjet e disfavorshme të tregjeve financiare në kushtet e pandemisë të virusit Korona. Megjithatë gjatë viti 2020 njësitë e kontabilitetit tek të dy fondet pensionale vullnetare kanë trend të ngjashëm edhe pse i ngadaltë shënon rritje në krahasim me vitin e kaluar (1,60% në SAVAd dhe 3,68% në KBPd).

Tabela 6.5. Vlera e njësive të kontabilitetit që nga fillimi i ekzistencës së FPV

Data	Vlera e njësive të kontabilitetit	
	SAVAd	KBPd
15.09.2009	100,000000	0,000000
21.12.2009	102,815757	100,000000
31.12.2009	103,061825	100,204385
31.12.2010	107,592926	106,891617
31.12.2011	111,854726	112,639593
31.12.2012	118,742851	119,129537
31.12.2013	130,511147	129,015451
31.12.2014	140,946772	139,908803
31.12.2015	147,535595	146,709341
31.12.2016	154,578083	154,465341
31.12.2017	164,155073	162,989756
31.12.2018	169,649887	163,696595
31.12.2019	188,197689	181,404697
31.03.2020	175,991205	169,941204
30.06.2020	184,139839	179,223252
30.09.2020	185,949598	182,091176
31.12.2020	191,209810	188,085163

Grafiku 6.18. Vlera e njësisë së kontabilitetit që nga fillimi i ekzistencës së FPV



Grafiku 6.19. Vlera e njësisë së kontabilitetit të FPV në vitin 2020



Rendimenti i fondeve të pensionit vullnetar sipas periudhave, i reduktuar në bazë vjetore, tregohet në Tabelën 6.6.

Tabelën 6.6. Kontributi i FPV

Periudha ²⁸	SAVAd		KBPD	
	në shumën nominale	në shumën reale	në shumën nominale	në shumën reale
31.12.2009 - 31.12.2010	4,40%		6,67%	
31.12.2009 - 31.12.2011	4,18%		6,02%	
31.12.2009 - 31.12.2012	4,83%		5,93%	
31.12.2009 - 31.12.2013	6,08%	3,00%	6,52%	3,42%
31.12.2009 - 31.12.2014	6,46%	4,09%	6,90%	4,52%
31.12.2009 - 31.12.2015	6,16%	4,25%	6,56%	4,64%
31.12.2009 - 31.12.2016	5,96%	4,36%	6,37%	4,77%
31.12.2010 - 31.12.2017	6,22%	4,72%	6,21%	4,71%
31.12.2011 - 31.12.2018	6,13%	4,91%	5,48%	4,27%
31.12.2012 - 31.12.2019	6,80%	6,22%	6,19%	5,62%
31.03.2013 - 31.03.2020	5,30%	4,75%	4,76%	4,21%
30.06.2013 - 30.06.2020	5,91%	5,37%	5,47%	4,93%
30.09.2013 - 30.09.2020	5,82%	5,18%	5,47%	4,83%
31.12.2013 - 31.12.2020	5,60%	4,90%	5,53%	4,82%
Fillo - 31.12.2020	5,82%	4,27%	5,89%	4,31%

* Fillimi është 15.7.2009 për SAVAd dhe 21.12.2009 për KBPD

Kontributi i llogarisë vullnetare individuale dhe/ose profesionale është i ndryshueshëm dhe varet nga kontributi i fondit pensional vullnetar dhe nga kompensimet e paguara nga shoqëritë. Kontributi ose fitimi është parametër i cili realisht nuk mund të parashikohet pasi varet nga kushtet e tregut të kapitalit edhe në ekonominë e përgjithshme.

Kontributi i fondeve pensionale vullnetare llogaritet në të njëjtën mënyrë si tek kontributi në fondet pensionale të detyrueshme.


Duke pasur parasysh natyrën afatgjatë e sigurimit pensional mirë është të llogaritet edhe kontributi i fondeve pensionale vullnetare nga fillimi i ekzistencës së tyre, i ndjekur në nivel vjetor i cili për SAVAd është 5,82% në shumë nominale ose 4,27% në shumë reale ndërsa për KBPD 5,89% në shumë nominale ose 4,31% në vlerë reale.

Lëvizja e kontributit në vlerë nominale sipas periudhave mund të shihet në grafikun 6.20., ku janë paraqitur sipas periudhave nga dt. 31.12.2009 deri më dt. 31.12.2020 sipas fondeve. Në fillim vihet re rritje e kontributit kështu që në fund të gjysmës së parë të vitit 2011 vihen re kontribute të larta tek të dy fondet pensionale vullnetare ndërkohë në fund të vitit 2011 kishte rënie të kontributeve. Më pas në vitet e ardhshme në vitet e ardhshme pason rritje graduale të kontributit deri në mesin e vitit 2015 pas këtij momenti vihet re rënie të kontributit deri në mesin e vitit 2016 dhe më pas përsëri vihet re rritje të kontributit deri fund të vitit 2016. Në vitin

²⁸ Deri në miratimin e ndryshimeve të Ligjit të sigurimit pensional vullnetar me financim kapital, janari i vitit 2013, të ardhurat e fondit pensional vullnetar janë llogaritur për një periudhë 3-vjeçare, vetëm në shumën nominale.

2019 vihet re rritje të kontributit në krahasim me kontributin në fund të vitit 2018. Në vitin 2020 vihen re kontribute më të vogla në krahasim me vitin 2019 edhe tek SAVAd edhe tek KBPd, më shumë për shkak të gjendjeve të disfavorshme në tregjet financiare në kushtet e pandemisë së virusit Korona.

Grafik 6.20. Kontribut i FPV (në shumë nominale)




Lëvizja e kontributit në shumë nominale dhe reale në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2019 (në nivel vjetor) edhe në vitin 2020 (në nivel tremujor), sipas periudhave ligjore përkatëse të definuara i konveruar në normë vjetore ekuivalente të kontributit, sipas fondit pensional vullnetar mund të shihen në grafikun 6.21. Në vitin 2020 kontributi në shumë nominale dhe kontributi në vlerë reale shënojnë rritje edhe tek SAVAd (nga 5,30% deri 5,60% në shumë nominale dhe nga 4,75% deri në 4,90% në shumë reale) edhe tek KBPd (nga 4,76% do 5,53% në shumë nominale nga 4,21% deri në 4,82% në shumë reale). Por kriza ekonomike –shëndetësorë megjithatë ndikonte edhe në kontributet e llogaritura për periudhën shtatëvjeçare në vitin 2020. Kështu që shuma më e vogël e kontributit edhe në shumë nominale edhe në shumë reale është shënuar në periudhën nga 31.03.2013 - 31.03.2020 tek të gjitha fondet pensionale të cilët ekzistojnë më shumë se shtatë vjet dhe i njëjti është më i vogël mesatarisht nga 1,5 pikë në përqindje në krahasim me kontributin për periudhën nga 31.12.2012 - 31.12.2019. Në tremujorët që pasojnë ose në fund të viti 2020 kontributi shtatëvjeçar tek fondet pensionale shënon shuma më të larta (tek SAVAd në të tre tremujorët vihet re një rënie e butë, tek KBPd në tremujorin e katërt ka rritje të vogël në krahasim me tremujorin e tretë) por akoma nuk është në nivelin e kontributit shtatëvjeçar i arritur në fundin e vitit 2019. Në periudhën e shqyrtuar (vitet 2013-2020) ndryshimi i niveli të shpenzimeve të jetës në periudhat e përlllogaritura e ndjekur në nivel vjetor, shënon ulje që ndikon në afrimin gradual të kontributit në shumë reale drejt kontributit në shumë nominale.

Kontributi shtatëvjeçar në nivel të financimit kapital të sigurimit pensional vullnetar për periudhën 31.12.2013 – 31.12.2020 i përlllogaritur nëpërmjet ndryshimit të mesatares së ponderuar²⁹ në njësitë e kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare i ndjekur në nivel vjetor është 5,56% në shumë nominale dhe 4,86% në shumë reale.

²⁹ Vlera mesatare është llogaritur si mesatare e ponderuar e njësisë kontabiliteti të fondeve pensionale vullnetare pjesëtuar me mjetet-neto të fondeve pensionale të detyrueshme.

Grafik 6.21. Kontributet në shumë nominale dhe në shumë reale të FPV, vitet 2013- 2020



6.7. Kompensime tek fondet pensionale vullnetare

Për kryerjen e funksioneve të veta për menaxhimin me mjetet e fondit pensional vullnetar, vlerësimin e mjeteve, anëtarësimin, mbajtjen e llogarive profesionale individuale vullnetare të anëtarëve dhe për informim të anëtarëve si dhe pagesën të kompensimeve për MAPAS dhe për Kujdestarin e pasurisë, shoqëritë në përputhje me Ligjin për sigurim pensional vullnetar me financim kapital arkëtojnë kompensim nga kontributet, kompensim nga mjetet dhe kompensim për kalim.

Kompensimi i kontributeve arkëtohet si proces nga çdo kontribut të paguar në fondin pensional vullnetar para shëndrimit të tij në njësi kontabiliteti. Këtë kompensim shoqëria e arkëton në të njëjtin proces nga të gjithë anëtarët në skemën pensionale profesionale ose në rast anëtarësie shumëvjeçare. Kompensimi mujor nga mjetet përfaqëson përqindje nga vlera e mjeteve –neto të fondit pensional vullnetar i cili llogaritet për çdo datë të vlerësimit të mjeteve të fondit pensional vullnetar (në përputhje me rregullativën nënligjore në fuqi data e vlerësimit është çdo ditë) dhe arkëtohet njëherë në muaj. Kompensimi për kalim arkëtohet në rast të kalimit të anëtarit nga një fond pensional vullnetar në një fond pensional vullnetar tjetër me kusht anëtar i cili kalon të ketë qënë anëtar i fondit pensional vullnetar aktual jo më pak se një vit.

Ligji i përcakton shumat maksimale ndërsa shoqëritë janë të lira që ti përcaktojnë shumat e llojeve të kompensimeve individualisht në kuadrin e maksimumit ligjor.

Kompensimet të cilat i arkëtojnë shoqëritë të cilat menaxhojnë me fondet pensionale vullnetare në RMV për vitin 2020 janë paraqitur në tabelën 6.7.

Tabela 6.7. Kompensimet të cilat i arkëtojnë shoqëritë të cilat menaxhojnë me fondet pensionale vullnetare për vitin 2020

Lloji i kompensimit	SAVA	KB Prvo
Kompensim i kontibutit*	2,90% ³⁰	2,90% ³¹
Kompensimi mujor nga vlera e mjeteve-neto të fondit pensional vullnetar	0,100% ³²	0,075% ³³
Kompensim për kalim		
numri i ditëve **	Shuma e kompensimit për kalim	Shuma e kompensimit për kalim
nr i ditëve ≤ 360	10 euro	10 euro
nr i ditëve > 360	arkëtohet kompensim për kalim	nuk arkëtohet kompensim për kalim

* Për anëtarët të cilët janë pjesëtarë në skemat pensionale profesionale shoqëria mund të përcaktoj shumë më të vogël tek ky kompensim.

** Nr i ditëve përcaktohet në bazë të numrit të ditëve nga data kur anëtari fitoi të drejtën e statusit të anëtarit në fondin pensional vullnetar aktual deri më datën e nënshkrimit, të kontratës për anëtarësi në fondin pensional vullnetar të ardhshëm.

Shuma e kompensimeve nga kontributet të cilat arkëtohen nga fillimi i punës të shtyllës së tretë deri më vitin 2020 është e pasqyruar në tabelën 6.8.

Tabela 6.8. Shuma e kompensimeve nga kontributet të cilat i arkëtojnë shoqëritë pensionale të shtyllës së tretë

Shoqëria pensionale	Shuma	Data e zbatimit
SAVA	5,25%	Nga fillimi i punës së fondit (15 qershor i vitit 2009.)
	3,80%	Nga 1 mars i vitit 2011.
	2,90%	Nga 1 janari i vitit 2017.
KB Prvo	5,50%	Nga fillimi i punës së fondit (21 dhjetor 2009.)
	4,00%	Nga 24 prilli i vitit 2010.
	2,90%	Nga 1 qershori i vitit 2013.

³⁰ Nga 1 janari i viti 2017 (më herët ishte 3,80%).

³¹ Nga 1 janari i viti 2013 (më herët ishte 4,00%).

³² Nga 1 marsi i viti 2011 (më herët ishte 0,15%).

³³ Nga 1 janari i viti 2017 (më herët ishte 0,15%).

Nga fillimi i punës të fondeve pensionale vulnetare shoqëritë pensionale dy herë e ulën kompensimin e kontributeve. Kompensimi nga kontributet nga fillimi i punës të shtyllës së tretë ishte 0,15% në muaj nga vlera e mjeteve –neto të fondit pensional vullnetar. Gjithashtu në vitin 2011 të dy shoqëritë e ulën kompensimin nga mjetet dhe i njëjti ishte 0,100% tek SAVA dhe 0,075% tek KB Prvo.

Arkëtimet e kompensimeve (në mijë denarë) nga ana e shoqërive të cilat menaxhojnë me fondet pensionale vullnetare gjatë viti 2020 sipas muajve dhe sipas llojit të kompensimit është dhënë në tabelën 6.9.

Tabela 6.9. Kompensime të arkëtuara nga ana e shoqërive në vitin 2020 (në mijë denarë)

	Jan.	Shkurt.	Mars.	Prill.	Maj	Qer.	Kor.	Gush.	Shtat.	Tet.	Nënt.	Dhjet.	Gjithsej
SAVA – gjithsej	1.471	1.446	1.469	1.220	1.339	1.254	1.297	1.258	1.259	1.496	1.348	1.779	16.636
nga kontributet	458	420	493	233	327	222	252	204	203	429	258	664	4.164
nga mjetet	1.013	1.026	976	987	1.012	1.032	1.045	1.054	1.056	1.067	1.090	1.114	12.472
KB Prvo – gjithsej	1.152	1.157	1.044	917	928	1.089	996	961	1.049	1.056	1.194	1.990	13.534
nga kontributet	401	393	321	181	175	321	218	175	257	254	375	1.149	4.217
nga mjetet	752	765	723	735	753	768	779	787	792	802	820	841	9.317

Komisionet e transaksionit në lidhje me transaksionet për fitimin ose transferimin e mjeteve të fondit pensional vullnetar paguhen nga mjetet e fondit pensional vullnetar ndërsa i arkëtojnë persona juridikë të zgjedhur të cilët kryejnë shërbime me letra me vlerë në vend dhe jashtë shtetit. Komisionet e transaksionit llogariten si përqindje nga vlera e çdo transaksioni të përfunduar.

Gjatë vitit 2020 nga SAVAd ishin arkëtuar gjithsej 185 mijë denarë komisione transaksioni ndërsa nga KBPd ishin arkëtuar gjithsej 27 mijë denarë komisione transaksioni.

6.8. Pagesa e kompensimeve pensionale nga financimi kapital i sigurimit pensional vullnetar

Kushtet për fitimin e të drejtës së kompensimit pensional dhe pagesës së kompensimit pensional nga shtylla e tretë janë më liberale në raport me shtyllën e dytë, por gjithsesi duhet pasur parasysh se ato janë kursime pleqërie. Përkatësisht, mjetet mund të tërhiqen më së shumti dhjetë vjet përpara moshës së fitimit të së drejtës për pension pleqërie në përputhje me Ligjin për sigurimin indalidor dhe pensional, që për momentin nënkupton moshën 54 vjeçe për meshkujt ose 52 vjeçe për femrat. Gjithashtu, mjetet mund të tërhiqen në rastet kur tek anëtari është verifikuar paaftësia e tij e përgjithshme për punë nga ana e Komisionit për vlerësimin e aftësisë së punës pranë FSPIM, pa marrë parasysh moshën. Në rast vdekjeje të një anëtari të fondit pensional vullnetar, mjetet e llogarisë së anëtarit bëhen pjesë e masës së trashëgimisë dhe me to procedohet në përputhje me Ligjin e trashëgimisë.

Mjetet e shtyllës së tretë shfrytëzohen sipas zgjedhjes së anëtarit, në një nga format e kompensimeve pensionale të dhëna më poshtë:

- Pagesë e njëhershme ose më shumë pagesa të mjeteve;
- Anuitet pensional që paguhet nga shoqëria e sigurimit, e autorizuar për këtë qëllim;
- Tërheqje të programuara të siguruara nga shoqëria që menaxhon me fondin pensional vullnetar, ose
- Kombinimi i opsioneve më sipër.

Sigurimi i pensioneve dhe kompensimeve të pensionit, që paguhet nga shtylla e dytë dhe e tretë, është rregulluar me Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale të financimit kapital të sigurimit pensional


Në vitin 2020 u realizuan 282 kompensime pensioni dhe pagesa nga shtylla e tretë. Pjesa më e madhe e kompensimeve pensionale ishin për rastet e moshës, më saktësisht pjesa më e madhe në formën e pagesave të njëhershme, ndërsa një pjesë e vogël u realizuan në formën e pagesave të shumëhershme. Një pjesë e vogël e pagesave të shtyllës së tretë ishin për rast vdekjeje të anëtarëve, me pagimin e trashëgimisë. Një vështrim i detajuar i kompensimeve pensionale të realizuara dhe pagesave për anëtarët e shtyllës së tretë, sipas fondeve pensionale vullnetare dhe llojit të llogarisë për vitin 2020 është dhënë me Tabelën 6.10.

Tabela 6.10. Kompensimet e realizuara pensionale dhe pagesat e anëtarëve të shtyllës së tretë

Lloji i kompensimit pensional dhe pagesat/Fondi pensional vullnetar	SAVAd		KBPD		Gjithsej
	Llogari Ind.	Llogari prof.	Llogari Ind.	Llogari prof.	
Pagesa e njëhershme	60	32	31	138	261
Pagesa të shumëhershme	2	2	0	6	10
Trashëgimia	6	1	2	2	11
Gjithsej	68	35	33	146	282

Në grafikun 6.23. është paraqitur struktura e kompensimeve pensionale të realizuara dhe pagesat e anëtarëve nga shtylla e trete nga fillimi i punës të shtyllës së tretë sipas viteve deri më vitin 2020. Numuri i pagesave është i vogël pasi sistemi akoma është i ri dhe anëtarët janë relativisht persona të rinj Pjesa më e madhe nga pagesat janë pagesa të njëhershme të paguara në rast të mbushjes së kriterëve të moshës dhe më pas pagesat në rast vdekje të anëtarit si pagesë trashëgimie. Ekziston edhe një numur i vogël pagesash të njëhershme mbi bazë invaliditeti si dhe pagesa të shumëfishta mbi bazë mbushje të kriterëve të moshës.

Grafiku 6.22. Struktura e pensioneve dhe pagesave të realizuara nga shtylla e tretë që nga fillimi i punës



7 • Efektet e krizës globale e shkaktuar nga pandemia e virusit Korona mbi financimin kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

7. Efektet e krizës globale e shkaktuar nga pandemia e virusit Korona mbi financimin kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Pandemia me virusin Korona dominonte në jetën e përditshme të vitit 2020 dhe në gjysmën e parë të vitit 2021 dhe akoma gjeneron një ambient të pasigurt. Përkeqësimi i menjëhershëm i situatës epidemiologjike globale e shkaktuar nga përhapja e virusit Korona e shoqëruar me vendosjen e masave për ruajtjen e shëndetit publik të llojit të kufizimit të pjesshëm ose të plotë shkaktoi efekte të ekonomike të mëdha. Kriza shëndetsore dhe ekonomike globale kishte ndikim të dukshëm në tregjet financiare të vendit dhe jashtë vendit ndërsa fondet pensionale maqedonase nuk ngelën imunë të situatave aktuale globale.

Tregjet financiare në nivel global ishin shumë të paqëndrueshëm në vitin 2020. Në përgjithësi çmimet globale të aksioneve ranë në mënyrë drastike në tremujorin e parë të vitit 2020. Indekset MSCI tregojnë se çmimet e aksioneve ranë nga mesi i muajit shkurt deri në fund të muajit mars të vitit 2020 në shtatë shtetet me tregje pensionale më të mëdha (Australia, Kanadaja, Japonia, Holanda, Zvicra, Mbretëria e bashkuar dhe USA). Indeksi MSCI botëror në gjysmën e dytë të marsit të vitit 2020 shënon rënie prej rreth 30% në krahasim me fundin e vitit 2019. Që atëherë tregjet e aksioneve i rikthyen vlerat e veta dhe deri në fund të shtatorit të vitit 2020 Indeksi MSCI botëror pothuajse ishte në një nivel si në fund të vitit 2019. Këto ndryshime sigurisht lidhen në një masë të madhe me efektet nga masat për ndalimin e përhapjes së virusit dhe nga masat politike për mbështetjen e ekonomisë. Në fund të tetorit 2020 tregjet financiare sidomos në Europë përsëri reagueshan dhe çmimet e aksioneve shënuan rënie më të butë. Indekset MSCI të vendeve europiane shënuan rënie në përqindje prej 8% në krahasim me rezultatet më të mira në Tetor të vitit 2020.

Grafik 7.1. Lëvizjet e indekseve MSCI³⁴ të shtatë tregjeve pensionale më të mëdha në botë Mars 2020- 2021 (baza 100 në fund të vitit 2019)




³⁴ Nxjerë: Refinitiv dhe përllogaritje personale.

I pashmangshëm është ndikimi i bursave botërore ndaj çmimeve të letrave me vlerë në të cilat janë investuar mjetet e fondeve pensionale. Në grafikun 7.2 janë dhënë lëvizjet e krahasuara³⁵ të MBI 10, OMB, Indeksi MSCI botëror dhe mesatarja e pandërruar të njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare dhe të detyrueshme për vitin 2020. Fillimisht efekti shihet në shumat e njësive të kontabilitetit. Në këtë periudhë vlera mesatare³⁶ e njësive të kontabilitetit shënoi oshilacione më të mëdha se të zakonshmet dhe në gjysmën e dytë të marsit viti 2020 shënoi rënien më të madhe në krahasim me dhjetorin e vitit 2019 dhe konkretisht mesatarisht prej rreth 8% tek fondet pensionale të detyrueshme dhe prej rreth 9% tek fondet pensionale vullnetare. Këto efekte janë afatshkurtëra ndërsa fondet pensionale janë investitorë afatgjatë kështu që performansat e tyre vlerësohen në një afat më të gjatë. Gjatë tremujorit të dytë dhe të tretë letrat e njësive të kontabilitetit gradualisht u ritën dhe në fund të Shtatorit të viti 2020 vlera mesatare e njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale të detyrueshme pothuajse e tejkaluan shumën e vitit 31.12.2019, Vlera mesatare të njësive të kontabilitetit të fondeve pensionale vullnetare e kaluan shumën e vitit 31.12.2019 në 1/3 e parë në tetor viti 2020.


Në fund të tetorit të vitit 2020 përsëri vihet re një rënie të vlerës mestare së njësive të kontabilitetit në krahasim me muajin Shtator të vitit 2020 për 1% edhe tek fondet pensionale të detyrueshme edhe tek fondet pensionale vullnetare. Por më 31.12.2020 rezultatet e mira investuese të fondeve pensionale i kompensuan rezultatet e ndryshimeve të këtylla të tregjeve në drejtim për poshtë. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020 (31.12.2020 në krahasim me 30.09.2020) njësia e kontabilitetit shënoi ritje prej 2,89% tek SAVAz, 3,40% tek KBPz dhe 1,37% tek TRIGLAVz. Gjithsej në fund të vitit 2020 njësitet e kontabilitetit tek SAVAz (për 3,15%), KBPz (për 4,28%) dhe TRIGLAV (për 0,09%) pothuajse i tejkaluan shumat e njësive të kontabilitetit të dt. 31.12.2019. Përsa i përket fondeve pensionale të detyrueshme të dy fondet pensionale e tejkaluan vlerën e njësive të dt 31.12.2019 (SAVAd për 1,60% dhe KBPd për 3,68%). Vlera mesatare e njësive shënon rritje prej 3,30% të fondeve pensionale të detyrueshme, ose 2,61% të fondeve pensionale të detyrueshme.

Grafik 7.2. Lëvizja të MBI 10, OMB, Indeksi MSCI botëror dhe mesatarja e ponderuar të njësive të kontabilitetit në FPD dhe FPV viti 2020(baza 100 në fund të viti 2019)




³⁵ Lëvizjet janë pasqyruar nëpërmjet ndryshimit të indekseve në varësi të indeksit fillestar =100, më 31.12.2019
³⁶ Vlera mesatare e njësive të kontabilitetit është llogaritur si mesatare e ponderuar në varësi të mjeteve neto të fondeve pensionale

Grafiku 7.3. Lëvizjet e mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit të FPD dhe FPV, 2020



Ndodhitë negative të tregjeve financiare botërore në vitin 2020 kishin ndikimin e tyre që shkaktoi uljen e vlerës të mjeteve të fondeve pensionale. Në tremujorin e parë të vitit 2020 ose në mars të vitit 2020 në krahasim me dhjetorin e vitit 2019 vihet re një devijim i dukshëm për poshtë nga trendi i ritjes të mjeteve neto të fondeve pensionale dhe konkretisht një mesatare prej 2,64% tek fondet e detyrueshme dhe mesatarisht 3,08% të fondeve pensionale vullnetare. Në muajin maj pothuajse vihet re ritje e mjeteve neto edhe tek fondet pensionale të detyrueshme edhe tek fondet pensionale vullnetare ndërsa në muajt e ardhëshëm edhe pse në masë të vogël u mbajt ritja kështu që në tetor të vitit 2020 vihet re ritja më e vogël mujore. Me gjendje dhjetor 2020 mjetet neto të fondeve pensionale të detyrueshme ishin 87,26 miliard denarë që do të thotë ritje prej 15,42% në krahasim me dhjetorin e vitit 2019. Ndërsa me gjendjen në Dhjetor të vitit 2020 mjetet neto të fondeve pensionale vullnetare ishin 2,29 miliard denarë, që do të thotë ritje prej 15,25% në krahasim me dhjetorin e vitit 2019. Për krahasim, në përpjethje me të dhënat paraprake të OECD, mjetet e fondeve pensionale në vendet anëtare të OECD në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 u ritën me 9% në vendet anëtare të OECD ose u ritën për diçka më shumë se 1% në krahasim me fundin e vitit 2019 në vendet që nuk janë anëtare të OECD.

Grafik 7.4. Lëvizjet e totalit të mjeteve neto të FPD dhe FPV sipas muajve viti 2020



Fondet pensionale janë investitorë afatgjatë kështu që më e rëndësishme është që ato të vlerësohen për një afat më të gjatë. Në përputhje me rregullat kontributi i fondeve pensionale llogaritet për një periudhë shtatëvjeçare në shumë nominale dhe në shumë reale. Kriza ekonomike-shëndetësore megjithatë ndikonte edhe në kontributet të llogaritura për periudhën shtatëvjeçare në vitin 2020. Kështu që shuma më e vogël e kontributit edhe në shumë nominale edhe në shumë reale të mesatares së ponderuar të njësive të kontabilitetit është vënë re në periudhën 31.03.2013 - 31.03.2020 edhe tek fondet pensionale të detyrueshme edhe tek fondet pensionale. Në tremujorët e ardhshëm dhe në fund të vitit 2020 vihen re shuma më të larta të kontributit shtatëvjeçar por akoma nuk është në nivelin e kontributit shtatëvjeçar të arritur në funde të vitit. Kontributi në shumë nominale i llogaritur nëpërmjet mesatares së ponderuar të njësisë të kontabilitetit të fondeve pensionale të detyrueshëm për periudhën 2014 – 2020 është më i vogël për 0,7 pikë në përqindje në krahasim me kontributin e periudhës 2013 – 2019 dhe për 0,9 pikë në përqindje tek fondet pensionale vullnetare. Fondet pensionale maqedonase akoma janë në fazën e akumulimit kështu që priten rezultate investuese të mira të cilat do ti kompensojnë rezultatet nga tronditjet e këtilla të tregut.

Grafik 7.5. Rendimenti i mesatares së ponderuar në njësinë e kontabilitetit, në FPD, edhe në FPV, sipas periudhave në vitin 2020



Ndikimi Individual mbi anëtarët e fondeve pensionale

Ndikimi në krizat financiare të këtilla individualisht për anëtarët e fondeve pensionale me kontribute të definuara varet nga alkimi i mjeteve të fondeve pensionale dhe nga mosha e anëtarit, për shkak se reziku investues e sjell vetë anëtarin individualisht. Shuma e pensionit të cilin anëtari do ta fitoj nga shtylla e dytë dhe e tretë do të varet nga fitimi të cilin fondi pensional vullnetar ose i detyrueshëm do ta realizojnë gjatë gjithë viteve të kontributeve të anëtarit dhe nga kontributi i realizuar në të gjithë periudhën dhe jo vetëm në disa vite të punës. Është logjike dhe e pritshme në periudhën kur anëtarët investojnë në fondet pensionale të zgjedhuara të ekzistojnë edhe periudha të rezultateve të dobëta, të ketë bile edhe kriza financiare në të gjithë tregun financiar të kapitalit në vend ose jashtë vendit por ajo që është më e rëndësishme fitimi në periudhat e punës së mirë ta mbulojnë humbjen kur tregjet e kapitalit kanë punuar dobët ose mesatarisht në një vit nëqoftëse merret parasysh periudha e përgjithshme e kontributeve të siguruarit (30-40 vjet) fondi të siguroj fitim të logjikshëm i cili do të siguroj një nivel të logjikshëm të pensionit nga shtylla e dytë ose kompensim pensioni nga shtylla e tretë. Që këtu lëvizjet e disfavorshme të mjeteve të fondeve pensionale në vitin 2020 nuk kanë ndikim shumë në mjetet e anëtarëve më të rinj të cilët mund të presin në vitet e ardhëshme mbulimin e humbjeve. Përderisa për anëtarët më të moshuar të cilët janë afër pensionit humbje të mëdha të mjeteve të fondeve pensionale mund të ndikojnë në humbje të pariparueshme dhe të gjata të kontributit nëqoftëse parat e kursyera duhet ti përdorin për tërheqje vjetore të programuara.

Por mosha mesatare e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshëm është 36 vjeç dhe mbi 95% e anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshëm janë më të rinj se 50 vjeç ndërsa mosha mesatare e anëtarëve të fondve pensionale vullnetare është 46 vjeç dhe mbi 91% e anëtarëve të fondeve pensionale vullnetare janë më të rinj se 50 vjeç. Numri i personave të cilët në vitin 2020 bënë tërheqje të mjeteve nga fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare është shumë i vogël Pritet këto ndikime afatshkurtëra dhe të disfavorshme të neutralizohen gjatë viteve që i ngelën anëtarëve derisa të dalin në pension.

Kriza ekonomike-shëndetësore në mënyrë afatshkurtër i devijoi trendët e lëvizjes për lart të parametrave të sigurimit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me financim kapital por fondet pensionale për një kohë relativisht të shkurtër e kthyen dhe e tejkaluan vlerën e zvogëluar të mjeteve e cila ndodhi nga lëvizjet e disfavorshme të tregut të kapitalit.

MAPAS si rregullator dhe supervisor regullisht e ndjek gjendjen dhe rreziqet në sfinancimin kapital të sigurimit pensional dhe me nevojë të vlerësuar mund të ndërmarë aktivitete dhe masa shtesë në kornizat e caktuara për veprim të supervisorëve pensional të cilët janë të njohur, të theksuar dhe të konfirmuar nga Organizata ndërkombëtare për supervisor pensional(IOPS).

8. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale

8. Marketingu dhe agjentët e shoqërive pensionale

Për mbrojtjen e interesave të anëtarëve aktualë dhe të ardhshëm të anëtarëve të pensionuar të financimit kapital të sigurimit pensional dhe për sigurimin real dhe informimin objektiv të publikut marketingu kryhet në mjedis të regulluar, të përcaktuar me ligj dhe me akte nënligjore.

Punët e marketingut janë të gjitha aktivitetet qëllimi i të cilëve është reklamimi i shoqërive pensionale dhe i fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe informimin dhe lidhjen e kontratave për anëtarësi në fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare dhe për pagesën e mjeteve nga fondet pensionale të detyrueshme dhe vullnetare. Këto aktivitete përfshijnë: reklamimin e punës së shoqërive pensionale dhe të fondeve pensionale me të cilët ato menaxhojnë, informimin për karakteristikat e sigurimit pensional të detyrueshëm dhe vullnetar me financim kapital, informim për kompensimet dhe për komisionet e transaksioneve, informim për kontributet e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, informim për portofolet investuese të fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, informim për llogaritë individuale, llogaritë individuale vullnetare dhe për llogaritë profesionale, anëtarësim dhe kalim të anëtarëve nga një fond pensional të detyrueshëm në një tjetër, anëtarësim dhe kalim të anëtarëve nga një fond pensional vullnetar në një tjetër, lidhje kontratash për tërheqje të programuara, kontrata për pagesa të njëhershme dhe kontrata për pagesa të shumëfishta dhe aktivitete të tjera për reklamim dhe sigurim informacionesh të lidhura me punën të shoqërive pensionale dhe të fondeve pensionale. Shoqëria pensionale mund të kryej punë marketingu të fondit pensional në ambientet e saj në ambientet e bashkëpunëtorëve tregtarë të saj për marketing ose jashtë tyre direkt ose nëpërmjet lloji të përshtatshëm komunikimi (telefon, faks, internet). Ambientet për marketing duhet ti plotësojnë kushtet e caktuara ligjorë.

Që të ketë mundësi MAPAS të realizoj funksionin kontrollues mbi materialet e marketingut, shoqëria pensionale është e detyruar ti dorëzoj tek MAPAS në fotokopje ose në medium të jashtëm të përshtatshëm çdo material për marketing i shpallur brenda afatit tre ditë nga dita e shpalljes së tij. Në rast kur MAPAS konsideron se ndonjë reklamë ose ndonjë material tjetër i shtypur mund të shkaktoj çoroditje, mund me vendim ta ndaloj shpalljen ose shpërndarjen e saj të mëtejshme dhe të urdhëroj shpallje të ndryshimit të atij materiali në një afat që vet mund ta caktoj.

Personi që kryen marketing, i ashtuquajtur agjent mund të jetë person i punësuar në shoqërinë pensionale ose person tjetër që është angazhuar me kontratë nga ana shoqërisë pensionale. Agjenti mund të kryej punë marketingu të fondeve pensionale ose /dhe të lidh kontrata për anëtarësi ose për pagesën e mjeteve vetëm për fondet pensionale me të cilat menaxhon shoqëria pensionale në të cilën ai është i punësuar ose i angazhuar me kontratë. Agjenti në mënyrë të detyruar bën pjesë gjatë lidhjes së kontratës për anëtarësi në fondin pensional, në kontratën për kalim, kontrata për tërheqje të programuara, kontrate për pagesa të njëhershme dhe kontrata për pagesa të shumëfishta është i detyruar ta nënshkruaj një kontratë të tillë. Agjenti është i detyruar të gjitha kontaktet me anëtarin me anëtarin e pensionuar ose me personat të cilët kanë të drejtën të bëhen anëtarë me anëtarët e pensionuar të fondit pensional ti kryej vetë dhe nuk mund të lidh kontrata nëpërmjet personave të tjerë. Gjithashtu agjenti ka rol të rëndësishëm dhe gjatë zgjedhjes të llojit të pagesës së pensionit nga financimi kapital i sigurimit pensional nga ana e anëtarit dhe është i detyruar personalisht ti bëjë prezantimin e ofertave për pensionet e ardhshme të projektuara anëtarit i cili ka bërë kërkesë për kotacion me sqarim të detajuar të karakteristikave dhe i supozimeve të përdorura për të gjithë llojet e pagesave të pensionit.

Personi mund të kryej punë marketingu vetëm pasi të regjistrohet në Regjistrin e agjentëve që e mban MAPAS. MAPAS përcakton mënyrën dhe procedurën për dhënien e provimit për agjentë dhe mënyrën e regjistrimit të personit në Regjistrin e agjentëve.

Gjatë vitit 2020 organizohej dhënie provimi për agjentë në dy sesione provimi. Sesioni i provimit i cili ishte parashikuar në mars të viti 2020 u anulua dhe u krye në tetor të vitit 2020 për shkak të situatave të shkaktuara nga pandemia e virusit Korona. Pastaj në dhjetor të vitit 2020 u krye edhe një sesion provimi. Në vitin 2020 nga 132 kandidatët prezentë të deklaruar për dhënie provim 69 prej tyre e morën provimin ose 52% nga kandidatët prezentë. Numri i kandidatëve të cilët dhanë provimin në vitin 2020 në mënyrë të dukshme është më i vogël në krahasim me vitin e kaluar që i detyrohet situatave të shkaktuara nga pandemia e virusit Korona. Në tabelën 8.1. janë dhënë të dhënat e detajuara për kandidatët prezentë të cilët e morën provimin për agjentë për vitin 2020 sipas shoqërive pensionale.


Tabela 8.1. Kandidatët prezentë të cilët e morën provimin për agjentë sipas shoqërive pensionale

Shoqëria penionale	Të pranishëm	Kaluan	kaluan (në %)
SAVA	35	20	57%
KBP	46	18	39%
TRIGLAV	51	31	61%
Gjithsej	132	69	52%

Gjatë vitit 2020 u krye regjistrimi i 88 agjentëve gjithsej nga të cilët 14 agjentë në SAVA, 37 agjentë në KB Prvo dhe 37 agjentë në TRIGLAV. Regjistrim i përsëritur³⁷ u krye për 4 agjentë për TRIGLAV SHOQËRIA PENSIONALE AD Shkup. Gjithashtu ishte kryer edhe rinovim vjetor të regjistrimit të agjentëve dhe konkretisht gjithsej 549 agjentë, nga të cilët 274 të SAVA, 205 agjentë të KB Prvo dhe 70 agjentë në TRIGLAV. Gjatë vitit 2020 tek gjithsej 14 agjentë i mbaroi statuti i agjentit nga të cilët 6 agjentë të SAVA dhe 8 agjentë të KB Prvo. Pasqyra e numrit dhe vlerave mesatare të agjentëve të regjistruar, me statut të rinovuar dhe të mbaruar nga viti 2015 deri më 2020 sipas shoqërive pensionale është pasqyruar në grafikun 8.1. Mund të vihet re se numri i agjentëve të regjistruar tek SAVA, KB Prvo dhe TRIGLAV në vitin 2020 është më i vogël në krahasim me vitin 2019 që prapë sigurisht më shumë i detyrohet situatave të shkaktuara nga pandemia e virusit Korona.

³⁷ Regjistrim i përsëritur i agjentit për një shoqëri pensionale kryhet për agjentë i cili më parë ka qenë agjent aktiv në tjetër shoqëri pensionale.


Grafik 8.1. Numri i agjentëve të regjistruar³⁸, me status të rinovuar dhe të mbaruar sipas viteve dhe shoqërive pensionale



Në lidhje me numrin të kontratave për anëtarësi në fondet pensionale të detyrueshme të cilat i lidhën agjentët nga fillimi i punës të sistemit nga grafikun 8.2.mund të vihet re se më shumë agjentë të cilët mesatarisht kanë lidhur më shumë kontrata për anëtarësi ka në vitin 2005, duke parë se ishte fillimi i sistemit edhe deri më vitin 31.12.2005 ishte afati i fundit kur anëtarët vullnetarët mund të zgjidhnin nëse do të përfshihen në sistemin dyshtyllësh dhe të nënshkruajnë kontratë. Në vitet e ardhshme numri i agjentëve të cilët lidhën kontratë në kontinuitet u zvogëlua nga viti në vit dhe njëkohësisht ritet numri mesatar të kontratave të lidhura për agjent deri në vitin 2011. Më pas deri në vitin 2014 numri mesatar të kontratave të lidhura për agjent dukshëm bie. Në vitet e ardhshme numri i agjentëve të cilët lidhën kontratë dhe numri mesatar të kontratave të lidhura për agjent ngelen afërsisht në të njëjtin nivel.Në vitin 2019 kur filloi të punoi shoqëria e tretë pensionale përsëri vihet re ritje të numrit të agjentëve të cilët lidhën kontrata si dhe ritje minimale të numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent në krahasim me vitin 2018. Ritja e numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent vazhdon edhe në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 më shumë për arsye të roitjes të numrit mesatar të kontratave të lidhura për agjent tek TRIGLAV. Për sa i përket numrit të agjentëve të cilët lidhën kontrata, ritje kishte vetëm tek TRIGLAV ndërsa tek SAVA dhe KB Prvo kishte ulje.

³⁸ Numri i agjentëve të cilët regjistrohen përsëri janë përfshirë në numrin e agjentëve të regjistruar.

Grafik 8.2 Numri i agjentëve të cilët lidhën kontratë për anëtarësi në FPD dhe numri mesatar i kontratave për agjent





MAPAS

Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

Përkthimi në shqip: Shoqëria për gjuhët e huaja dhe
kompjutera LOGOS PLUS ABC DOOEL Shkup

